

40 VJET MË PARË U NDA NGA JETA DRITA ÇOMO, VAJZA E LIRI BELISHOVËS

Në ditën e ftohtë të fundit të shkurtit, një qerre çonte në varrezën e qytetit një poeteshë njëzetetrevjeçare, një vajzë të bukur, një nga ato që ky popull i pillte me aq lehtësi e po me atë lehtësi i shkatërronte. Pas qerres, mbi të cilën lëkundej trupi i pajetë i vajzës, ecte vetëm një njeri: nëna e saj. Sëmundja e pashërueshme kishte ngadhnyer më në fund mbi trupin e vajzës, por shteti diktatorial, më i egër se sëmundja, do të ishte i pamëshirshëm në mizorinë e tij.

Dritë që vjen nga humnera

Nga Ismail Kadare

ÇFARË PO NDODH ME ARBËRISHTEN?

Nga Edmond Cane

(fq. 12)

Homazh për poetin arbëresh, Zef Kakoca
SHEMBJA E URËS MBI DET

nga Arben Veselaj

(fq. 13)

Romani "Mos harro të më kujtosh"
i Liridon Mulajt

**Si një thirrje për dashuri,
kujtesë dhe ndryshim...**

Nga Adrian Zalla

(fq. 9)

Lindita Xhanari Latifi:

**Hapja e qendrave albanologjike
në Turqi, domosdoshmëri**

Intervistë dhënë gazetares

Mimoza Hasani Pllana

(fq. 20)

Mbi ekspozitën e piktorit dhe studiuesit Oltsen Gripshi
"Stinët e qenies apo himni i jetës"

**KUR SHKOJMË MË
TEJ SE IMAZHI**

Prof. Dr. Josif PAPAGJONI

(fq. 16)



70 vjet më parë,
më 26 shkurt 1951
u pushkatua pa gjyq

**SABIHA KASIMATI
INTELEKTUALJA E
SHQUAR MARTIRE**

Nga Uran Butka

(fq. 8)

**QASJE NDRYSHE NDAJ
ROMANIT "DIKTATORI NË
KRYQ" TË MIRA MEKSIT**

Nga Floresha Dado

(fq. 14)

**Të përkthesh Kadarenë
për skenën: Stinë e
mërzitshme në Olymp**

Fabrice Conte-Williamson

World Literature Today, Shkurt 2021 (fq. 22)



Mbi përkthimin e George Orwell

**ARBEN
KALLAMATA:
Sa më shumë ta
mendosh, aq më i
frikshëm të duket
përkthimi**

Bisedoi Andreas Dushi

(fq. 6)

BIBLIOTEKË

Klara Kodra

Tablo dimri

(fq. 11)

Jeffrey Archer

Dashuri me shikim të parë

(fq. 18)

Franz Kafka

Dy proza të shkurtra

(fq. 19)

Drita Çomo

Dashuri siberiane

(fq. 5)

BOTIME TË REJA

Shtëpia e librit OMBRA GVG:

MONIKA KOMPANÍKOVÁ

Varka e pestë

(fq. 7)

Shtëpia botuese Dituria

ALDA MERINI

E çmendun, e çmendun, e

çmendun dashunie për ty

IBEN AKERLIE

Shoku im kokëposhtë

(fq. 11)

ISMMAIL KADARE: Dritë që vjen nga humnera

I

Një natë shkurti të ftohtë të vitit 1981, në një nga dhomat e spitalit onkologjik të Tiranës, ndodhte një skenë dhembjeje, tepër e njohur në këto mjedise: përbri shtratit të një vajze të re njëzetetrevjeçare, që ishte në grahmat e fundit të jetës, nëna e saj, e kërrusur nga brenga bënte të vetmen gjë që shumica e të afërme bëjnë në kësi rastesh, i lagte buzët.

Skena ishte diçka e përsëritur qindra herë në këtë ndërtesë të trishtë. E veçanta ishte se te dera e dhomës së vajzës që po jepte shpirt, nënën e mjeruar e prisnin në këmbë dy njerëz të policisë së fshehtë shqiptare. Ata nuk e fshihnin padurimin, madje njëri prej tyre i tha gruas të shpejtonte.

Edhe kjo nuk ishte e rrallë në Shqipërinë komuniste. Shpeshherë, ata që vinin për të parë të afërmit që jepnin shpirt në spitalet, ishin të internuar. Kështu që vinin të shoqëruar me roje dhe kohën e kishin tepër të kufizuar, madje duhej të falenderonin shtetin për zemërgjerësinë e treguar për dhënien e lejes. Shumë të tjerë, as që arrinin ta merrnin dot lejen, ose e merrnin tepër vonë, kur i sëmuri ndodhej ndërkaq nën dhé.

Gruaja kërkoi të rrinte edhe pak, por shoqëruesit, fare shpërfillës, e urdhëruan haptas të ngrihej.

Te dera ajo bëri përpjekjen e fundit: “Unë njoh Nexhmije Hoxhën. Më lejoni t’i telefonoj. Ajo është nënë dhe do të më kuptojë”.



Rojet qeshën me zë të lartë: “Si shumë lart e vrake. Dashke të shqetësosh edhe shoqen Nexhmije. Nuk thua faleminderit që të lamë edhe kaq”.

Gruaja uli kryet dhe doli.

II

Vajza që jepte shpirt në spitalin Onkologjik ishte Drita Çomo, një nga letraret më interesante të brezit të vet, por në atë kohë e panjohur krejtësisht, për arsyen e thjeshtë se të atin e kishte në burg dhe nënën në internim. Për ata që e shihnin, ishte thjeshtë një vajzë tepër e bukur, pakëz e trishtuar. Në udhën e jetës së saj i kishin dalë herët, tepër herët, dy nga përbindëshat më të zez të kohës: diktatura dhe kanceri.

Nëna, e cila nuk arriti dot t’i bindte rojet për ta lënë edhe pakëz më shumë te kryet e vajzës, kishte qenë vite me radhë një nga gratë më të njohura e të fuqishme të vendit, anëtare e Byrosë Politike, portretin e së cilës, e mbanin njerëzit në duar, në festat e paradat e Një Majit.

Njëzet vitet e internimit duhet t’i kishin mësuar shumë gjëra gruas, që kishte qenë dikur pranë majës së piramidës së pushtetit. Megjithatë, ajo natë shkurti, kur Gazi i Degës së Brendshme e çonte nëpër rrugët e errëta të Shqipërisë, drejt vendit të internimit, duhet t’ia ketë dhënë një zbulim të fundit për natyrën e shtetit e të regjimit, në mekanizmin e të cilit kishte bërë pjesë. Mijëra e mijëra familje të shqyera kështu për shkak të luftës së klasave. Fate të përmbysur, njerëz të ndarë përjetë për së gjalli, egërsi e skajshme, mungesë mëshire, çnjerëzi e ngritur në doktrinë.

Goditja e fatit, ajo që komunistët kishin gjithmonë dëshirë ta imitonin, kishte qenë mizore për gruan. Do të mjaftonte shumë më pak për t’i kujtuar gjithkujt se ka një kërcënim qiellor, që qëndron mbi dokrrat politike të çdo ngjyre, mbi pushtetin, paradat, byrotë politike dhe, natyrisht, mbi luftën e klasave.

Do të mjaftonte leximi i shkrimeve të vajzës, që nëna i mbante në çantën e saj, për të kujtuar se sa larg ishte bota komuniste nga bota e njeriut. Ndonëse të cinguar nga ankthi i kontrollit, ato shkrime jepnin fare qartë një tjetër botë. Mirëpo fati nuk ishte mjaftuar me gjykimin e prozës dhe vjershave të vajzës. Ai kishte kërkuar më shumë: vetë krijuesen e tyre.

III

Drita Çomo vdiq dy ditë më pas nga vizita e nënës, në moshën 23-vjeçare, krejt e vetmuar, në një shtrat të spitalit Onkologjik. Qysh foshnjë

kishte qenë në internim. Në moshën 18-vjeçare ishte prekur nga sëmundja e pashërueshme. Nga vjershat dhe ditaret e saj del fare e qartë se e ka ditur gjithmonë se do të vdiste shpejt. Gjithë rinia e saj kishte kaluar nën kërcënimin e vdekjes. Duke e patur këtë minierë të zezë, këtë antithesar mizor, ajo në vjershat e saj as e shpërfill sipas recetave rozë “të ngadhënjimit shpirtëror mbi vdekjen” etj. etj., e as e kthen në vello, në dantellë të errët te recetave të kundërta: “Vdekje, jam jotja” etj. etj. Natyrshëm shkruan se dëshiron shumë të jetojë, e po aq natyrshëm shkruan se e di që ditët i ka të numëruara.

Jeta e saj e shkurtër zhvillohet në një hapësirë të ngushtë: Cërrik, Elbasan, Tiranë, hekurudha që përshkon këtë zonë, stacionet e mërziatshme të Rrogzhinës e të Durrësit, ardhja në Tiranë për analiza ose shtrim në spital, kthimi prapë, ardhja përsëri.

Në trenat e mjerueshëm shqiptarë, në të ftohtën e dimrit ose zhegun e verës, zhvillohet pjesa më interesante e jetës së saj të dukshme. Është tepër e bukur dhe përherë tërheq vëmendjen e djemve. Ndaj në çdo udhëtim ka përherë nga një histori të vogël. Një histori që s’ka kurrë vazhdim. E ndërprerë, jo më prej fatalitetit të vdekjes, por prej një force po aq të errët: shtetit komunist. Ose më mirë, prej asaj vetë, që ka rënë robinë e këtij shteti.

Një vajzë e re që e di që do të vdesë, ose e humbet krejt shijen e jetës, ose synon të përfitojë sa më shumë prej afatit të shkurtër. Drita Çomo krijon një raport të vetin qoftë me jetën, qoftë me vdekjen, një raport të natyrshëm, pa kurrfarë poze dhe kryesorja: sipëran. Shpjegimi i këtij raporti të mahnitshëm është se ajo, ndonëse nuk e thotë, e ndjen se i përket një bote të veçantë, asaj të krijuesve. Janë ata, princat e një bote tjetër, atje ku vdekja dhe jeta janë të përziera, dhe ku jeta ka të tjera afate, që i japin motrës së tyre të vogël atë drejtpeshim të admirueshëm.

Njëzetvjeçare, e bukur, me verdiktin e vdekjes në trup, nuk i shmanget njohjes me djemtë. E megjithatë, pa qenë e ftohtë, është e përmbajtur. Në çdo njohje duket sikur kërkon të vërtetojë pambarimisht, si në një ëndërr të keqe, fatalitetin e gjendjes së saj. Afërsia e vdekjes nuk është pengesë për dashurinë, përkundrazi. Është diçka tjetër që ngjan e pakapërcyeshme: statusi politik. Ndaj, ndërsa rrallë, shumë rrallë, i tregon të njohurit të saj arsyen shëndetësore përse i shmanget një lidhjeje me synim martesë, pothuajse të gjithëve iu tregon pengesën politike. Duket sikur mezi ç’pret çastin që adhuruesin e porsanjohur të saj ta vejë në provë. Nuk është as trill, as kureshti femërore. Është thelbi i jetës shqiptare, që pasqyrohet në dramën e vogël që do të luhet mu përpara syve të saj, në çastin kur ajo do t’i thotë adhuruesit mbiemrin e vet, ose më mirë mbiemrin e nënës, Belishova. Ky është mbiemër tepër i njohur për të gjithë ata që kanë mbaruar shkollat e Shqipërisë. Qysh në gjimnaz, në mësimin e marksizëm-leninizmit, në kreun për grupet armiqësore antiparti, ata kanë mësuar diçka edhe për gruan, vajza e së cilës është shfaqur befas në sytë e tyre në trenin e mërziatshëm Rrogzhinë-Peqin. E bukur, e largët, me sy të vëmendshëm ajo heton efektin e zbulesës tek i porsanjohuri. Brenda një grime kohe, ajo është në gjendje të rrokë atë që analistëve do t’u duhej një kohë e gjatë: në ç’masë shteti diktatorial ka arritur të cënojë e të shtrajtojë shpirtat njerëzorë, sa thellë ka zbritur e keqja në ndërgjegjen dhe në fund ndërgjegjen



e tyre. Të vënë përpara një prove të befasishme, djemtë, që nuk e kanë ditur as vetë në ç'raporte kanë qenë me shtetin diktatorial, zbërthehen aty për aty. Një pjesë hutohen, disa heqin dorë, disa më të rrallë, përkundrazi, ndonëse e dinë se ç'tmerr është një guxim i tillë, i thonë se janë të gatshëm të përballojnë pasojat. Ndërkaq ajo, sipërane si një princeshë, pa lojtur me askënd e pa fyer asnjëri, qoftë të drojturin, qoftë kokëshkretin, tërhiqet nga skena njerëzish. Vdekja e afërt, ashtu siç e dëshpëron, po aq e ndihmon të jetë shpirtërisht e lirë, e palidhur me gremçat e bezdisshme të jetës.

Megjithatë, e ndershme tërësisht, e nderon gjer në fund paktin me jetën. Vazhdon të jetojë normalisht, mëson gjuhë të huaja, lexon libra, dëgjon muzikë, zgjeron kulturën dhe, kryesorja, shkruan vjersha dhe mban ditar. E refuzon shturjen, që në raste të tilla është tunduese, ndërkaq nuk tërhiqet as nga imazhi i murgeshës. Krijesë e plotësuar njerëzore, e provon dhe e njeh dashurinë plotësisht. Por, po aq sa dashuria, ndoshta më fort se ajo, hapësirën e saj të brendshme vazhdon ta mbushë gjer në ditët e fundit të jetës letërsia dhe arti. Afrimi i vdekjes nuk ndryshon asgjë, as në artin, as në ndjenjat e saj. Vazhdon

të shkruajë vjersha njëjloj si më parë dhe po aq natyrshëm mban ditar. Asnjë përçudnim nuk i ndodh në shpirt. Një shoqe e saj e shkollës është bërë artiste dhe ajo shkruan dy vjersha për të dhe për bukurinë e saj, ndonëse vetë ka mbetur në humbëtirën e internimit.

Banore e tokës dhe e qiellit njëkohësisht, jeton në të dy nivelet, në harmoni me vetveten. E vetmuar, jashtë çdo kontrolli apo detyrimi moral, me njëfarë lirie që, për çudi, ia jep pikërisht sëmundja (udhëtimet në Tiranë për kontroll mjekësor, trenat dhe stacionet, qëndrimi i ndonjë nate në hotel para shtrimit ose daljes nga spitali), vajza njëzetvjeçare, ndonëse e shkelur me këmbë prej shtetit dhe sëmundjes, e ruan në të gjitha rrethanat klasin e saj të lartë. Ndjesia e të qenurit e fisme, nuk i vjen aspak prej kujtimit të kohës kur prindët e saj bënë pjesë në piramidën e pushtetit. Përkundrazi, ajo piramidë është kthyer në makth për të. Epërsia shpirtërore i vjen prej një tjetër nomenklature, asaj të artit, zotat e së cilës nuk i rrëzon dot asnjë stuhi e asnjë terror. Neofite modeste e këtij urdhri të madh, ajo është tashmë e përgatitur të përballojë perandorinë e vdekjes.

Në këto vjersha dhe ditare ne shohim vetëm periferinë e shpirtit të saj. Janë shkrime të krijuara

nën kërcënimin e kontrollit të befasishëm të policisë. Ndaj, gjithçka në to është e kujdesshme, e përmbajtur. Rrallë, shumë rrallë, përmenden gjëra delikate, si skena e gjykimit dhe e dënimit të ungjit të saj. Pothuajse asnjëherë s'përmendet ajo që duhet ta ketë torturuar, zymtuar e eksituar vite me radhë shpirtin e saj: rrëzimi i prindërve, sidomos i së ëmës.

E detyruar të heshtë për kryesoren, ajo na jep vetëm ca shenja të kursyera, por edhe ato janë të mjafta për të kuptuar pasurinë kryesore të saj: atë që u varros bashkë me të. Vepra e saj mund të përftohet vetëm kështu: një mundësi, një pasqyrim i diçkaje, thelbin e së cilës e ka thithur humnera.

Një pjesë të kësaj vepre e përbën kronika e spitalit dhe e zhvendosjeve për shkak të tij, hyrjet dhe daljet në ndërtesën e trishtueshme, analizat, shtimi ose pakësimi i leukociteve, grafitë e njëpasnjëshme, portrete të sëmurësh të tjerë, mbasditet e mërzitshme, vizitat e të njohurve, ardhja e njeriut të dashur, prapë analiza, grafi, shpejtim ose ngadalësim i përkohshëm i hapave të vdekjes.

Duke ruajtur gjithë përmasat, mund të thuhet se ky libër është skica e një versioni shqiptar të "Pavijonit të kancerozëve", me të vetmin ndryshim se Solzhenicini e shkroi atë gati dhjetë vjet pas vdekjes së Stalinit, kurse vajza njëzetvjeçare nga Shqipëria, e krijoi atë në vitet 1977-1981, kur diktatori ishte në kulmin e zyrtimit të tij.

IV.


"Sot ajo kalbet në dhé, në planetin që e deshi aq shumë". Me këto fjalë e ka dhënë ditën e varrimit të saj djaloshi që, ndonëse pati lidhje me të dhe e deshi fort, nuk arriti të bëhet, së paku, i fejuari i saj.

Në ditën e ftohtë të fundit të shkurtit, një qerre çonte në varrezën e qytetit një poeteshë njëzetetrevjeçare, një vajzë të bukur, një nga ato që ky popull i pillte me aq lehtësi e po me atë lehtësi i shkatërronte. Pas qerres, mbi të cilën lëkundej trupi i pajetë i vajzës, ecte vetëm një njeri: nëna e saj. Sëmundja e pashërueshme kishte ngadhnyer më në fund mbi trupin e vajzës, por shteti diktatorial, më i egër se sëmundja, do të ishte i pamëshirshëm në mizorinë e tij. Edhe pas vdekjes, atëherë kur ata që ai i quante kundërshtarët e tij, bëheshin të parrezikshëm për të, ai vazhdonte hakmarrjen. Kështu që vajza po futej nën tokë më e vetmuar se ç'kishte jetuar në sipërfaqen e saj.

Nga gjithë planeti tokësor, përveç spitalit, ajo s'kishte njohur veç një skutë fare të veçuar të tij, ca trena të vjetër, ca stacione të mërzitshëm dhe qytetthin e internimit brenda shtetit me emër të bukur por me fat të hidhur, Shqipërisë. Të tjerat: aeroportet, dritat e qyteteve të mëdhenj, muzikën, shkrimtarët, filmat, diskotekat e vallëzimit, plazhet e kafenetë e gëzueshme të të rinjve, ajo i kishte brenda vetes së saj, si një mall të vazhdueshëm e të paarrtshëm. Ishte ai mall i pamundur që, me rrezatimin e tij, ka ushqyer këto faqe fisnike. Duke kaluar anash botës, ajo arriti megjithatë të merrte jo egërsinë, por dritën e saj.

Ky libër, që del në dritë gjashtëmbëdhjetë vjet pas fikjes së vajzës, bën pjesë në ripërtëritjen e ëndrrës së vjetër të njerëzimit: rikthimit prej territ dhe asgjësë. E në këtë rast ne i themi vajzës: mirëseardhe në jetën tënde të dytë, në atë që s'njeh as veçim, as ankth.

Tiranë, 1997



E penguara

fragment romani

TRE MUAJ MË PAS. LINDA B.

Nga gjithë zhurmat e sipërfaqes, pothuajse asnjëra nuk zbriste në thellësi të tokës, atje ku Linda B. vazhdonte të ndodhej ende në të njëjtin kënd të varrezës së qytetit të vogël provincial.

Ndonëse shteti shqiptar po lëkundej, ligjet dhe sidomos rregullat që lidheshin me burgjet dhe internimet, ishin po ato. Njëri prej tyre ishte tejet i veçantë dhe të shumtë ishin ata që besonin se nuk gjendej askund, veç Shqipërisë. Ligji kishte të bënte me të internuarit dhe të burgosurit politikë, të cilët vdekja i zinte pa mbaruar dënimin. Trupat e tyre, pavarësisht se zbrazeshin nga shpirtrat, duhej të vazhdonin kryerjen e dënimit, gjer në mbarim të afatit, aty ku ndodheshin: në varre. Thënë ndryshe, vetëm pas plotësimit të kohës së dënimit, familjarët kishin të drejtë t'i nxirnin nga varreza e caktuar prej shtetit, për t'i çuar atje ku donin.

Ishte dashur njëfarë kohe që të merrej vesh se ligji, më saktë, thelbi i tij: veprimi i njëllojtë si mbi tokë ashtu edhe nën të, pikërisht ai që ishte dashur të shnjhej i pari, do të hiqej, me sa dukej, i fundit. E po ashtu të sqarohet se të vetmit që nuk i nënshtroheshin rregullores ishin, ashtu si më parë, të burgosurit e përjetshëm bashkë me të pushkatuarit, dy grupe të dënuarish për të cilët s'kishte më kohë, sidomos kohë që përbënte afat në kuptimin ligjor.

Për sa i përkiste dallimit midis të burgosurve dhe të internuarve, ndonëse, në thelbin e çështjes, veprimi të njëjtë të ligjit mbi dhë e nën dhë, i nënshtroheshin të njëjtit detyrim, ishte një pikë ku ndaheshin. Ndërsa vendimi për të burgosurin ishte gjithmonë vetanak, si çdo gjë tjetër e orëligut, për të internuarin, si rrjedhojë e asaj që internimet nuk bëheshin veçse familjarisht, po ashtu, familjarisht vinte edhe lirimi.

Ndërkaq, për shkak se familjet ishin përgjithësisht me shumë anëtarë, ishte e pamundur që ditën e lirim-it, midis të të dënuarve të mos kishte disa të vdekur, gjatë viteve të internimit, sidomos vocrrakë dhe pleq. Kështu që, në shkresën e famshme, anëtarët e liruuar shënoheshin veçmas në dy shtylla: të kësaj jete dhe të tjetrës.

Te prindërit e Linda B., shkresa kishte mbërritur saktësisht, jo vetëm në ditën kur mbusheshin pesë vjet nga e mëparshmja, por afërsisht në të njëjtën orë, pak përpara mesditës.

Ishte hera e parë që atë e pritën pothuajse me shpërfillje. Linda s'ishte më dhe ndjesia e parë e prindërve, kur e morën prej dorës së postierit, ishte se shkresa e kishte humbur tashmë kuptimin e saj. Një grimë kohe, tek vështronin emblemën e shtetit sipër zarfit, mendimi i parë që u erdhi mes zbrazëtisë ishte ç'e donin lirin tani që vajza s'ishte më. Madje, fshehtëzi, iu duk se do të dëshironin që përgjigjja, ashtu si më parë, të ishte mohuese. Le të mbeteshin aty, ashtu si më parë, në atë humbëtorë, ku dergjej tani vajza e tyre.

E ndienin se po bënin mëkat, dhe iu lutën Zotit t'i falte. U lutën me përdëllim përsëri dhe mendimi se nuk ishte vetëm djali, që i shkaktonte ndjesinë e mëkatit, por diçka tjetër. Ç'tjetër? desh thirri e ëma me zë. Ç'mund të kishte tjetër veç Lindës?

Donte të qetësohej, por nuk mundte. Turbull, nga thellësia i vinte përgjigjja e pyetjes së vet. Natyrisht që s'mund të kishte tjetër veç Lindës. Natyrisht që s'mund ta linin Lindën aty e vetë të iknin. Me sy të mjegullt vështronte shkresën që djali po ia tregonte ndërkaq, si për t'ia bërë të kuptueshme. Është emri i saj këtu, mama, bashkë me emrat tanë.

Pas tronditjes, kuptimi i asaj që kishte ndodhur po dilte nga mjegulla. Jo vetëm që Lindën s'do ta linin kurrë vetëm, por edhe ikjen, nëse do ta bënin, më shumë se për veten do ta bënin pikërisht për të.

Më shumë se ata në sipërfaqe të tokës, ishte ajo që kishte vuajtur nën të, e lidhur jo me një palë, por me dy palë pranga, ato të shtetit dhe ato të mortit. Nëse të mortit nuk ia hiqnin dot, t'i hiqnin së paku të parat, ato më të rëndat, shtetëroret.

Gjithë atë javë të paharrueshme u morën me dokumentet. Ato të Lindës ishin më të ndërlikuarat. Nga leja për zhvarrim që jepej prej drejtorisë së komunales gjer te një vërtetim i fundit i Degës së Brendshme, pa përmendur shkresat mjekësore. Pas endjes zyre më zyre, qëllonte që këmbët i shpinin te varri. Iu dukej se vajza kishte padurim, ndaj e ëma i përsëriste të njëjtat fjalë: duro edhe pak, zemër. Do të niseshin së shpejti,

të katërt, si dikur, nëpër filma, të dielave.

Nga Tirana, kushërinjtë e largët i lajmëruan se e kishin gjetur, më në fund, një vend në varrezën perëndimore të kryeqytetit, atë në drejtim të detit.

Ashtu u nisën vërtet një ditë fund maji, të katërt, në një furgon të vogël. Ata të tre ulur në ndenjset anësore, kurse Linda në arkëmortin e ngushtë, në mes.

Dita ishte e bukur. Frynte fllad. Karficën e flokëve, që nuk e kishte hequr qysh nga balloja e lamtumirës dhe që ia kishin gjetur midis baltës, ia kishin kapur me një gjilpërë mbi arkëmort, si të vetmin zbukurim.

Tabelat e rrugëve tregonin herë pas here fillime ose mbarime katundesh a qendrash banimi, që furgoni i linte pas. Shqipëria ngjante çuditërisht e e gjerë.

Kur u dukën tabelat e para me emra të pazakonshëm "Motel Europa", "Kafe-bar Atlantik", ata kthenin kryet sa djathtas, majtas, si për të kuptuar nëse kishin dalë ndërkaq nga zona e internimit.

Nuk kishte asnjë shenjë askund. Më duket se asnjëherë s'ka pasur, kishte thënë e ëma me zë të humbur. I ati nuk fliste, ndërsa i biri vazhdonte të lexonte me zë tabelat: "Kafe Viena", "Moteli i dy mbretëreshave".


Zhurma e motorit të furgonit ndryshoi papritur. Rruga kishte njëfarë ngjitjeje, por jo aq sa për atë gulçim e ato fjolla tymi të zi. Makina mezi çante përpara, ndërsa ata të dy, burrë e grua, vështronin prapë nga të dyja anët, këtë herë me fytyra të zbardhura nga tmerri.

Nuk flisnin, veç më pas ia pohuan njëri-tjetrit se kishin pasur ndjesinë e njëjtë se aty, me sa dukej, mbaronte zona e internimit, ndaj toka e shurdhër, thellë së cilës lajmet mbërrinin me vonesë, nuk donte ta linte trupin e vajzës të dilte.

Më tutje, furgoni e rimori prapë ecjen e tij të lehtë. Ishte po ajo freski maji dhe Shqipëria dukej tani e pafundme. Dy-tri herë u ndalën në kafenetë e vogla ndanë rrugë, për të marrë diçka, bashkë me shoferin. Tek përpiquej të mos binte në sy, gruaja, herë pas here, kthente vështrimin nga furgoni, i lënë pak si mënjanë, përbri hyrjes.

Pasdite vonë lanë prapa anëdetin e Durrësit, me vilat e shumta dhe hotelet e mëdha të turizmit, ku pistat e vallëzimit ende ishin të zbrazëta.


Kishte kohë që kryeqyteti jepte shenjat e tij, ndërsa vetë dukej se largohej. Ata vështronin të nemitur shtyllat telefonike që iknin mbrapsht, feramat dhe helikopterët në aeroportet e vogla ushtarake. Po binte mbrëmja. I ati me të birin herë pas here ndiqnin me bisht të syrit mollëzat e gruas. Ajo e kishte mbajtur veten më mirë se ç'kishin menduar. Vetëm kur larg u dukën dritat e Tiranës, dënosa befasisht ia drodhi supet, pastaj krejt shtatin, gjersa u këput e ra kruspull mbi arkëmort, si ta kishin goditur. Midis dënësës ia përmendte emrin Lindës, e herë pas here, në vend të tij, mezi arrinte të thoshte fjalët: vajzë, vajza ime.



Në vitin 1996 ndërsa po përgatisnim për botim librin me fragmente ditari dhe poezi të Drita Çomos, i kërkua Kadare që të shkruante një parathënie.

Shkrimtari jo vetëm që lexoi të gjithë librin por u interesua veçanërisht për historinë e jetës së saj të shkurtër duke biseduar me nënën e saj Liri Belishova (të cilën Kadare e kishte pasur personazh në romanin e tij "Dimri i vetmisë së madhe") Kadare shkroi parathënien me titull "Dritë që vjen nga humnera", që u bë edhe titulli i librit të Drita Çomos.

Shumë vite më vonë Kadare shkroi një nga romanet më të rëndësishëm të pas viteve '90, duke u bazuar në jetën e Drita Çomos. Romani u titullua "E penguara", i përkthyer tashmë në shumë gjuhë, duke e bërë të njohur në botë fatin tragjik të Drita Çomos.



Dashuri siberiane

poezi nga DRITA ÇOMO

PËR VETEN

22 vjet
Sa pak dhe sa shumë
Sa pak për të njohur kaq shumë dhembje,
Sa shumë për të bërë kaq pak në jetë.

22 vjet mund të ishin
Vite pasioni, kënge, rinie
Mund të ishin vite librash e kërkimesh,
Ngarkesa ëndrrash e poezie.
Shumë gjëra mund të ishin
Po mbyllur në guackë si kërmilli
22 vjet si t'i zvarrisësh?

Si t'i durosh për tërë këta vjet
Buzë hekurash, të shkurtrat takime,
Minutat që ikin aq shpejt, aq shpejt,
Ndarjen, mallin dhe dhembjen,
Që të rëndojnë mbi shpinë.

Si të ecësh kaq pranë vdekjes,
Ta zhveshësh veten nga më e thjeshta ëndërr
Dhe të studiosh qetësisht në bibliotekë
Literaturë që flet për vdekjen tënde.
Ta prekësh vdekjen rastësisht
Një mëngjes pas gjumit,
Strukur rrzëzë kofshës në një gjëndër.

Në sipërfaqe asgjë e veçantë nuk duket,
Në sy pranvera vend ka zënë.
Ndodh që rrugës qesh me fëmijë të bukur
Dhe e di që kurrë s'do bëhesh nënë.

Dhe të gjitha janë krejt të zakonshme,
Nën këmbë toka, lart qielli dhe re,
në mars sythet çelin dhe stinët ndërrohen.
Kot të ankohesh
Klith po deshe pa fund: "Përse?!"

Kot të gjitha... Po jetën e dua shumë
Dhe shpesh gëzohem ashtu kot, pa ditur,
Gëzohem që dua dhe që më duan,
Për një copë diell, për diçka të bukur.

Mars 1980

NËNËS*

Atë ditë ajo dukej krejt e thinjur.
Sytë e errët,
Si gjithnjë fshihnin dhembjen.
E kish harruar atë ditë zemërimin.
Atë ditë ajo ishte
Vetëm nënë.

PËR TY

Lëkunden pishat nën retë që ikin,
Ikin e ikin retë nëpër shi...
Unë pres të shoh pas reve pak qiell,
Ashtu siç pres pasditeve, të më telefonosh ti.
Po ti s'dukesh gjëkund. Ku paske humbur,
Ka kaq ditë që pres. Dhe bie shi...
Si mund të jetoj, pa pak qiell të kaltër,
Si mund të jetoj, pa zërin tënd, pa ty.
Ti do vish, unë e di, do vish patjetër,
Po unë dua të vish tani, nëpër shi,
Pastaj retë do të ikin dhe do të dalë dielli
Po unë dua diellin të ma sjellësh ti.

24 mars 1978

DASHURI SIBERIANE

Po bie shi... dhe ti je kaq larg
Po ndoshta dhe s'dua të jem me ty
Ky qiell gri... Në shpirt - kaq akull,
Kaq ftohtë në shpirt. Si në Siberi.

E megjithatë, unë të dua.
Dhe të dua shumë, çuditërisht
Po qe se të urresh është njësoj si të duash,
Të urrej dhe të dua njëkohësisht.
Të urrej për atë, që më prishe qetësinë
Të urrej, pse erdhe tek unë,
Për çdo gjë të vërtetë dhe çdo gjë të dyshimtë
Të urrej dhe të dua kaq shumë.

Dhe në shpirt kam dimër, gjithnjë dimër,
Një ftohtësi pa fund dhe pa anë
Në sa gradë nën zero paske lindur,
Dashuria ime siberiane.
Në të tërë qënien time bie shi
Dhe ti nuk je. Dhe ti je aq larg
Kam dëshirë për ty, kam nevojë për ty
Dhe prapë s'dua të jemi bashkë.

9 shtator 1978

CA LULE

Ca lule të bardha këputa në kopsht,
Si pikëllim i bardhë kanë ulur kokën
E duket se më thonë, po përse,
Ç'faj kishim ne, ç'faj kishim ne...
Ç'bëra, them me vete, veten shaj,
Po ja dhe unë vuaj dhe pa faj...
Petalet e bardha nis i shkund,
Si dhembje të vogla në dhembjen e pafund.

Po unë e dija, them me vete, veten shaj,
Se ç'do të thotë të vuash, kur s'ke faj.

12 prill 1978

PËR ATA QË DO VINË

Në pafundësinë e qiellit
dhe mbi ashpërsinë e tokës
Hodhëm hapat e parë.
Dy qenie të vogla, mizorisht të vogla.
Në tragjedinë e paanë të botës,
Nga më të zakonshmit udhëtarë.

Ecëm.
me një të kaluar që s'e kishim jetuar
Dhe pa të ardhme.
Megjithatë jetuam.
Pikërisht për të kaluarën
Dhe pikërisht për të ardhmen.

E deshëm jetën. Thjesht.
Dhe e duam.
Në humbëtirën e kohës shtyjme monotoninë
e ditëve.

Pa asgjë të re.
Ata që do vinë, të mos pyesin
përse jetuam:
jetuam, që ata mos jetojnë si ne.
Që ata të kenë ëndrra të lira,
si deti;
Të mos e njohin ngushtësinë
makabre të qelive,
Që ata ta duan diellin dhe njëri-tjetrin
Dhe të mos u besojnë kaq shumë perëndive.
Që ata ta dinë çdo të thotë DHEMBJE
Çdo të thotë të njohësh frikën dhe lotët
Dhe ta kuptojnë se... "Partia" dhe "Revolucioni"
Nuk mjaftojnë për ta bërë më të mirë botën.

Gusht 1977

** Fundi i këtij vargu është prishur qëllimisht nga Drita për shkak të përmbajtjes. (Shih faksimilen) I kemi vënë këto dy fjalë në bazë të kujtimeve të nënës së saj.

*Pa asgjë të re.
Ata që do vinë, të mos pyesin
përse jetuam:
jetuam, që ata mos jetojnë si ne.
Që ata të kenë ëndrra të lira,
si deti;
Të mos e njohin ngushtësinë
makabre të qelive,
Që ata ta duan diellin dhe njëri-
tjetrin
Dhe të mos u besojnë kaq shumë
perëndive.
Që ata ta dinë çdo të thotë
DHEMBJE
Çdo të thotë të njohësh frikën dhe lotët
Dhe ta kuptojnë se...
Nuk mjaftojnë për ta bërë më të
mirë botën.
D. Çomo
4-5. VIII. 77.*

* Është dita e takimit, pasi e ëma kishte marrë vesh se Drita vuante nga një sëmundje kanceroze.

ARBEN KALLAMATA: Sa më shumë ta mendosh, aq më i frikshëm të duket përkthimi

Bisedoi Andreas Dushi

A. D: Arben, fillimisht më lejoni t'ju përgëzoj me zemër për punën e mundimshme që si rezultat pati sjelljen e përkryer të Orwellit në gjuhën shqipe. Së fundmi, "Onufri" pas botimit të "Ferma e Kafshëve", ka botuar edhe "1984" nën përkthimin tuaj. Ky proces përkthimi, si ka qenë për ju?

A. B: Ju faleminderit. I jam mirënjohës "Onufrit" jo vetëm për dashamirësinë dhe besimin ndaj meje si përkthyes, por edhe për punën e shkëlqyer e serioze për t'i sjellë lexuesit shqiptar vlera të vërteta letrare. Midis botimit të këtyre dy kryeveprave të Orwellit ka një humerë kohore prej gati tridhjetë vjetësh, aq sa mund të flitet për epokë të ndryshme. "Ferma e Kafshëve" është përkthyer në një kohë kur ishte ende e rrezikshme të përktheje Orwellin dhe iu soll në dritë lexuesit pikërisht në çastin historik kur Shqipëria po linte pas një sistem për të kapërcyer te tjetri. Pra në një kuptim ishte periudhë kapërcimi, përmbyesjeje, revolucioni. "Ferma e Kafshëve" është metafora e revolucionit që merr për keq (si shumica e tyre).

Kur nisa ta përktheja atë libër, e shihja thjesht si parodi të asaj që kishte ndodhur me të ashtuquajturin revolucion proletar në Shqipëri. Ndërsa kur erdhi koha për ta rishikuar para se ta dorëzoja për botim, isha i bindur se kishte lidhje edhe me atë që po ndodhte, pra me përmbyesjen e madhe të fillimit të viteve '90-të. 'Ferma e Kafshëve' vinte jo vetëm si kujtesë për atë që kishte ndodhur, por edhe si paralajmërim për atë që po ndodhte dhe mund të ndodhte. Derri i quajtur Napoleon mund të marrë pamjen e Sekretarit të Parë të KQ të Partisë me kasketë proletari, por mund të marrë edhe pamjen e një kryeministri me kostum të errët dhe atlete të bardha.

Por ndërsa 'Ferma e Kafshëve' është metafora e revolucionit që merr për keq, '1984' është pamja brutale e revolucionit që ka marrë për keq, është mishërimi i qartë dhe i prekshëm i makthit me formën më të egër që mund të marrë diktatura. Unë e lexova për herë të parë "1984" në 1986 dhe nuk kisha se si të mos e përqasja me atë që shihja dhe përjetoja përreth. Ishin dy realitete frikshëmrisht të ngjashme. Mbaj mend që i kthehesha dhe i rikthehesha shënimeve biografike për Orwellin sepse nuk e përceptoja dot se si mund ta kishte shkruar ai atë libër qysh në vitet 1940, duke parashikuar me aq saktësi realitetin e vitit 1984 apo 1986 në Shqipëri. Dëshira për ta përkthyer '1984' më lindi që në atë kohë si një dëshirë për të ndarë me sa më shumë njerëz gjenialitetin e Orwellit dhe ndoshta si nevojë për t'iu bërë titull të gjithëve rreth meje: *Hej, shikoni se ku jemi katandisur*. Por natyrisht, në atë kohë nuk bëhej fjalë për përkthimin e Orwellit, ndërsa disa vite më vonë, në vitet '90-të unë nuk e ndjeja veten aq të zotin sa të përktheja '1984'.

Ishte koha kur mua m'u dha rasti të shkoj për të studiuar në SHBA. Libri i parë që bleva atje? '1984'. Nxitoja ta kisha në formë libri atë që e kisha lexuar nga një lidhje artizanale fletësh të fotokopjuara. Natyrisht, u vura gjithë kënaqësi ta lexoja përsëri, duke zbuluar pas çdo fraze nënkuptime të reja. Por befasia erdhi, kur përfundova librin. Botimi që kisha blerë dhe që e ruaj ende përmbante edhe një pasthënie të shkruar nga Erik From. Aty u shtanga, pasi për herë të parë hasa idenë se '1984' nuk ishte vetëm parodi e diktaturës komuniste, por ishte parodia e çdo diktature. Mustaqet e dashura të Vëllait të Madh, po aq sa të Stalinit mund të ishin edhe të Hitlerit.

Ky zbulim më bindi edhe më shumë se unë nuk isha gati ta përktheja '1984'. Prandaj prita. Prita disa vjet,

derisa u desh një bisedë me Bujar Hudhrin që të më nxiste të hiqja dorë nga hezitimi. Në atë kohë unë kisha vite që jetoja në mjedis anglisht-folës (në Kanada) dhe kisha krijuar një përfytyrim të qartë të jetës dhe mënyrës se si funksionon shoqëria në Perëndim.

Fillova të përkthej në vitin 2005. Fatkeqësisht, ose ndoshta edhe fatmirësisht, Onufri në atë kohë nuk mund ta botonte menjëherë përkthimin, pasi nuk kishte mundësi të siguronte të drejtën e botimit (*copyright*). Si botues serioz, Bujari nuk mund të shkelte rregullat më elementare të botimit. Na u desh të prisnim vite të tëra, gjatë të cilave unë i rikthehesha herë pas here përkthimit. Pati çaste kur isha i bindur që ai përkthim nuk do të botohej kurrë, e megjithatë vazhdoja e punoja për të sepse më jepte kënaqësi puna për të shkruar drejt asaj që të paktën unë e shoh si të përkryer. Zakonisht, unë përpiqem të gjej hapësira për përmirësim në çdo rresht që lexoj, pavarësisht nëse është shkruar nga unë apo nga dikush tjetër (një nga huqet e vjetra të punës si redaktor). '1984' e kam rishikuar aq shumë sa që është ndoshta e vetmja gjë që e ndjej se s'kam ç'i bëj më.

A. D: Kuptimi i asaj që ju e përktheni *Gjuhëre*, edhe kur e lexon në anglisht krijon një vështirësi, një lloj ngërçi. Ju, si e kapërcyeni atë dhe e sollët rrjedhshëm *Gjuhërenë* në shqip?

A. B: Më vjen shumë mirë që po më pyet për *Gjuhërenë* sepse është pjesë e përkthimit tim për të cilën ndihem më krenar. Kapitulli 'Parimet e Gjuhëresë' është përfshirë si *Apendiks*, si shtesë e romanit, por përbën në fakt, një nga sfidat më të forta për përkthim, sepse është një ndërthurje e mrekullueshme e leksikologjisë dhe gramatikës me fantazinë dhe sarkazmën, të gjitha këto në funksion të idesë kryesore të librit. Pa qenë pjesë integrale e ngjarjeve të romanit, ajo është në një farë mënyre pjesë funksionale e një prej ideve bazë të librit – idesë se '1984' është një

formë e ndërlikuar diktature që arrin të kontrollojë jo vetëm veprimet e njerëzve, por edhe mendimin, gjithçka që njeriu arrin të krijojë brenda kokës së vet. Pakësimi i numrit të fjalëve dhe kufizimi i kuptimit të tyre i kushtëzon krijimin në mendje vetëm atyre ideve që i përshtaten politikës së Partisë. Gjithçka tjetër është e pamundur të artikulohet nga truri, pasi nuk ekziston lënda e parë - fjala. Për mendimin tim, edhe sikur të shkëputej 'Parimet e Gjuhëresë' nga i gjithë romani dhe të paraqitej ajo më vete, si ese, do të kishim të bënim me një kryevepër.

Fati e ka sjellë që unë të punoj me fjalën edhe si dhe gazetar, si krijues, por edhe si mësues, përkatësisht mësues i gjuhës angleze. Kjo e fundit më ka diktuar nevojën e njohjes në thellësi të gramatikës dhe të nuancave nënkuptimore të fjalëve, gjë që më ka ndihmuar në përkthim, veçanërisht në përkthimin e 'Parimet e Gjuhëresë'. Në këtë kapitull çdo fjali, çdo frazë, çdo fjalë është sfidë më vete që për mua ishte jo vetëm punë, por edhe kënaqësi ta përballoja. Fillova ta përkthej gjithë librin, vetëm pasi u sigurova që isha në gjendje të përktheja si duhet 'Parimet e Gjuhëresë'. Përndryshe, nuk do të kishte kuptim.

A. D: Goethe, te "Shënime për divanin perëndim - lindje", duke folur për përkthimin, ngulmonte te "afrimi i së huajës tek e vendit, të së njohurës me të panjohurën" (A. Klosi, *ABC e përkthimit letrar*, fq. 18). Ndonëse në rastin e Orwellit, kulturës së gjuhës pritëse nuk iu paraqit diçka krejt e huaj, e panjohur, si e ndjetë ju të ndodhte ky afrim gjatë procesit të përkthimit?

A. B: Fjala dhe mënyra se si përdoret, apo keqpërdoret ajo, qëllimisht apo jo, është një nga temat më të rëndësishme për Orwellin. Flas jo vetëm për trajtesa të drejtpërdrejta si eseja e njohur *Politika dhe Gjuha Angleze* (Politics and the English Language), por edhe për të gjithë stilin e të shkruarit të tij. Orwell i përket atij grupi shkrimtarësh që i lexon me lehtësi, pasi përdorin fjalë në dukje të thjeshta dhe jo shumë të vështira. Por, po t'i shohësh me vëmendje vëren se thjeshtësia në dukje është rezultat i një kujdesi të jashtëzakonshëm për ta vënë gjithçka në vendin e vet, për ta puthitur sa më mirë dhe për të mos e ndërlikuar frazën pa qenë e nevojshme. Thellësia e mendimit nuk ka nevojë të fshihet pas shprehjeve të errëta dhe të vështira për t'u kuptuar. Por që të arrihet kjo, kërkohet më shumë punë, më shumë talent dhe njohje e thellë e gjuhës. E njëjta kërkesë është edhe për përkthyesin, nëse ky është vërtet serioz dhe kërkon ta përçojë me sa më shumë vërtetësi natyrën e vërtetë të autorit që po përkthen.

A. D: "Ferma e Kafshëve" ngërthen ngjarje që krijojnë një prej alegorive më mbresëlënëse. Të gjenit në shqip gjetjet e fijeve që ndërtojnë atë pëlhurë letrare, qe e vështirë?

A. B: Jo, gjetja e fijeve nuk ishte edhe aq e vështirë për vetë faktin se kur unë përktheja "Ferma e Kafshëve" ne sa po dilnim nga komunizmi dhe të gjitha fijet i kishim ende nëpër këmbë. Për një njeri të lindur dhe të rritur

GEORGE ORWELL

FERMA E
KAFSHËVE



OnufriRoman

GEORGE ORWELL

19

84

OnufriRoman



në diktaturë nuk ishte e vështirë t'i dalloje ato. E gjithë llafollogjia, i gjithë inventari i ideve propagandistike trushpëlarëse ishte vërdallë, i freskët, i prekshëm. Duhej vetëm vetëdije dhe prirja për t'i mbërthyer dhe përshtatur. Po sjell si shembull një pasazh të shkurtër:

"Tani ferma prodhonte më shumë dhe ishte më e organizuar; ishte zgjeruar me dy ngastra të tjera të blera nga zoti Pilkington. Më në fund kishte përfunduar me sukses edhe ndërtimi i mullirit, ndërsa pronave të fermës u ishin shtuar edhe një makinë shirëse e një transportier drithi... Kafshët i qenë përveshur me mobilizim punës për ndërtimin e një mulliri tjetër." Të gjitha këto fjalë: fermë, organizim, ngastra, makinë shirëse, transportier drithi, përveshur punës me mobilizim – janë pjesë e fjalorit të përditshëm propagandistik të diktaturës komuniste.

A. D: Teoritë e përkthimit dallojnë mjetet që përdoren për përkthimin e teksteve informuese dhe atyre letrare. Ndonëse edhe në një bisedë me V. Zhitin bëj një pyetje të ngjashme, përgjigjia juaj më ngjall shumë interes: Mendoni se "1984" është diçka përtej letrares, gati pranë informimit të botës mbi utopinë e diktaturës? A e trajtuat si të tillë, ndërkohë që po e përkthenit?

A. B: Shumë pak shkrimtarë arrijnë të ndikojnë aq fort në kulturën botërore sa të bëhen pjesë e fjalorit të përditshëm. Njerëzit nuk kanë nevojë të përmendin Shekspirin kur thonë *'të rrosh apo të mos rrosh'*, Servantesin kur përcaktojnë se dikush *'po lufton me mullinj të erës'*, apo Moljerin kur përcaktojnë dikë si *harpagon*, sepse janë shembuj kur letërsia i ka kapërcyer caqet e veta dhe është bërë pjesë e kulturës së përgjithshme dhe gjuhës së përditshme. Në të njëjtën mënyrë janë bërë pjesë e gjuhës *Big Brother* (Vëllai i Madh), *'të gjitha kafshët janë të barabarta, por disa kafshë janë më të barabarta se të tjerat'*, *'lufta është paqe, liria është skllavëri, padija është forcë'*. Edhe më fort se këto ka hyrë në fjalorin e përditshëm jo vetëm të anglishtes, por të shumë gjuhëve, një numër, **1984**, që përdoret për të përçuar një ide, ose një gjendje të caktuar politike, një *distopi* të cilës i druhen, duhet ta shmangim dhe që fare mirë, në forma të ndryshme, mund të jemi duke e jetuar. Është fjalë që përdoret nga një numër shumë më i madh njerëzish se sa mund të jetë numri i atyre që e kanë lexuar librin.

A. D: Si përkthyes, ju jeni gjithmonë mbi një litar tejet të tendosur i cili është i kapur në dy skaje, atë të gjuhës nisëse dhe atë të gjuhës pritëse. Si ja dilni të lëvizni mbi të, duke ruajtur gjithmonë drejtpeshimin?

A. B: Po sjell një nga ngjarjet që ka ndodhur diku nga gjysma e dytë e viteve 80-të, kur punoja si redaktor në gazetën "Drita". Një mik (e kam për nder ta quaj mik sepse është ndër më të shquarit poetë që ne kemi) vjen një ditë me një fletë ku ishin shkruar nja katër-pesë poezi të shkurtra të Robert Burnsit. "Ti di anglisht," më tha. "Ma përkthe pak se ç'thuhet." Mua më kapën të dridhurat. E para unë nuk përkthej poezi. E dyta, flitej për Bërnsin, që edhe anglisht të dish mirë, nuk e përkthen dot. Duhet të dish edhe *skoçeççe*. Dhe e treta, kujt po ia përktheja –

poetit? Por ai më qetësoi. S'ka problem, tha. Pak a shumë më thuaj me fjalë e tua çfarë thuhet. Unë bëra sa kisha mundësi, ndërsa ai mbante shënime. Më falenderoi dhe më tha që pak a shumë tani e kishte të qartë, sepse e krahasonte edhe me një variant italisht të poezive.

Përfytyroni habinë time kur po atë fundjavë pashë në gazetë një cikël me poezi të Burnsit të përkthyer prej poetit.

Ka përkthyes që mjaftojnë sa t'i marrin pak idenë origjinalit dhe pastaj i lëshojnë fantazisë së tyre. Përkthyes-krijues. Pësia e tyre si krijues i rëndon aq shumë atij litarit që thoni ju i lidh të dyja gjuhët, të dyja variantet, origjinalen dhe përkthimin, sa që litarit zgjatet e lëshohet pa fund. Pra, i vënë peshën e vet përkthimit, gjë që mund të jetë e tolerueshme kur përkthyesi është krijues i mirë, si në rastin në fjalë. Megjithatë, mua nuk më pëlqen ky lloj përkthimi. Të përkthesh Bërnsin pa ditur anglisht, pa njohur dialektin e Skocisë, pa njohur historinë e Skocisë, është një lloj si t'i mbash erë trëndafil me kundragaz dhe pastaj të përpiqesh t'ia shpjegosh erën dikujt që nuk e ka ndjenjën e nuhatjes.

E kundërta e kësaj janë ata përkthyes që përpiqen të përkthejnë gjithçka fjalë për fjalë, që ndikohen aq shumë nga origjinali sa që nuk gjejnë dot fjalë në shqip, përdorin fjalë të huaja dhe sintaksa iu del e shfytyruar.

Unë them që në atë figurën e litarit të tendosur të kapur në dy skajet, përkthyesi duhet të përpiqet të jetë sa më i pa-peshë, sa më i lehtë, që litarit të mbetet i tendosur. Unë jam gazetar dhe një gazetar i mirë duhet të jetë si ajo miza në murin e dhomës, që i dëgjon të gjitha ç'ndodhin por nuk ndikon në ngjarje. Në një farë mënyre, këtë rol duhet të ketë edhe përkthyesi. Përkthyesi duhet të ketë peshën e mizës mbi litar. Por që të arrijë ta bëjë këtë, duhet të njohë mirë të dy gjuhët, të dyja kulturat dhe veçanërisht, të njohë mirë autorin. Përkthyesi duhet t'i qëndrojë sa më besnik origjinalit, duke përçuar regjistrin ose shkallën e formalitetit, tonalitetin, nivelin e sofistikimit të fjalorit, dendësinë e përdorimit të idiomave apo shprehjeve popullore, masën e lojës me gjuhën që ka pasur ndërmend autori. Anglishtja ka idiomat që përkthehen fjalë për fjalë me të njëjtin figuracion edhe në shqip. Pastaj ka idiomat që i gjejnë të barazvlefshmet e tyre në ndërthurje krejt të ndryshme fjalësh. Dhe së fundi, ka idiomat që nuk përkthehen dot me idiomat tonat. Siç edhe shqipja ka idiomat që mund të përdoren fare mirë në kontekste kur autori po t'i kishte pasur në gjuhën e tij do t'i kishte përdorur. A e përcakton dot përkthyesi se ku dhe si duhen përdorur idiomat, apo i bie shkurt dhe përkthen ashtu si i duket atij më bukur?

Sa më shumë ta mendosh, aq më i frikshëm të duket përkthimi.

A. D: Dhe në mbyllje, një pyetje pak cliché, por e cila ka vlerë të veçantë në ditët e sotshme, kur shumëkush nisat edhe nga përkthyesi sa herë përzgjedh librin e radhës për të lexuar: A jeni duke punuar për ndonjë përkthim të ri?

A. B: Jo.

BOTIM I RI

Monika Kompaníková
VARKA E PESTË

Përktheu Nonda Varfi

Shtëpia e librit OMBRA GVG

Monika Kompaníková, ka lindur në vitin 1979. Konsiderohet si një nga shkrimtaret më të shquara bashkëkohore të Sllovakisë. Ka studiuar për pikturë dhe dizajn grafik në Akademinë e Arteve të Bukura në Bratislavë.

Kompaníková është fituese e çmimeve:

2001: Short Story, 2002: New Year Greeting for Gaz de France, 2004: Ivan Kraso Prize, 2008: Tatra Banka Foundation, 2011: Anasoft Litera Award, me romanin "Varka e pestë", 2013: Literary Fund Award, me librin për fëmijë "Përralla nga deti i thellë".

Romani "Varka e pestë" është përkthyer në shumë gjuhë të ndryshme dhe në vitin 2014, është realizuar film në një bashkëprodhim sllovak-çeko-gjerman.

Frymëzuar nga ngjarje të vërteta, Kompaníková ka shkruar një histori të jashtëzakonshme rreth marrëdhënieve të fëmijëve dhe prindërve në shoqërinë moderne. Kritikant ndaj shoqërisë dhe pyetjet e shumta të rëndësishme që ajo ngre mbi këto marrëdhënie e bëjnë atë, sipas shumë njerëzve, pikën e kthesës së letërsisë bashkëkohore sllovaqe.

Kompaníková rrëfen me talent krijon një atmosferë autentike. Kritika e ka cilësuar romanin "Varka e pestë" si një roman modern socio-kritik, një fenomen i rrallë në letërsinë sllovaqe. Një ndër temat mbizotëruese në veprat e saj, vetmia e individit, zakonisht çfaqet në formën e vetizolimit nga bota e jashtme. Personazhet e saj janë njerëz që jetojnë në skajet e shoqërisë me një të kaluar të errët ose që mund të aluzionohet.

Historia rrëfëhet nga këndvështrimi i Jarka-s dymbëdhjetë vjeçare, [ajo ka ardhur në jetë kur Lysia, mamaja e saj nuk ishte më shumë se gjashtëmbëdhjetë vjeç], e cila jeton me mamanë e saj dhe me gjyshen, në një familje "pa dashuri dhe harmoni".

E injoruar nga mjedisi social dhe e rrethuar nga xhungla e godinave postkomuniste prej betoni në një qytetet të vogël të Bratislavës, Jarka i kalon ditët duke ëndërruar për vendin e saj më të sigurt: një kopsht dhe një shtëpizë e vogël e ndërtuar nga gjyshi diku në periferi e rrethuar nga gjelbërimi dhe "varka e saj në një port të sigurt"...

Një ditë ajo "vjedh" dy binjakë miturakë, dhe i çon në shtëpizën e vogël në kopsht e kujdeset për ata. Në këtë shtëpi ajo sjell edhe "vocërrakun" tetëvjeçar Kristianin, një djalë shumë i edukuar që është larguar nga shtëpia e tij.

Këto janë historitë e fëmijëve të periferisë, të braktisur dhe që gjejnë strehë në rrugë duke u ndier më të sigurt sesa në shtëpitë e tyre.





Me rastin e pushkatimit të saj pa gjyq në mesnatën e 26 shkurtit 1951

SABIHA KASIMATI INTELEKTUALJA E SHQUAR MARTIRE

Nga Uran Butka

“Unë jam evolucioniste. Evolucioni është në natyrën e gjërave. Me dhunë nuk shkohet dot as në socializëm, as në demokraci; shkohet drejt shkatërrimit.”

Sabiha Kasimati

Sabiha Kasimati, një nga gratë e shquara të Shqipërisë, vjen nga një familje e njohur intelektuale libohovite. I ati i saj, Abdurrahman Kasimati, i kishte kryer studimet universitare për mjekësi në Turqi, ku punoi si mjek dhe jetoi me gjithë familje deri në vitin 1927. Në këtë vit u kthye në Shqipëri, ku fillimisht u vendos në Korçë, mandej në Elbasan, ku shërbeu si mjek dhe gëzoi respektin dhe mirënjohjen e qytetarëve, por edhe vlerësimin e miqësinë e personaliteteve të këtij qyteti: Aqif pashë Elbasanit, Lef Nosit, Visarion Xhuvanit, Ethem Haxhiademit, Sotir Paparistos e të tjerë.

Sabiha Kasimati lindi në Edërne (Adrianopojë) të Turqisë, më 15.09.1912. Atje kaloi fëmijërinë, e ushqyer

nga prindët me dashuri për Shqipërinë, por edhe për kulturën evropiane. Ndaj, kur u kthye familja në atdhe, ajo u vendos tek i vëllai në qytetin e Korçës, ku filloi studimet në Liceun Francez të këtij qyteti. Ajo qe e para femër që e mbaroi këtë shkollë perëndimore, në vitin 1930. Qysh nxënëse, ajo zotëronte disa gjuhë të Perëndimit dhe të Lindjes, në mënyrë të shkëlqyer frëngjishten, aq sa habiste edhe profesorët francezë të Liceut.

Vajzat korçare, por edhe qytetarët e Korçës e kujtojnë edhe sot Sabihanë si dallëndyshen e parë të Liceut, si çupën e emancipuar, të kulturuar dhe me temperament burror, që mbeti si një shëmbëlltë e pashlyer për vajzërinë dhe djelmërinë shqiptare.

Mbas mbarimit të Liceut të Korçës, ajo punoi disa kohë si mësuese në shkollën normale femërore të Korçës, duke dhënë lëndët «Edukatë morale» dhe «Frëngjisht». Më vonë u transferua si pedagoge në shkollën shqiptaro-amerikane në Kavajë, ku jepte biologji.

Në vitin 1936 mundi të plotësonte dëshirën e zjarrtë për studime të larta. Shteti shqiptar i akordoi bursë studimi në Universitetin e Torinos, në Fakultetin e Shkencave Biologjike, të cilin e përfundoi me sukses me notat 30/30, me lavdërim (trenta su trenta con lode). Në verën e vitit 1941 mbrojti edhe doktoraturën. Katedra i ofroi vendin e asistentes në ihtiologjinë fluviale, por ajo nuk pranoi dhe u kthye në atdhe.

Në Shqipëri punoi me entuziazmin e një vajze të re e të kulturuar, por edhe me vullnetin e një shkencëtareje të re që kërkonte t'i shërbente vendit të saj në nevojë. U emërua pedagoge në Institutin Femëror “Nëna Mbretreshë” në Tiranë. Mbas disa vitesh pune me pasion, u detyrua të shkonte në Itali për kura shëndetsore në një sanatorium të Torinos. Pas shërimit, aty nga viti 1945, u kthye në atdhe. Tek kthehej nga Italia, në aeroport takoi Ali Koprenckën që vinte nga Shqipëria. Ai i tha:

“Si vete në Shqipëri? Nuk e di se ç’po bëhet atje, hataja po bëhet! Ne, andaj po ikim. Po vendoset diktatura e kuqe.”

Sabihaja iu përgjigj: “Atje janë gjithë shokët e shoqet dhe bashkërisht do të përpiqemi që ajo gjë të mos bëhet dhe Shqipëria të përparojë.”

Nisi punën në Institutin e Shkencave, siç quhej atëherë bërthama e parë shkencore, që drejtohej nga prof. Selaudin Toto.

Sabihaja punoi me zell dhe përkushtim në specialitetin e ihtiologjisë (disiplinë shkencore që studion peshqit). Për rezultatet e saj për studimin e peshqve në ujrat e vendit tone, si edhe për vlerën ushqimore dhe ekonomike të tyre, ajo punoi 10 vjet me radhë dhe e përfundoi në vitin 1948.

“Jam e gëzuar që mbarova një studim mbi peshqit që do t'i shërbejë jo vetëm Shqipërisë, por edhe shteteve të tjerë që janë në kufi me Shqipërinë.”

Pra, Sabihaja ishte edhe një autore libri, i monografisë voluminoze “Peshqit e Shqipërisë”, që nuk u botua sa qe gjallë. Në vitin 1955, botohet vepra e saj, por jo me emrin e Sabihës, me emra të tjerë, duke i vjedhur edhe punën e saj intelektuale.

Sabihaja ishte një intelektuale e kompletuar, që kishte studiuar në Perëndim, një filozofe dhe biologje që e njihnte mirë thelbin dhe shfaqjen e panatyrshme e çnjerëzore të sistemit totalitar komunist, i cili po vendosej në Shqipëri. Ajo u dëshpërua thellësisht nga goditjet e rënda që po u jepeshin intelektualëve të vendit, veçanërisht atyre që kishin studiuar në Perëndim, mjaft nga të cilët ishin kolegët e saj. Gjyqet ushtarake dënonin me pushkatime dhe burgime të rënda elitën shqiptare. Ajo u trondit veçanërisht nga pushkatimi i drejtorit të saj, shkencëtarit Selaudin Toto, si edhe i intelektualëve opozitarë Gjergj Kokoshi, Suad Asllani, Sulo Klosi, Shefqet Beja, prof. Stanislav Zuberit etj., veçanërisht nga dënimi i shkrimtares së parë shqiptare, Musine Kokalari. Kështu Sabihaja filloi të shprehte pakënaqësinë për regjimin dhe për Enver Hoxhën, shokun e saj të klasës në Liceun e Korçës.

Këto pakënaqësi të saj, si edhe prejardhja nga një familje e madhe, tërësisht intelektuale dhe demokratike, bënë që emri i Sabihës të futej në listat e zeza të Sigurimit të Shtetit si “kundërshtar e regjimit”.

Dr.Namik Kasimati, rrëfen: “Duke qenë se Sabihaja kishte mbaruar Liceun Francez bashkë me Enver Hoxhën dhe e njihnte mirë, i kërkoi një takim.

Sabihaja: Kam ardhur të të them se ti po vret gjithë intelektualët. Dua të të pyes se me cilët ke ndërmend ta ndërtosh Shqipërinë, me teneqexhinjtë apo me këpucarët?”

Enveri: Boll lexove iluministët francezë, të këshilloj të lexosh Marks dhe Leninin.

Pas dy ditësh, Nako Spiru, të cilin Sabihaja e kishte shok, e thirri Sabihanë për një kafe dhe në bisedë e sipër i tha: “Sabiha, duhet ta qepësh gojën, jo me karficë, por me babushkë”.

Sabihaja ishte e çiltër, e shkujdesur dhe nuk mendonte se i ishte qepur pas vdekja.

Ing.Viktor Kasimati, i biri i Refiut, kujton: “Një ditë, aty nga fund i vitit 1948, Sabihaja ndodhej në shtëpinë tonë. Im atë u vonua pak atë ditë se kishin pasur një mbledhje me rëndësi në shkollën Politeknike,

ku punonte si pedagog. Ishte koha kur PKSH kishte dënuar Koçi Xoxen dhe grupin e tij, duke ia ngarkuar atij të gjitha krimet që kishte bërë pushteti komunist mbi shqiptarët, sidomos mbi elitën intelektuale. Im atë i tregoi Sabihase kur po hanim drekën: “Na foli një personalitet komunist, Tuk Jakova, i cili na tha që janë kryer shumë shkelje të ligjeve dhe janë dënuar shumë njerëz pa faj. Por në të ardhmen nuk do të ndodhin më gjëra të tilla”

Sabihaja e dëgjoi me vëmendje dhe ia ktheu aty për aty:

“Refi, mos i beso këto! Kjo është taktika e tyre, shtrëngo, liro pak dhe prap shtrëngo më fort se më parë për të mbajtur pushtetin. Mbaje mend që pas pak kohe, do të rifillojnë përsëri terrorin.”

Në fakt, rifillimi i terrorit masiv në vitin 1951 mori edhe kokën e Sabihase.

Sabihaja u arrestua më 20.02.1951. Ajo bënte pjesë na listën e Sektorit të Dytë të Drejtorisë së Sigurimit të Shtetit. Përbri emrit të saj ishte vënë një kryq, që do të thoshte se ajo do të pushkatohej.

Mehmet Shehu ishte ministër i Brendshëm. Ai propozoi në mbledhjen e Byrosë Politike që të arrestoheshin 100 ose 150 vetë, prej të cilëve të pushkatoheshin pa gjyq 10-15 persona dhe byroja ia miratoi

Pra, vendimi për të realizuar këtë masakër, u mor jo në sallën e gjyqit, por në Byronë Politike të PPSH, në mbledhjen e datës 20.02.1951, me pretekstin e hedhjes të një sasive të vogël dinamiti në oborrin e Ambasadës Sovjetike, që theu vetëm disa xhama në mbrëmjen e datës 19.02.1951. Urgjentisht u mblodh kupola e partisë-shtet dhe me propozim të ministrit të Brendshëm, Mehmet Shehut, u vendos të merreshin masa të jashtëzakonshme represive “pa marrë parasysh ligjet në fuqi.” (Të gjithë anëtarët e Byrosë, me në krye E.Hoxhën: Jemi dakord me këto masa represive.)

Enver Hoxha ia miratoi të gjitha veprimet dhe emrat e viktimave, që kishte përzgjedhur. Por Enveri shtoi nga ana e tij emrat e Sabiha Kasimatit, Reiz Selfos, Manush Peshkëpisë, Qemal Kasoruhos, të cilët ishin nga treva e Gjirokastrës dhe ai i njihte personalisht, por edhe ata e njihnin mirë atë. Ai nuk mund t'i harronte fjalët e Sabihase bie fjala, emri i Sabiha Kasimatit, thënë ish-shokut të klasës: «Kam ardhur të të them se ti po vret gjithë intelektualët. Dua të të pyes se me cilët ke ndërmend ta ndërtohet Shqipërinë, me teneqexhinjtë apo me këpucarët?»

Sabihaja u akuzua se bënte pjesë në një organizatë terroriste. Ajo nuk e pranoi akuzën për akte terroriste të paqena, për vënie në shërbim të agjenturave të huaja etj.

Sabihaja ishte një njeri i kulturës dhe i paqes.

Zonja Didi Biçaku, nga familja e Aqif pashë Elbasanit, e cila u arrestua në një kohë me Sabihanë dhe qëndroi në një birucë me të në burg, ka dëshmuar: “Më kujtohet çasti kur Sabihaja u ktheu nga hetuesia. Ishte e qetë. Hë? - e pyeta shkurt. - Më akuzuan si terroriste, m'u përgjigj. U thashë: Unë kam studiuar për biologji dhe jam evolucioniste. Evolucioni është në natyrën e gjërave. Me dhunë nuk shkohet dot as në socializëm, as në demokraci; shkohet drejt shkatërrimit.»

E vranë pa gjyq intelektualen, pedagogen, shkencë-taren, autoren e një libri, demokraten e shquar, martiren Sabiha Kasimatit! Në mesnatën e datës 26 shkurt 1951, të lidhur me tela me gjemba, bashkë me 21 burra nga e gjithë Shqipëria, i pushkatuan dhe i hodhën në një gropë të përbashkët, pranë Urës së Beshirit. Fshatarët kanë dëgjuar britmat e saj, deri sa dha shpirt. Eshtrat e saj sot prehen në varrezat e dëshmorëve të kombit, në një varr të përbashkët me 22 martirët e pushkatuar atë natë të përgjakshme.

Xha Kadriu nga Mëniku, rrëfen: “Më vonë, kur ai vend, ku u pushkatuan, filloi të shpyllëzohej, një traktoristi që po punonte aty, i ra të fikët tek pa që traktori tërhiqte zvarrë një kufomë gruaje, të cilën e mbuluan përsëri. Ishte trupi i patretur ende i Sabiha Kasimatit!”

Po shpirti i saj, vepra e saj, fryma e saj jeton, sepse është brenda nesh, brenda shpirtit të kombit, ndaj është e pavdekshme.

Romani “Mos harro të më kujtosh” i Liridon Mulajt Si një thirrje për dashuri, kujtesë dhe ndryshim...

Nga Adrian Zalla

Romani “Mos harro të më kujtosh”, i shkrimtarit Liridon Mulaj është një reflektim i vetë jetës, pothuaj i të gjithë cikleve të saj, mbushur me klishe, rënie në klishe dhe dalje nga ato, me shpërthime ngjarjesh befasuese, me marrje kthesash të papritura, me ngritje dhe rrëzime mitesh, me të vërteta e bestytni, i mbushur me gjithfarë ndikimesh popullore dhe elitare, si vetë jeta e cilitdo prej nesh, lexojmë e marrim leksione nga Frojdi dhe në darkë dëgjojmë përrallat e legjendat e gjysheve që mbase as të lexojnë nuk dinë...

Tadori është personazhi kryesor dhe zëri rrëfyes i romanit “Mos harro të më kujtosh”. Por kush është Tadori? Tadori jemi të gjithë ne, njerëz të vegjël dhe të pazë siç edhe ai thotë në historinë e tij, Tadori është tranzicioni 31 vjeçar të cilit nuk po i duket fundi asgjëkund, Tadori janë plagët e popullit tonë të thjeshtë e punëtor, Tadori është mish për top, krahëprerë për të fluturuar, Tadori jemi unë, ti, ai, ajo të gjithë ne që biem nga shiu në breshër dhe aty nuk është askush për të na ardhur në ndihmë, jemi të vetëm në një dhomë të mbushur me errësirë dhe të rrahur nga sistemi. Tadori na tregon sesi jemi trajtuar dhe vazhdojmë të trajtohem, Tadori është zëri i vuajtjes, i ndërjegjes që na kërkun me klithmë të rishkojmë të tashmen dhe rishkruajmë e jetojmë më mirë të ardhmen...

Autori ka guxuar me shkrimin e këtij romani të sjellë të paktën në tre rrafsh kryesore, në rrafshin e një analize panoramike sepse praktikisht romani është pasqyrë e një realiteti prej të paktën tri dekadash, ku depresioni kolektiv, histeria kolektive, si dhe uniformiteti, pra mungesa e individualizmit janë krejt normale në këtë shoqëri pa kurrfarë ekuilibrash por në kërkim të tyre, edhe pse nuk dinë nga t'ia nisin...

Plani i dytë është rrafshi i aktualizimit, mbushur me detaje prej tri dekadash, por edhe me detaje të viteve të fundit. Në historinë e Tadorit ende po luftohet për mbrojtjen e teatrit, por tanimë ne qeniet reale, pa asnjë ndryshim me qeniet në botën e Tadorit, e dimë si përfundoi historia e teatrit. Ai e mbush hapësirën e përshkrimit me plot detaje reale të artitekturës së kryeqytetit tonë por edhe me detaje të jetës politike, sociale e kulturore, por duke shfaqur një vërtetësi të plotë të përzier me një lloj cinizmi natyral, të cilit personazhi ynë nuk ia njej fillin...por ia mëson atë kur rrihet, shkëlmohej gjakoset e prek fundin vetëm sepse kishte thënë të vërtetën.

Autori ka rrezikuar shumë me paraqitjen e realitetit gati siç është por e shpëton me rendin e ngjarjeve, të kapitujve, të rendit të emocioneve, me zgjimin dhe vrasjen e shpresës, me kthesat që i jep, të cilat nuk mund ti parashikosh dot në kohë duke bërë një punë shumë cilësore dhe një roman dëshmitar i dekadave që lamë pas në kohë por që po i rijetojmë sërish në ditët e sotme...se jemi plakur por a jemi maturuar, a kemi ndryshuar, mund të pyeste Tadori.

Rrafshi i tretë që na paraqitet në roman është ai fikcional, sërish i përzier me grimca nga bota reale. Tadori është një djalë i ri me dëshira vetëvrasjeje, i cili përcaktohet nga ngjarjet që i ndodhin. Pas dështimit për të emigruar, vdekjes së nënës së tij, braktisjes nga e dashura, moslindjen e Ninos, lindjes së sëmundjes së mushkërive, trashëgimit të varfërisë drobitëse Tadorit i ngelet shumë pak për të jetuar edhe pse është në një konstante dorëzimi dhe mosdorëzimi gjatë gjithë romanit. Por ku është fikcionaliteti në këtë roman që na zbulon edhe rrafshin e tretë të romanit.

Humbja e njerëzve vjen si reminishencë e humbjes së kohës; mungesa e dashurisë kalon në fajësim dhe transferim faji, madje mund të shkojë deri në urrejtje, gjë që na shfaqet në kapitullin e parafundit, njehsimi i botës tonë me ferrin, i abortit me vrasjen, i braktisjes me harresën, i të vërtetës me absurden, dhe të drejtës me dënimin e padrejtë; përshkrimi i shokëve dhe shoqeve të klasës na vjen si humor grotesk prej sinqeritetit të zhveshur dhe tepëruar njëherazi, biseda me lypsin të cilat mund të jenë të frymëzuara nga Avniu i Elbasanit/filozofi i rrugës (njeri real) por që vijnë tërësisht në formën e fiction-it.

Nënvizimin e rëndësisë së fatit, ngritjen e mitit dhe thyerjen e tij në kaptullin: “Letër e munguar për Ninon”, ëngjëlli kthehet në vrasëse, trajtimi i abortit si vrasje e mundësisë së vetme për të superuar apo nisur një të ardhme të re mbushur me dashuri e shpresë; moslindja e Ninos i merr Tadorit të vetmen mundësi për të zëvendësuar, për të shlyer gjithçka nuk iu dhurua atij, marrëdhënia me Tason, Donaldin, ëndrrat dhe makthet, marrëzinë për t'i gjetur shpjegim çdo fenomeni; gjuha e bukur, e pasur, e kuruar që ndryshon nga standardi në zhargon dhe anasjelltas i japin masën e duhur të fikcionalitetit dhe e bëjnë veprën letërsi të mirëfilltë.

Taso dhe Tadori vallë një dyshe klasike? Nuk di ta them me siguri, por di të them që Taso mund të jetë prindërit tanë, gjyshërit tanë, i mbushur me përvojë jete dhe i ngopur me zhgënjime vjen si pragmatist me përgjigje të shkurtëra, të pa argumentuara por absolute; i ka sosur durimi për t'i rënë gjatë dhe i bie shkurt ndryshe nga Tadori që rreket të gjejë një arsye për gjithçka, për të shpjeguar çfarë i vjen në kokë, dhe në gjueti, për të gjetur të mirën ose për ta kthyer atë sadopak në jetën e tij por edhe në botën jashtë tij...

Romani është i mbushur me projeksione, përngjasmime dhe një thirrje për kujtesë. Për pasojë Tadorit i ngjan vetja me Tason por e projektun, ose thënë ndryshe, veten e sheh dhe e gjen te Donaldi. Për të Donaldi është e ardhmja, si dhe mundësia për të jetuar jetën që nuk mundi të jetonte vetë. Romani është thirrje për kujtesë siç edhe nënvizova më sipër, nisur kjo dhe nga fjalët që nëna i thotë në shtratin e vdekjes: “Tador mos më harro. Harresa e fshin njeriun përfundimisht, jo vdekja”, deri në një tjetër moment sublim në të cilin kemi të bëjmë me një lloj trashëndence, kapërcimi, tejkalimi, trashëgimie ku Tadori i kërkun Donaldit ti premtojë se nuk do ta harrojë asnjëherë dhe, ky është një çast ku lind një vëllazëri “gjaku”, ku të dy premtojnë që nuk do ta harrojnë asnjëherë tjetrin.

Dikotomia harresë-kujtesë e ndërtuar tanimë prej shekujsh është shtylla kurrizore me të cilën nis dhe përfundon romani. Për Tadorin braktisja, vetmia, vdekja dhe gjithçka e rëndë apo e konsideruar e ligë duhet t'i përkasë harresës dhe duke qenë se ka jetuar gjithë jetën mbi binarë të ndërtuar mbi këto ndjenja apo ngjarje, i tmerrohet atyre; ndërsa kujtesa për të është dritë, dashuri, përkujdesje, amshim është nëna e të mirave mbi këtë tokë, ai nuk e përcaqton dot kujtesën ashtu siç përkuqizon harresën me fjalët: “Harresa është përbindëshi që e vret njeriun”, sepse kujtesa për të është ndjenjë e fortë e cila për bazë ka dashurinë dhe ka shumë gjëra të cilat nuk kanë dhe nuk kërkun shpjegim...

Romani “Mos harro të më kujtosh”, vjen si një thirrje e fortë ekzistenciale më së pari, një thirrje e fortë për dashuri, kujtesë dhe ndryshim. Një thirrje e fortë që kërkun shlyerje e drejtësi për mëkatet dhe krimet e të shkuarës, që kërkun kujtesë dhe vlerësim për rrënjët nga vijnë, që kërkun triumf të së mirës mbi të keqen, që kërkun mundësi për të ndryshuar fatet njerëzore, që kërkun falje dhe përgjegjësi nga ata që kanë shkaktuar çdo gjë në këtë vendin tonë të vogël; kërkun një dorë ku të kapet, kërkun një fije përkujdesje dhe mbështetje, si dhe të dijë që nuk është vetëm...

Romani “Mos harro të më kujtosh” është një thirrje e fortë dashurie, kujtesë dhe nisje për ndryshimin, së pari në vetën e parë njëjës e më pas në vetën e parë shumës. Tadori kërkun ndryshimin e shoqërisë, kërkun një shoqëri ku jeta të jetë e vërteta dhe shpëtimi dhe jo e kundërta.

LIRIDON MULAJ

mos harro
të më kujtosh



OnufriRoman

BOTIMI RI

Alda Merini

E ÇMENDUN, E ÇMENDUN, E ÇMENDUN DASHUNIE PËR TY

Përktheu: Ledia Dushi

Alda Merini: Gjени i dashurisë

Poezia, dashuria, çmenduria futen njëkohësisht në jetën e Alda Merinit, një stuhi që e fshin, në adoleshencë, deri kur ajo arrin të fitojë forcën për ta përballuar, me pushtetin e fjalës. Duke treguar për vitet e kaluara në çmendinë, ajo padit përvojën më të dhimbshme: urdhrin që i jep mjeku që të mos dashurohet. Një urdhër që do të ngatërronte paradoksalisht, aftësinë për të kuptuar dhe dalluar, vullnetin dhe forcën për të vepruar. Nëse elemente të tilla do të ishin të pranishme, nuk do të mund ta justifikonin një urdhër të tillë, një ndërhyrje kaq prepotente në intimitetin e një personi: "Jam mjaft e bindur për të kuptuar se ku fillon patologjia e ku zë fill poezia. Janë dy momente krejt të ndryshme. Aspekti melankolik leopardian nuk ishte një depresion i zakonshëm që kurohet me qetësues..."

Alda Merini nuk ndien asnjë lloj turpi nga sëmundja e saj, por përkundrazi ka një kthjelltësi që e mbizotëron, e çliron duke e mbartur përtej hapësirës dhe kohës, përtej çdo ferri e çdo parajsje: "Dikush e ndaloj udhëtimin tim./ pa i ardhur keq për tingullin./ Edhe pse e shtrirë përtokë / këndoj për ty / këngët e mia të dashurisë."

Dashuria ashtu si poezia është diçka e patjetërsueshme, e pakorruptueshme dhe, aspak e dëmshme, është pikërisht kundërhelmi më i mundshëm i çmendurisë. Në vargjet e Merinit, Maria Corti zbulon një proces që shtrihet nga realja te vizionarja, një udhëtim drejt lartësisë, nga realiteti tragjik që ka të bëjë me sëmundjen, i cili e ka mposhtur, te realiteti i rifituar nëpërmjet kujtesës dhe i mundur nga triumfi i poezisë.

Ashtu siç nuk ka ndonjë afërsi të domosdoshme mes gjenisë dhe çrregullimit, aq më pak vlen krahasimi i artit me çmendurinë, dogma që e konsideron çmendurinë burim të frymëzimit poetik, që shikon te i çmenduri një qenie në njëfarë mënyre të privilegjuar, meqenëse është i aftë të shquajë dhe të ndiej të vërteta, që për pjesën tjetër janë të pamundura:

"Nuk është poezia ajo që të çmend, por rrethanat e jetës; jo çdo i çmendur është edhe poet". Përkundrazi, çmenduria ia dobëson fluturimin poezisë, ashtu si shumë rrethana të tjera të jetës, si turbullimi i realitetit, heshtja e një lënde të ftohtë, shterpë. Është fati i çuditshëm që "përpjek krahët e ngrata dhe fishk dashurinë". Çmenduria është mungesë, është humbje e ndjenjës, mungesë dashurie ("sepse mungesa e dashurisë / është vetë murtaja ime").

I ashtuquajturi "përdëllim" i përket poezisë dhe jo çmendurisë: poezia "është zë, frymëzim i së vërtetës, një zë që dikush e ka përbrenda e që e nxit të shprehet nëpërmjet muzikës, nëpërmjet një trupi, që është melodia". Poezia është "drita që ngadhënjën në mbrëmje", janë lotët e qiellit që i japin ngjyra jetës, është vaji i lehtësuar, i shndërruar në dritë të plotë që u rikthehet syve, që të jetojnë prej yjeve. Në vargjet e Alda Merinit vihen re dy botë metaforike: ajo e tokës shterpë, të ashpër dhe tërë pluhur, plot me hije, e errët, dhe ajo e qiellit, e lehtë, e kthjelltë, plot me drita dhe ngjyra. E para shpreh delirin e çmendurisë, që nuk zbulon por verbon, e dyta botën shëlbuese të poezisë dhe atë të mbarsur me dashuri, të afta ta hapin mjegullën e mendjes.

E vetmja çmenduri pozitive është ajo e dashurisë, e që shprehet në lirikën që i jep edhe titullin kësaj përmbledhjeje. Dashuria, dëshira, janë elementet krijuese, forca e groposur ndaj fjalës që lartësohet, fara që plazmon lëndën e zbrazët, vetëtima që ndriçon zonat e errëta me vezullime të befta e fluturake si një fill zëri ("pasionet e ethshme ta plazmojnë sërish / lëndën tashmë të vdekur: brenda teje pres / e kthyer nga jehonat në pafundësi").

Në poezitë e Alda Merinit dashuria, më shumë se një temë dominuese është shpirti që përshkon vargjet, është mekanizmi që vë në lëvizje fjalët. Personat konkretë, dashuritë e humbura apo të tashmet, janë tejkualuar nga ato që Maria Corti i quan "fantazma poetikë". Objekt i dashurisë është gjithçka që mund të nxisë tek ajo një "ngacimim përrallor të mendjes", një "mrekulli abstrakte", që tejkalon çdo përkufizim kohor e hapësiror.

Dashuria është dëshira e një tërësie mitike, nostalgji për

të pafundmen, "pafundësinë që mund të quhet muzikë / dashuri, o besim..." Është e ndrojtur dhe prepotente në të njëjtën kohë, e përhumbur dhe e tendosur, ashtu siç dashuria e adoleshencës ushqehet me veten, dashuri brenda dashurisë, dëshirë shkatërruese drejt diçkaje të papërcaktueshme. Nuk ka rëndësi kë dashuron, e rëndësishme është të dashurosh, sepse "kush dashuron, është gjени i dashurisë", i ka sytë të hapur ndaj bukurisë dhe ka dhuntinë e mrekullisë. Përtej dëshirës erotike, përtej dashurisë platonike apo mistike, dashuria jeton në një dimension zanafillor, ku e shenjtja dhe profania zmadhohen reciprokisht, ku të dashuarit "janë zotër të tokës / dhe aq pranë Zotit / si shenjtorë të përdëllyer".

Poezia e Alda Merinit nuk hap botë, por i sugjeron ato, jep shpresë, sfidon veten dhe të tjerët, me enigmat e saj. Grumbullon fragmente, zbulon gjurmë hyjnisht ikanake, hije të një bukurie që për një moment është shfaqur, jehona zhurmash dhe tinguj tashmë të zhdukur: "Zemra ime është pyll i shkretë, / i virgjër, dendur me hije dhe zhurma / të lehta, vegimesh fluturake, / ngarendjesh edhe më fluturake".

Dhe, atyre që mendojnë se poezia e Merinit është e vështirë, e çuditshme, hermetike, mund të marrin si përgjigje vargjet e Eugenio Montales: "Mos lyp prej nesh at' fjalë që shpirtin tonë amorf / anë për anë ta skuadrojë, e me shkronja zjarri / ta shpallë e ta ndriçojë si një lulëkuqe ari / degdisur në mes të një livadhi zhar [...] Mos prit prej nesh formulën që botë ty të shpalosin, / po veç ndonjë rrokje të shtrembët e dushk të thatë. / Vetëm këtë sot mund të themi, / se çka nuk jemi e se çka nuk duam.

ÇKA NDJEJ PËR TY

Çka ndiej për ty
asht e plotë si rinia
pa dridhje e puthje
a përgjërime t'përshpirtshme.
Ma i miri i librave
asht dashunia jonë
për letrën e bardhë
ku vështrimi
grish ndjenjën
dhe zenitin e hanës.



MBRAMË ISHTE VAKT DASHUNIE

Mbramë ishte vakt dashunie,
vetëm ti dhe unë
ikë e arratisë
me një puthje dhe një gojë
si në një pikturë abstrakte:
ti dhe unë të dashunuar
të dy mrekullisht.
Unë të stolisa dhe e thashë;
por ky emocion imi
shkoi shuar nëpër fjalë.

JAM E ÇMENDUN, E ÇMENDUN

Jam e çmendun, e çmendun,
e çmendun dashnie për ty.
Ankoj nga dhembshunia
ngase jam e çmendun, e çmendun,
ngase humbë t'kam.
Sot mëngjesit ishte aq nxehtë
e ndjehesha krejt e çoroditun,
ligë prore prej vuajtjes
ligë mbas tandes humbje.

JAM DASHUNUAR

Jam dashunuar
me krahët e mi prej engjëlli,
me vrimat e hundës që thithin natën,
jam dashunuar me veten
e me vuajtjet e mia.
Një lesë që gërmon n'brendësi t'sendeve,
apo ndoshta me t'u ba grua
humba tiparet e mia.
Je kaq i zhveshun, i dashun,
lakuriq dhe i pambrojtun:
unë jam lira e njëmendtë
që të godet mu në gjoks
e të çarmatos.

Tablo dimri

poezi nga **KLARA KODRA**

UJI I JETËS

... dhe vajza iku (nëpër shtigje përralle),
Iku në male, fusha, nëpër pyje
Që të gjente ujin magjik të gjallë...

Si ajo vajzë, rend dhe unë ndër shtigje,
Në vend që si dikur të qaj me ligje,
Të gjej ujin magjik që t'ju ringjallë,
Ju, nënë, baba, ju, miq që s'jeni më!
Po rend, po rend, po nuk po gjej asgjë
Të bëjë që jeta juaj të rinisë!

Asgjë... veç ujit magjik të poezisë.

Janar 2021

ORA E FUNDIT

Qe ora e fundit. Nxënësit e rrethonin
Si ndahet toka nga lulet do ndahej
Nga këta fëmijë që si zogj cicëronin.

Zëri i tingëllonte i freskët si dikur.

Hapi regjistrin. E pena lehtë mbi letër
Viza shënoi pranë emrave sikur
Pas saj do vinte prapë orë tjetër.

Thellë nga gjoksi i ngjitej një e çarë
Po e gëlltiti shpejt që të ishte
Kjo orë e fundit e gjallë si ora e parë.

Shtator 1980

MOTRËS NË DITËN E LINDJES

Erdhe, e mbështjellë me batanije të kaltër.
Shihje përreth me sy të ndritshëm të habitur.
Të priste, si copë qielli, krevati i kaltër.
Tej dritares e verdha e artë e mimozave.

Dilje nga një guvë e errët dhe rozë.
Sytë t'i vrau në fillim një dritë e bardhë.

Qenë ngjyrat e para të jetës sate.

28 mars 2020

LETRA DASHURIE

Ngjan se koha s'i ka prekur ato zarfe. Shkrimi
I bukur, i qartë i mamasë sime
Dhe shkrimi i pjerrët, i ngatërruar i babait
Flasin ende nga fletët e kaltra, të verdha, të bardha,
Flasin për dashurinë që dikur më lindi
Dhe që në gjakun tim vibron akoma
Dhe në gjakun e fëmijëve që kam pranë
Që s'janë të mitë e prapë janë të tillë,
Burbuqe flakë nga gjaku i vajzës tjetër
Që e pa dritën edhe ajo nga kjo dashuri.
Një karafil të bardhë e një të kuq
Në dorë mbaj. Aroma e ditës së sotme
Shkrihet me aromën e ditëve që fluturuan.

Shkurt 2021

KUJTIM I LARGËT

Këngët e festivalit të San Remos dikur
Gdhëndnim nëpër banka. Antena
Mbi çati vinim që të kapnim valët
Që nga perëndimi vinin. Në ato valë
Muzike zhyteshim të tërë si në det.
Ndjenim shije si prej fryti të ndaluar.
E prapë ishim aq naivë, aq të pafaj.
Atë gëzim fluror që ndjenim ne
E gjeni ju vallë sot në valët e Internetit?

Valët e kohës veç përpara rrjedhin.

Shkurt 2021

TABLO DIMRI

Mëngjes i ftohtë shkëlqimtar
Luftojnë diell dhe acar.
Toka e bardhë, qielli si ar.

-o-

Mimoza shtrin degët e saj
Si foshnja krahët drejt pranverës.
Qielli pikon lot të bardhë.
Tokën e shkundin shkulma ere.

-o-

Fëmijët klithin orë pa orë:
-O mami, borë! Ja, ku ka borë!
Në topa e mbledhin në dorë.

Shkurt 2021



Iben Akerlie

Shoku im kokëposhtë



BOTIMI RI

Iben Akerlie

SHOKU IM KOKËPOSHTË

Përktheu: Elvi Proko

Shtëpia botuese Dituria

Të jesh LOL në shoqërinë e sotme

Jetojmë në epokën e celularëve, internetit, rrjeteve sociale. Dita e shumë prej nesh përqendrohet e kufizohet nga të qenit në qendër të vëmendjes, të qenit "cool", marrjes së "like"-ve në Facebook apo Instagram e pasjes së sa më shumë "friends"-ave apo "followers"-ave o, ndjekjes së "blog"-eve apo të "influencer"-ave... E thënë ndryshe, dita e shumë prej nesh përqendrohet te dukja, sipërfaqësorja, zbrazëtia.

Pikërisht në këtë kontekst na shfaqet Amanda, një vajzë e urtë dhe e turpshme, ëndërrimtare por jo e guximshme, e drejtë por e tërhequr, dëshira e vetme e së cilës është të mos bjerë në sy, të jetë – siç thotë ajo – asnjansë, e të mund të ëndërrojë e qetë, si shumë adoleshente të moshës së saj. Me fillimin e vitit të ri shkollor, bota e Amandës do të përmbysset krejt, pasi do t'i caktohet nën patronazh – kundër vullnetit të saj - një djalë me sindromën Down, Larsi, e siç mund ta marrim me mend, askush nuk do të donte të ishte kujdestar i tij, e as Amanda. Larg çdo pritshmërie, Larsi do të bëhet miku i saj më i mirë, me të ajo do të mësojë të jetë vetvetja, pa qenë e paragjykuar, e do të kuptojë kotësinë e antivlerave me të cilat është mbrujtur rinia bashkëkohore. Pikërisht këtë kontrast, autorja e këtij bestselleri prekës dhe emocionues e ravijëzon duke vënë përballë miqve të Amandës, Larsit të çiltër, elementeve të mbartura nga bota magjike e Harry Potterit, blog-un e pamëshirshëm të Anës dhe Kristinës.

Pikërisht në këtë çast, Amanda do të zbulojë se Larsi është bërë objekt talljesh në shkollë. E ky realitet e tmerron dhe e lëndon. Si do të veprojë Amanda? A do të arrijë ta mbrojë Larsin prej bullizmit, apo do të rrezikojë të bëhet edhe ajo shënjestër e këtij të fundit? Çfarë do të mendojnë vallë për të Adami shpërfillës, shokët moskuptues të klasës dhe vajzat e pamëshirshme "në modë"? A ekziston ndonjë mënyrë për t'u fshehur a për t'u arratisur, apo do t'i duhet ta luftojë a përqafojë atë?

"Por Larsi është LOL", shprehet Larsi, duke ia çjerrë maskën e kotësisë shoqërisë së rrjeteve sociale, duke shfaqësuar madje edhe bullistët e vet dhe duke shpallur triumfin e vlerave të miqësisë, dashurisë e çiltërsisë. Në një shoqëri që emancipohet me hapa të vegjël, por që gjithashtu nuk resht së huazuari elementet më bashkëkohore të modave të cekëta, siç është edhe shoqëria shqiptare, besoj se ky libër do të ketë një ndikim të rëndësishëm dhe do t'u përçojë vlera të larta lexuesve të rinj.

Nga Elvi Proko
Përkthyesi i librit

Çfarë po ndodh me arbërishten?

Nga Edmond Cane

Çfarë po ndodh me arbërishten?

Përgjatë dekadave të fundit, dhe përgjatë edhe shqetësimeve në rritje për bjerrjen e arbërishtes në komunitetin italo-shqiptar në Itali, po artikullohet për një kohë të gjatë futja e mësimdhënies së arbërishtes në shkolla. Ndjesitë në hapësirën shqiptare janë kryesisht pozitive për orientimin e favorshëm të shtetit italian për mbështetjen dhe inkurajimin e arbëreshëve, promovimin e gjuhës, kulturës, trashëgimisë dhe identitetit të tyre etnik. Në 1999 Italia aprovoi edhe një ligj në mbështetje të minoriteteve gjuhësore në Itali (12 komunitete të tilla), mbi bazë të të cilit këto minoritete gjuhësore mund të kërkojnë dhe të përfitojnë vëmendjen dhe mbështetjen shtetërore italiane. Kjo vëmendje përkthehet në projekte të rëndësishme, dhe më tej, në rezultate që përbëjnë një kontribut me vlerë lidhur me vijimësinë e arbërishtes dhe arbëreshëve në tokën italiane. Sidoqoftë, kjo ka funksionuar përgjithësisht në sferën kulturore,

Sa më sipër është një tablo ndërtuar mbi perceptime, konstatime, informacione dhe të dhëna të përgjithshme, që pak a shumë e ndajnë shumica e arbëreshëve (në Itali) dhe shumica e shqiptarëve (në hapësirat përkatëse etnike në Ballkan). Në këto vlera, kjo tablo konfirmohet edhe në krahasimin horizontal, ndër rastet paralele të minoriteteve shqipfolëse në shtete të tjera, si dhe në krahasimin përgjatë aksit historik të kësaj çështjeje.

Nga ana tjetër, në dritën e qasjeve gjuhësore, si dhe të disa zhvillimeve të sotme, kjo tablo nuk duket sot aq e rëndësishme.

Katastrofa e sotme gjuhësore

Gjuhë të ndryshme janë shuar ndër shekuj dhe ky fenomen nuk do të përbente ndonjë çudi. Por, zhdukja e tyre me këtë ritëm të përshpejtuar, përbën, sipas gjuhëtarëve, një katastrofë humane. Ky është të menduarit në sferën e gjuhësisë duke filluar nga vitet 1990'. Nëpërmjet argumenteve të qarta, mbështetur mjaftueshëm me studime dhe të dhëna të shumta, të shumë-konfirmuara, vlerësimeve të shumanshme – gjuhëtarët kanë konfirmuar shkallën e jashtëzakonshme dhe të përshpejtuar të kësaj zhdukje masive dhe sensibilizuan autoritetet përkatëse, shtetet përkatëse. Edhe super-institucionet u vunë në lëvizje: UNESCO, BE, platforma ndërkombëtare, europiane, rajonale. Ligji që mbron minoritetet gjuhësore në Itali në 1999, më tepër se një iniciativë italiane, duket se është "vijim i kësaj komete". Në këtë krahasim, përveç konceptimit dhe zhvillimit, edhe stadi i zbatimit në Itali, kundruar me shumë situata dhe procese të gjuhëve të tjera minoritare, lë shumë për të dëshiruar, pavarësisht se kjo nuk vë në pikëpyetje vullnetin dhe qëndrimin dashamirës të autoriteteve italiane.

20 vjet pas vlerësimeve të para, të dhënat janë më të shumta dhe më të plota. Gjuhëtarët kryesorë* kanë vlerësuar dhe provuar se vazhdon tendenca bjerrëse. Më shumë se 75 për qind e gjuhëve minoritare në Australi, Kanada, SHBA, të cilat lëvroheshin të paktën deri në 1950, janë ose të shuara ose në fazën e parafundit të shuarjes së tyre. Por, në Afrikën Sub-Sahariane janë vetëm 10 për qind. Po konstatohet tashmë se 19 për qind e gjuhëve të botës nuk po transmetohen tek fëmijët.**

Në dokumentin e UNESCO-s 2003, përcaktohen nëntë faktorë për të vlerësuar vitalitetin e gjuhës (ose në të kundërt, bjerrjen e saj)

- i) Transmetimi ndër breza
- ii) Numri absolut i folësve
- iii) Proporcioni i folësve kundrejt popullsisë në fjalë
- iv) Përdorimi i gjuhës brenda domeneve dhe konteksteve ekzistuese
- v) Reagimi në përdorimin e gjuhës në domene të reja dhe në media
- vi) Disponueshmëria e materialeve për arsimimin gjuhësor
- vii) Politikat gjuhësore institucionale dhe qeveritare
- viii) Qëndrimi i komunitetit kundrejt gjuhës së tyre
- ix) Sasia dhe cilësia e dokumentacionit

Për secilin faktor janë një grup treguesish që ndihmojnë drejt një vlerësimi sasior dhe cilësor më të saktë, duke mundësuar edhe një referim apo vlerësim krahasues ndër gjuhëve minoritare. Studimet e shumta, veçanërisht, përgjatë

tre dekadave të fundit kanë krijuar një tablo të pasur për të parë dhe për të kuptuar më mirë si planin e kërcënimit aktual ndaj gjuhëve specifike, shkallën masive të kësaj humbje, perspektivat reale, por edhe vitalitetin aktual, si dhe atë potencial për një numër të konsiderueshëm të këtyre gjuhëve për të mbijetuar.

Lidhur me arbërishten nuk ka pasur studime të organizuara përgjatë këtyre linjave. Pamundësia e informacionit, e dijes në sasi dhe në cilësi nuk na lejon të përcaktojmë qartë çfarë po ndodh dhe në cilat nivele është arbërishtja, dhe në vijim, çfarë specifikisht mund të bëhet, kush mund apo duhet të bëjë çfarë, cilat janë prioritetet apo urgjencat më të mprehta, cilat janë pikat e dobëta dhe cilët faktorë të vitalitetit do të duhet të jenë në qendër të politikave për rigjallërim të gjuhës.

Bazuar në vëzhgimet në shumë raste studimore, hapi i parë përcaktues drejt vdekjes së gjuhës është *rrezikimi potencial*, për shkak të presionit të jashtëm, por ndërkohë komuniteti i folësve vazhdon të transmetojë gjuhën në familje. Faza më tej është *rreziku real (definitely endangered)*, i konfirmuar, kur pakësohet numri i folësve dhe fillon të rrezikohet transmetimi i gjuhës te fëmijët. Më pas vijon faza e *rrezikut kritik*. Këtu, gjuha nuk ka shumë gjasa të mbijetojë tek brezi tjetër i folësve dhe shpejt do të shuhet. Ka një fazë të katërt që në gjuhën e ekspertëve referohet "moribund" që është gjallimi i fundëm, duke shkuar drejt fazës 5 – *humbjes së gjuhës*. Në fazën e parafundit nuk ka më folës të rinj të gjuhës pasi gjuha ka pushuar së transmetuari. Në këtë fazë ka një numër të kufizuar folësish të mbetur, bartësit e fundit.

Lista e UNESCOs 2010*** ka një vlerësim zyrtar për arbërishten – *në rrezik real*, që i korrespondon nivelit diku në mes të këtij shkallëzimi mes fillimit të bjerrjes dhe shuarjes së plotë. Është një konfirmim që ka hyrë në rrjedhën e shuarjes – në mënyrë definitive. Për arbërishten nuk ka pasur studime të mjaftueshme, por megjithatë kjo gjendje është qartësisht e dukshme. Studimet e deritanishme kanë konstatuar rrjedhën e bjerrjes së vijueshme të gjuhës në komunitetin arbëresh. Arbërishtja e Zarës dhe gjuha e arvanitasve në Greqi vlerësohen në një nivel më të përkeqësuar – në fazën e *rrezikut kritik*.

Humbje për kë?

Duhet vënë në dukje që, së pari, kjo është humbje për komunitetin arbëresh në Itali. Në politikat, qëndrimet, këndvështrimet, si dhe në debatet e ndryshme, është e rëndësishme të respektohet ky paritet dhe kjo pronësi e parë ndaj gjuhës. Nëse gjuha do mbijetojë apo jo, nëse duhet dhe do të ndërmerren strategji, politika, veprime në funksion të kësaj, mbetet në radhë të parë diçka që ka si protagonistë kryesorë, dhe humbës të parë, vetë arbëreshët. Ky përcaktim ka nevojë të vihet në pah dhe të shmangë qëndrime të patakt apo deri paternaliste në këtë anë të detit, ndërkohë që paternalizmi do të shkaktojë reagimet përkatëse, distancuese. Kjo do të ishte e pafavorshme pikërisht në këtë situatë që kërkon strategji dhe zbatim të orkestruar.

Pavarësisht qëllimeve më të mira, institucionet në Shqipëri janë aktorë të jashtëm për arbërishten e rrezikuar, dhe nuk kanë shumë mundësi të jenë të efektshëm apo të suksesshëm. Kjo nuk nënkupton megjithatë mënjanimin në një qëndrim pasiv. Përkundrazi, institucionet në Shqipëri kanë kapacitete, mundësi, mjete dhe mund të kontribuojnë vlera shumë të rëndësishme, mund të ndihmojnë për ndërgjegjësimin, të japin kontribute gjuhësore, kurrikulare, koordinojnë në zhvillimin dhe zbatimin e programeve, të ndihmojnë në lidhjen mes koncepteve për programe dhe burimeve financiare, etj. Mund të kenë rol deri vendimtar. Sidoqoftë, së pari janë pjesëtarët e komunitetit që duhet të jenë pjesë e iniciativave, programeve, vendim-marrjes.

Humbje shqiptare

Ndoshta nuk jemi shumë të vetëdijshëm, edhe për shkak të vlerësimeve klishe për mendimtarët dhe veprimtarët e Rilindjes Kombëtare, që në kushte të turbullta ata arritën të ndërtojnë një entitet shtetëror, në një hapësirë kombëtare



reale. Sot mund ta kuptojmë më mirë, në kushtet e zbehjes së hapësirave të caktuara, kur nuk jemi të sigurtë nëse do të kemi kapacitete etnike dhe konjitive, dhe sidomos frymë, për të mbajtur këto hapësira (arbëreshët, arvanitasit) në lidhje etnike dhe identitare. Sfida po bëhet edhe më e prekshme, pasi ndoshta po humbim edhe diasporën më të re të larguar në vitet e fundit.

Humbje humane

Humbja e gjuhëve shihet si unike në kohën tonë. Është e çuditshme që ka pasur një vëmendje dhe preokupim të gjerë për shfarosjen e specieve të ndryshme, e cila nga ekspertët është vlerësuar në nivelet e shuarjes së 7.4 për qind të specieve gitare dhe 2.7 për qind e specieve të zogjve. Sigurisht nuk janë të pakonsiderueshme, sidomos për impaktin në ekosistem. Por nuk ka të krahasuar, në sasi dhe në cilësi me humbjen masive të gjuhëve, dhe perspektivës në vitin 2100, ku jo më pak se 50 për qind (disa gjuhëtarë vlerësojnë deri në 60 për qind, dhe disa deri në 80 për qind) e gjuhëve aktuale do të jenë shuar.

Në planin konjitiv dhe gjuhësor

Në këndvështrimet e teorive të sotme gjuhësore, parashtrihet (jo thjesht në mënyrë figurative apo deklamative) se një gjuhë është një mënyrë njerëzore të menduarit, një variant, një alternativë konjitive e caktuar, e papërsëritshme në llojin e vet. Për shkencat konjitive (psikologji konjitive, gjuhësi konjitive, antropologji, etj.), këto gjuhë janë bërë tashme burime të dhënash primare për të kuptuar dhe shpjeguar evolucionin e strukturave gjuhësore por edhe konjitive. Pra, është humbje e diversitetit kulturor dhe intelektual, në një globalizim të skajshëm, ku gjuhët dominante gllabërojnë masa të mëdha gjuhësh minoritare, por njëlloj të vlefshme në fondin e kulturës dhe dijes botërore. Sipas Ken Hale,**** humbja e gjuhëve lokale dhe e sistemeve kulturore që ato shprehin, nënkupton një humbje të pazëvendësueshme të thesarit interesant dhe divers, të produkteve të paçmuara të industrisë intelektuale njerëzore

Këndvështrimi europian

Shumë ekspertë, studiues të shkencave humane, por edhe politikanë e filozofë, e shohin si një humbje përtej komunitetit rajonal. Veçanërisht Europa ka vënë në themel të zhvillimit dhe gjallimit të vet, filozofinë e diversitetit kulturor, që përfshin në mënyrë specifike, deri kuadër ligjor të BE-së, edhe diversitetin gjuhësor. Bota perëndimore në përgjithësi është e prirur të shikojë diversitetin si burim thesari dhe zhvillimi. Shkencat humane ndërkohë na provojnë se përgjatë evolucionit, diversiteti i specieve në përgjithësi, dhe homo-sapiensëve në veçanti, kanë qenë paralel me avantazhet e tyre përkundër specieve të tjera dhe shanseve për evolim. Edhe shkalla e diversitetit ka qenë në përpjesëtim të drejtë me shkallën/hopin e evolimit. Kjo rrudhje e speciet në planin gjuhësor, sigurisht që përbën arsye për preokupim - në nivel të species. (Besoj se prirja për të parë legjislacionin e zhvilluar të BE-së në këtë sferë si burokraci e Brukselit, është e nxituar, pasojë e mosdijes në lidhje me sa më sipër)

Faktori kryesor që ka gjeneruar këtë situatë kërcënuese

Në dekadat e mëparshme, vdekja e gjuhëve lidhej kryesisht me politikën kolonialiste, politikën represive nacionaliste të kombit dominues kundër pakicave. Sot, shkaqet e humbjes variojnë nga gjenocidi, shkatërrimi i habitatit social-ekonomik, zhvendosjes së popullsisë, shtypjes nëpërmjet arsimit të detyruar asimilues deri te 'bombardimi mediatik', sidomos nga TV, një armë e re jashtëzakonisht letale - që Michael Krauss e ka quajtur 'gaz nervin kulturor'.

Në lidhje me lëvizimin e gjuhës, shohim nga njëra anë

**** Ken Hale – Kongresi Ndërkombëtar i Gjuhësisë 1992, Quebec.

* Të dhëna bazuar në EGIDS - Expanded Graded Intergenerational Disruption Scale (Lewis & Simons 2010)

** Michael Krauss, Ken Hale, Lewis, Simons & Fennig 2013, etj.

*** Atlas i UNESCO-s për Gjuhët e Botës në Rrezik kategorizon 2473 gjuhë sipas nivelit të rrezikut. Gjatë tre brezave të fundit, janë shuar tashmë 200 gjuhë.

pafuqi institucionale, dhe nga ana tjetër një rënie të peshës së familjes dhe strukturave më të vogla sociale. Paralelisht, makrostrukturat po shfuqizojnë intensivisht familjen dhe strukturat e vogla. Në lidhje me çështjen në fjalë, superstrukturat e superfuqizuara janë inerte ose tepër të plogështa të rikapin këto vlera të neglizhuara. Ndoshta do të duhet një kohë më e gjatë të kemi makrostruktura më efikase dhe më funksionale (apo inteligjente), por në këtë moment, ky faktor nuk është në nivel të favorshëm. Përpyqje po bëhen në shumë zona në botë, dhe ndoshta mund të arrijnë që në masën më të madhe ta ndalin këtë bjerrje. Pyetja e rëndësishme për ne është nëse arbërishtja do të ketë aq fat të jetë në anën e gjuhëve të mbijetuara në këtë moment kritik.

Çfarë duhet bërë?

Gjuhëtari Michael Kraus, në prezantimin e njohur përpara Shoqatës Amerikane të Gjuhësisë në 1991 përgjigjet se “*Ajo çka ne duhet të bëjmë na qëndron para fytyrës...Nëse ne nuk veprojmë, brezi që do vijë do të na mallkojë që në stilin Neronian, i binim violinës ndërsa Roma digjet*”

Institucionet e interesuara dhe të specializuara mund të bëjnë shumë. Ka modele të suksesshme, por është problem aktivizimi i tyre, drejtimi i vëmendjes dhe impenjimit të tyre. Italia ka 12 gjuhë minoritare dhe kapacitetet institucionale ndoshta nuk arrijnë të investohen mjaftueshëm në secilën prej gjuhëve të rrezikuara. Aktorët e tjerë të rëndësishëm janë institucionet arbëreshe dhe ato shqiptare, që mund të plotësojnë njëra-tjetrën. Nëse çdo gjë do të mund të organizohet efektivisht, do të mund të realizonim studimet e nevojshme për të vlerësuar dhe analizuar gjendjen e të folmes kundrejt parametrevë që kanë përcaktuar ekspertët, do të mundësoheshin mekanizmat për të rigjallëruar transmetimin në familje duke e riorganizuar në kushtet e sotme mbi bazë të sistemit arsimor, pasi ky i fundit ka dalë primar përsa i përket strategjive për mbijetesën e gjuhëve. Eksperiencia e deritanishme gjithashtu nxjerr në pah pamjaftueshmërinë e thjeshtë disa orëve mësim arbërishte në shkolla. Ka shumë argumente dhe eksperiencia që rekomandojnë se këto kërkesa modeste nuk kanë shans të jenë të suksesshme dhe mund të rezultojnë humbje kohe. Praktikant shumë afër nesh, për gjuhën baske, katalane, gale, etj. demonstrojnë nevojën dhe rëndësinë e një pakete të plotë arsimore, që fëmijët të mësojnë lëndët kryesore të dijes në këtë gjuhë amtare, minimalisht, mësim gjuhe, mësim historie, lexim etj., nëpërmjet arbërishtes. Nevojitet një kurrikulë e plotë përgjatë arsimit fillor dhe të mesëm, që të krijojë bazat e strukturimit dhe praktikimit të arbërishtes standarde, që tashmë është mbuluar totalisht nga italishtja dominuese. Këto hapësira duhet të fillojnë të balancohen gradualisht, përndryshe, një arbërishte e rrudhur, inferiore, pa vlera dhe mundësi për jetën, karrierën, kuadrin social, nuk ka shans të mbijetojë.

Gjuha dominante, italishtja në këtë rast, shihet si gjuha që të drejton nga mundësitë social-ekonomike. Përpyqja për rigjallërim të arbërishtes nuk kërkon qëndrime donkishoteske për të hequr dorë nga shanset për zhvillim arsimor, kulturor, intelektual dhe profesional të fëmijëve arbëreshë, që përgjithësisht janë në gjuhën dominante – në italisht. Synimi është të ndërtohen kanalizime të tilla që ky zhvillim të mundësohet nëpërmjet arbërishtes. *Ndonëse duket sfidë e vështirë në kontekstin italian*, nuk ka qenë e tillë për raste paralele për gjuhë minoritare në Europë. Ndryshimin duhet ta bëjnë me kontribute zhvilluese dhe ndërtouese së pari komuniteti arbëresh, institucionet e specializuara për programet arsimore, kuadrin kurrikular, kuadrin e gjuhëve të rrezikuara, institucionet e dijes dhe kulturës, elementët komunitarë dhe në tërësi, shteti italian do të duhet të programojë dhe aplikojë një mision të tillë tepër të komplikuar.

Avantazhet e bilingualizmit kanë qenë kryesisht në plane deklarative. Por nga ana tjetër, ka të dhëna shkencore dhe rezultate që tregojnë aftësi më të larta konjitive të folësve dy-gjuhësh përkundër atyre që flasin vetëm një gjuhë të vetën. Faktikisht, kur këto aftësi nuk janë të zhvilluara dhe të kultivuara, nuk arrijnë të shfrytëzohen në këtë drejtim dhe, në këto nivele të pak-zhvilluara, nxënësit dhe studentët me gjendje dygjuhësie ndiejnë se bilingualiteti i tyre, dhe veçanërisht statusi dhe potenciali social, profesional i gjuhës së tyre lokale, nuk është një faktor i favorshëm në përpyqjet për jetën, mirëqenien sociale, profesionale, etj. Por, nëse këto kultivohen dhe shfrytëzohen, ato sigurojnë avantazhe kundrejt pjesës tjetër.

Epilog

Qasja dhe argumenti më sipër nuk e përmbysin plotësisht tablonë krye të këtij shkrimi, sidomos përsa i përket thelbit të raportit/marrëdhënies dashamirëse mes minoritetit arbëresh dhe shtetit italian. Megjithatë, e orienton në tjetër kah dhe shtron një sërë pikëpyetje dhe problemesh përballë aktorëve të përfshirë rreth kësaj çështje – pra, sugjeron që duhet të ketë një tjetër tematikë diskutimi mes tyre në funksion të ndërtimit të politikave për mbijetesën e gjuhës, vlerave, identitetit arbëresh.

**** Michael Krauss, në fjalën përpara Komitetit të Senatit (2000)

(Homazh për poetin arbëresh, Zef Kakoca)

SHEMBJA E URËS MBI DET

nga Arben Veselaj

Javën e tretë të këtij frori me borë dhe acar, qielli i Arbërisë së Vjetër të përtejdetit, u shndritë për një çast nga bardhësia e shpirtit të poetit, këngëtarit dhe atdhetarit të madh arbëresh, Zef Kakoca. Ai hoqi frymën e fundit në një spital të Kantazaros në Itali, në moshën 64 vjeçare. Zefi, apo Pino Cacoza, siç njihej me emrin përkëdhelës, që njëri nga pasardhësit e rrallë të arbërorëve fisnikë që e pasuan me krenari flakadanin e qytetërimit evropian të shqiptarëve, bartur në tokën italice, pesë shekuj më parë. Ai që njëri nga intelektualët e rrallë i cili tërë jetën ia kushtoi ruajtjes dhe promovimit të kulturës identitare arbëreshe: arbërishtes së vjetër, letërsisë, e sidomos të muzikës legjendare arbëreshe. Në mesin e arbërorëve të Kalabrisë që në vitet ‘70-të emri i tij u bë i njohur si poet dhe kantautor. Duke qenë se kishte studiuar letërsinë frënge, poezia e tij, edhe pse e formatit dhe e strukturës klasike, përvijon doemos traditën e rapsodive legjendare arbëreshe, me mallin për atdheun e humbur dhe melankolinë monumentale përbrenda. Poezia e Zef Kakocës edhe pse i ka të gjitha shenjat e modernitetit letrar, megjithatë, brenda saj e ruan ndjeshmërinë e pararendësve të tij romantikë, sidomos të poetit që ai e kishte për zemër, Jeronim De Radës. Në poezinë e Zef Kakocës gjen vend një vizion i ri i shikimit të botës; edhe pse në një kontekst ekzistencialist ai asnjëherë nuk i shmanget kontekstit historik. Emri i Zef Kakocës si poet radhitet mes emrave më të nderuar të poezisë arbëreshe të gjysmës së dytë të shekullit XX, si: Voreo Ujku, Karmel Kandreva, Dushku Vetmo, Lluqa Perrone, Zef Skiro Di Maji, Pietro Napoletano, Agostin Xhordano, Enca Skutari, Mario Bellici etj.

Në botën arbëreshe Zef Kakoca që i njohur jo vetëm si poet e profesor i gjuhës dhe i letërsisë, por edhe si këngëtar virtuoz. Me angazhimin këmbëngulës gjatë tërë jetës ai u konsiderua përfaqësues i këngës poetike arbëreshe, apo siç e kanë quajtur shpesh: “pasues i rapsodisë tradicionale arbëreshe”. Paraqitjet publike në skenën e Festivalit të Këngës Arbëreshe, me recitalet e njohura muzikore - teatrale, si: “De Rada dhe Milosao”, “Rrënjët e Arbërisë”, “Udhëtimet e Arbërisë”, “Homazh De Radës” etj., zbuluan talentin e rrallë të tij si këngëtar, dhe, në përgjithësi, si një artist ambivalent.

Për disa javë rresht, Zef Kakoca, e vuajti një sëmundje të papritur, e cila nga një ftohje e lehtë në mushkri, shpejt u bë mort për të. Unë e njoha në verën e vitit 2019, përmes mikut tim, poetit dhe kantautorit nga Prishtina, Ilir Shaqiri. Kishte vite qëkur Iliri e Zefi kishin një miqësi shumë të sinqertë, shkonin me njëri-tjetrin si dy vëllezër. Ata sikur e kishin kërkuar shumë gjatë, dhe, më në fund, e kishin gjetur njëri-tjetrin në magjitë dhe misteret e këngës shqipe. Ilir Shaqiri dhe Zef Kakoca qenë inspirim për njëri-tjetrin ... mbase nga miqësia e tyre do të mund të jenë shkruar edhe dy romane: “Lemza e Dheut” (Ilir Shaqiri) dhe “Toka e Yllit” (Zef Kakoca). Ishin takuar për herë të parë në kryeqendrën e arbëreshëve të Kalabrisë, në Shën Mitër Koronë. Nga një cep i sheshit “Skënderbeu”, Zef Kakoca i kishte thirrur Ilirit me zërin e tij skofiar: “Oj, vëlla, kush të sollti te udha ime?”

Për shumë vjet, Zefi dhe Iliri ia thanë dyzërash këngës shqipe duke shkruar brenda saj epikën e veriut shqiptar dhe rapsodinë

arbëreshe. Këngët që kënduan bashkë këta dy artistë, si: “Jam arbëresh”, “Ura mbi det”, “Duro Zemër” etj., i dhanë karakter përtëritës lidhjeve vëllazërore mes kosovarëve dhe arbëreshëve. Njëra prej këngëve që ata bashkë e shkruan dhe e kënduan (“Ura mbi det”) seç ka një paralajmërim: “Po zgjohet dielli, një dritë e re, po lidhen brigjet mbi atdhe”. Ky varg ngjante me një ogur të bardhë për një “urë të gjallë” mbi det, të cilën Zef Kakoca dhe Ilir Shaqiri bashkë po përpiqeshin ta ngrehnin.

Shpesh mendoja me vete se sa me fat isha që e kisha takuar Zef Kakocën, që kisha lidhur miqësi me të. Duke iu falënderuar atij në vitin 2020 arrita ta realizojë librin “Triptikon arbëresh”. Shpresoja që me ndihmën e Zefit sërish do të mund të shkoja në Kalabri e Sicili, për ndonjë projekt tjetër ... kushedi, mbase në kërkim të gjenezës së letërsisë shqipe. Por, papritmas, gjithçka u përmbys. Miqtë tanë nga Kalabria, në vend që të na përcillnin ndonjë video nga ndonjë koncert apo recital të Zef Kakocës, siç bënim rëndom, këtë të diel na përcollën videon funebre nga varrimi i tij.

Gjatë udhëtimit nëpër katundet arbëreshe, në vitin 2019, Zef Kakoca jo vetëm që na priti e na përcolli me shumë ndere, por ai na u bë edhe udhërrëfyes i rrugëtimit tonë. Mes shumë gjërave interesante që Zefi na rrëfeu gjatë atij pelegrinazhi të paharrueshëm, që një moment kur na ftoi që t’i vizitonim varrezat e Shën Mitrit, për t’u njohur nga afër me kulturën funerale të arbëreshëve. Ai na dëftoi varrin e familjes së tij. Aty i pushonin përjetësisht të dy prindërit, Luigji dhe Paskualina. Varrezat e arbëresheve në të vërtetë ishin pasqyra më reale e kulturës dhe shpirtit arbëror që gjallon në brigjet perëndimore të detit Jon. Më shumë se prej shumëçka tjetër, nga gurët e varreve ata sikur duan të na rrëfejnë fisnikërinë e tyre të lashtë. Vezullima e kryeve madhështore mbi secilin varr e bënte disi pikëllues atë shkëlqim të fshehur pas atij mali me lisa të lartë. Iliri dhe unë e ndoqëm nga pas Zef Kakocën sikur në një procesion, derisa ai ndaloi te varri i familjes së tij. O zot, një varr për një familje, këtë s’e kisha parë kurrë! Katakombi i familjes Kakoca ishte një arkemort i madh prej mermeri, varret ishin të futura në muret e katakombit. Aty kishte dhe një të tillë të zbrazët. Zefi tha se ishte varri i tij.

Kur dolëm në parkingun e varrezës, Zefi u përkul në tokë dhe mori një guralec. Pasi u sigurua se po e ndiqnim se çfarë do bënte, e hodhi guralecin pas shpine. “Guri i hedhur”, - tha Zef Kakoca, “është një rit i lashtë, si një dëshirë e hedhur, që kur të vdes fati të më sjell sërish këtu, për t’u prehur përgjithmonë!” Duke e shikuar Zefin me habi, gati sa s’më shpëtuan lotët. Atë çast m’u kujtua një fjali e mjeshtrit të madh të prozës shqipe, Mitrush Kutelit, i cili në një reportazh që kishte shkruar për Prizrenin në vitin 1942, ndërsa i përshkruan varret e ortodoksëve shqiptarë, na jep një nga tablotë më të ndiera të letrave shqipe: “Vaje e lot shumë - kështu është ortodoksia: mistike, sentimentale, lakrimogjene”.

Ndërsa po i shkruaj këta rreshta dhe po e kujtoj këtë episod me Zef Kakocën, po ndihem si me faj, sepse në librin “Triptikon arbëresh” krejt padashur e kisha përshkruar varrin bosh të Zef Kakocës. Tani që përgjithmonë po prehet aty, jam i bindur se do të jetë njëri nga varret më të mëdha të arbërorëve të përtejdetit.



QASJE NDRYSHE NDAJ ROMANIT “DIKTATORI NË KRYQ” TË MIRA MEKSIT

Nga Floresha Dado

Jo rastësisht shtroj pyetjet: Cili është raporti midis titullit të romanit dhe strukturës së brendshme *kuptimore* të tij? Cila është filozofia e vërtetë e veprës? A është figura e diktatorit dominantja dhe kontributi më i madh i autores, siç është thënë për këtë roman?

Ta vlerësosh romanin e M.Meksit vetëm për krijimin e figurës së diktatorit (që sigurisht vjen për herë të parë në letërsinë tonë në një pikëvështrim të veçantë, original), ende nuk kemi rrokur botën komplekse filozofike që përbën vlerën e vërtetë të tij, do të thotë që me imagjinatën tonë interpretoese nuk kemi depërtuar tërësisht në marrëdhëniet e brendshme midis medimit të personazheve, lidhjes së mjediseve të ndryshëm në kohë dhe hapësirë, nuk kemi zbuluar plotësisht kuptimin e raporteve midis *pjesëve dhe së tërës*. Subjekti i romanit, i marrë në tre linjat e tij, nuk është thjesht veprimi i jashtëm, por një komponent në veprim të vazhdueshëm në lëvizjen e brendshme, në afrimet dhe largimet, në përjasjet apo kundërvëniet e skenave dhe personazheve...

Përse pyetjet që sapo parashtrava?

Duke qenë se qëllimi i artit është të japë ndijesinë e gjërave *si janë perceptuar dhe jo si janë njohur*, duke qenë se sipas teorive të interpretimit roli i kritikut është ‘të korigjojë ose të arsyetojë një lexim’, duke qenë se çdo moment interpretimi nënkupton disa supozime për *natyrën e kuptimit*, mendoj se romani “Diktatori në kryq” ka një specifikë të brendshme kuptimore, dhe si i tillë duhet rizbuluar më thellë, për të kuptuar përmasën universale të filozofisë që e përshkon. Nëse romani është vlerësuar për krijimin e figurës së diktatorit në them: jo, vepra është më shumë se kaq! Ajo nuk është roman thjesht për diktatorin, ndonëse figura e tij zëvendëson tërësisht, është më shumë, prandaj edhe vlerat e autores nuk mund të nivelohen thjesht në mënyrën e konceptimit të kësaj figure qendrore.

Filozofia e romanit ngjizet së brendshmi, përmes një strukture specifike, në **tre linja** që, ndonëse në vështrim të parë janë të ndryshme, formojnë *tërësinë e pandashme*. Tre linjat, zhvilluar në tre plane: ditët e anktheve të fundit të diktatorit, përpjekjet për grabitjen e kryqit që mban brenda ashklën e drurit të shenjtë të kryqëzimit të Krishtit si dhe zbulimi i misterit të kishës 1500 vjeçare e Labovës me sekretin e shenjtë të saj, realizojnë një unitet të fuqishëm filozofik. Kështu, të tre linjat ndërthuren rreth një boshti të vetëm, por nëse leximi i drejtpërdrejtë na njeh me këtë strukturë të jashtme, duhet thënë se intuïta krijuese e Mira Meksit e tërheq lexuesin edhe më thellë, për të arritur në vlerën e vërtetë të tij. Tre planet kapërcejnë funksionin e dukshëm të drejtpërdrejtë; në raport me njeri-tjetrin dhe në marrëdhënia me të tërën, sjellin mesazhin e një filozofie universale. Kuptimi i kësaj filozofie është sfida më e bukur para lexuesit, i cili mund të kuptojë se pikërisht struktura e brendshme luan rol të rëndësishëm në procesin e përjetimit artistik dhe organizon në një unitet emocional elementet e strukturës së jashtme. Marrëdhënia midis dy strukturave krijon një njësi të plotë emocionale, me ngarkesë të jashtëzakonshme, çka kërkon që komunikimi i lexuesit me romanin të mos mbetet vetëm në nivelin e parë të leximit, i cili sigurisht është shumë intrigues, por perceptimi të kalojë përtej marrëdhënieve subjektore; është pikërisht ky fenomen i strukturës kuptimore, kompleksiteti i rrëfimit shumështrësor që prodhon emocione specifike. Këtu qëndron suksesi i romanit; intuïta jo e zakonshme e autores, e cila, përtej *krijimit-trillimit* dhe gjërmimit të *të dhënave reale-historike*, qasjes origjinale, mënyrës së përpunimit të planeve të veçanta, kureshtjeve që provokon te lexuesit përmes këtyre tre linjave subjektore, shumë interesante, qoftë të marra në vetvete, në thelb ka krijuar një tërsi unike, boshti i së cilës është një filozofi e veçantë. Cila është ajo

? Formësohet duke ndjekur tre linjat, veç e veç dhe në pandashmërinë e tyre.

Linja e Diktatorit

Dëshira e ringjalljes, e rifillimit të jetës ka lindur bashkë me njeriun dhe është realizuar në imagjinatën e tij në forma dhe përmasa të ndryshme. Historia e mitologjisë i ka dhënë jetë, në trajta nga më të ndryshmet, kësaj ëndrre tejshekullore... Në këtë aspekt edhe simboli i ringjalljes së Jezusit, mbas kryqëzimit të tij, e bëri të fuqishëm motivin e ringjalljes në ëndrrën njerëzore. Romani i kthehet këtij motivi, por në një qasje tjetër, për të theksuar kontrastin e madh midis *dëshirës dhe mëkatit* njerëzor, midis modelit të shenjtë të sakrificës dhe dhunimit të shpirtit të njeriut dhe të vetë besimit të shenjtë.

Në përballjen midis ëndrrës dhe realitetit, që diktatorit i vjen gërryese, e pamëshirshme në ditët e fundit të jetës, përmes zhytjes në ‘humbëtira të kllapisë’, imazheve fantazmagorike, dëshirës dhe frikës, autorja ka krijuar një figurë tragjike, të cilën e ndjek sarkazma e qetë, por shkatërruese. Gjithshka ndodh përmes procesit artistik të *kondensimit psikanalitik*. Kjo figurë fuqizohet me alegoritë e rasteve të ndryshme, me paranojën e përballjes me kundërshtarë të fshehtë, me ankthin e frikshëm të krimeve të kryera në jetën politike të tij, me frikën për gjykimin në jetën e përtejshme...Të kombinuara këto sjellin mënyra të veçanta në vizatimin e figurës së diktatorit, përqendruar vetëm në lëvizjet e brendshme të botës së tij, kryesisht të pavetëdijshme. Një vizatim i jashtëzakonshëm nga romancierja. Intensiteti i vështrimit të brendshëm merr forcë dhe përmasa të gjera për zbulimin e thelbit të diktatorit, duke mbartur peshën dhe thellësinë e ndriçimit të kësaj figure. Mendoj se kjo qasje e brendshme ka efekt të pakrahasueshëm me vizatimet e jashtme të çdo lloj portreti letrar në linja të hollësishme subjektore. Ankthi,



ëndërrat e frikshme, përlëshja e të pavetëdijshmes me të vetëdijshmen kanë një forcë të jashtëzakonshme në roman, dhe në përgjithësi në letërsi. M.Meksi është mjeshtrë në këtë aspekt, çka e ka dëshmuar në portrete edhe të krijimeve të tjera të saj. Autorja ka kapur një aspekt mjaft interesant (që e lidh këtë figurë me dy linjat e tjera): ankthin e papërmbytur për ringjallje e trondisin rikthimet pas, dhe, i tmerruar ai i premtos vetes që në rikthim gjithshka do ishte ndryshe. Është ky moment pendese? Sigurisht jo; është thjesht tmerrri i ndëshkimit, frika e përballjes në jetën e përtejme me viktimat, rishfaqja e skenave të ekzekutimit. “*Tërë ligësitë dhe fëlligëshitë e mbartura prej mijra vjet u shkarkuan nga trupi i tij*”. Në këtë drejtim konceptimi i figurës nuk është thjesht dukuri individuale, por fenomeni shekullor i jetës së diktatorëve... Parimi i kontrastit tragjik midis vegimeve që e tmerron dhe dëshirës së papritur njerëzore për të patur pranë dashurinë, pastërtinë e shpirtit dhe bukurinë e infermieres së re, zbulojnë tragjizmin e karakterit, i cili në momentet e tmerrit kërkon të shpëtojë nga pasioni më i bukur i jetës. Jeta tashmë në pragun e mbarimit, pasvdekja me dëshirën për t’u përjetësuar në piramidë, risjellja e ballsamimeve të diktatorëve të tjerë, ethet për grabitjen e kryqit jetëdhënës, mpleksen në agoninë e personazhit. Rikthimi mund të bëhet vetëm nën shenjë të shenjtë të dashurisë. Por, ndonëse ai kërkon ta risjellë dashurinë, qenia e tij e ka tradhëtuar atë gjatë gjithë viteve të sundimit. Çdo moment i përjetuar në situatë halucinative shfaqet gërryese përballë filozofisë universale që përcjell kjo figurë. Prandaj ai është edhe diktatori shqiptar, edhe imazhi i jashtëzakonshëm i çdo diktatori, parë në momentin tragjik të përballjes finale me realitetin tragjik të ndërtuar prej tij. Autorja kalon më tej kur dërrmon me pyetjen gërryese se a mund të ketë efekt ringjallës kryqi i shenjtë tek ai që e dhunoi në mënyrë të pashembullt këtë besim? Në plan përballës me filozofinë e kryqit, që ruan misterin e madh, linja e diktatorit paralajmëron ndriçimin e filozofisë së madhe, që shfaqet e plotë, e qartë në fund të romanit. Pra kuptimi nuk ndalet këtu. Ai vazhdon të vijë...

Linja e Patriarkut të Kishës Ortodokse Ruse

Është qasja po aq ironike në strukturën e romanit. Është ankthi i diktatorit tjetër, Stalinit, për të fituar ringjalljen? Apo ankthi i shfrytëzimit të kësaj relikeje të shenjtë, i ashklës së kryqit, për të forcuar pozitën e kishës ortodokse, në armiqësi të heshtur dhe konkurrencë të vjetër me Patriarkanën në Konstandinopojë? Apo është ironizimi i kompromentimit të kishës me politikën shtetërore? Apo është ambicja për ta bërë Moskën Romën e tretë? Ideali i Patriarkut Aleksej I ishte “t’i jepte kishës ortodokse ruse vendin që meritonte në universin e ortodoksisë, atë që prej shekujsh e mbante tanimë padrejtësisht Patriarkana e Konstandinopojës,

ajo që dikur ishte quajtur Kisha mëmë e të gjitha kishave ortodokse”. Sarkazma e autores është sa fine aq edhe e pashembullt, sepse në këtë linjë na lind ideja se besimi i krishterë duhet të tronditet nga hipokrizia, mashtrimi, lidhjet me agjuntura, synimet jo besnike ndaj idealit krisht, përballë rrëmbimi të ashlës për të konkuruar fuqinë e Kostandinopojës. Misioni i Patriarkut Aleksej I është fetar, apo politik? Përpyqjet e ethshme të agjunkturës së organizuar shtetërisht, në Shqipëri apo dhe në Rusi, zhbëjnë shenjtërinë e besimit,... Këto pikëpyetje vinë natyrshëm po të shihen si shkojnë në linja paralele : nga njera anë agjuntura shqiptare, grabitja shtetërore, nga ana tjetër dinakëria, hipokrizia e besimi, veprimet mafioze brenda institucionit më të lartë fetar në Moskë për të organizuar grabitjen e kryqit në kishën e lashtë shqiptare. Përsëri kjo linjë nuk është e mjaftueshme. Kuptimi vazhdon të vijë...

Linja e albanologut gjerman F.Guttenberg

Shkon në kontrast me dy linjat e tjera, duke bashkuar interesin e veçantë të albanologëve të huaj për historinë shekullore të gjuhës shqipe, me admirimin për vlerën e jashtëzakonshme të dokumentimit të kulturës fetare që ruhet në këtë vend që nga historia e lashtësisë ilire. E krijuar dhe zhvilluar me mençuri nga autorja kjo linjë ndërton kontrastin e madh filozofik midis hipokrizisë, mashtrimit dhe pasionit shkencor, kontrast i madh me pasionet mesquine të dy linjave të para...Megjithatë, ndonëse kjo figurë risjell pasionet dhe kontributet e shumë albanologëve të huaj, thelbi është diçka tjetër : kërkimet për historinë e krijimit të kishës së Labovës nuk përbëjnë thjesht një linjë subjektore interesante, me shumë kuriozitetet, por rikthim të historisë para shumë shekujsh, rindezja e deshifimeve që hapnin portat e kumteve të Zeusit në gjuhën ilire’.

Ndryshe nga linja e dytë, ku përshkrimi realist krijon tablo të qarta, reale, personazhe fetarë apo politikë, linja e Guttenbergut, veshur me një tis mrekuor e romantik, me një magji dhe mistikë mahnitëse, hyjnizon zbulimin e madh të historisë së ngritjes së kishës së Hylindësës në Labovë mbi rrënojat e tempullit pagan. Zbulimi prej albanologut i rrethanave të ndërtimit të kësaj kisha ku u vendos kryqi me ashklën e shenjtë jetëdhënëse është një linjë sa shkencore aq edhe magjike. “Brenda pafundësisë së botëve ai pa si në një film të ngadalësuar kalimin e kohës në atë hapësirë që tani quhej kisha e Labovës, por që ishte i tërë kozmosi. Pa se shekujt fluturonin para tij...Pa në mes të një mjegulline ngjyrëre nje tempull të lashtë dhe shkëlqimtar...Pa rrënjët e kishës të ngulura thellë në besimin e admirueshëm të të lashtëveqë i ushqenin ato rrënjë ...Pa mes tistit vezullues të dritës shugurimin ceremonial të kishës : mbërritjen e Kryqit të Shënjtë reliktmabajtës që ruante brenda ashklën e Drurit të Kryqitku u kryqëzua Krishti.....dhe mbylli sytë fort pothusj i verbuar nga tërë ajo dritë qiellore.” Imagjinata konkretizohet si në një pikturë impresioniste, me imazh rrezatues, me një imazh imagjinar të jashtëzakonshëm. Realizmi magjik, që në të vërtetë në gjithë veprat e M.Meksit është sythi i imagjinatës së saj krijuese, mplekset për t’i dhënë më shumë magji filozofisë që përshkon gjithë veprën. Kështu linja e Guttenbergut është larg anktheve të dy linjave të mëparshme për grabitjen e kryqit (nxitur nga motive të ndryshme) prandaj lexuesi prek në të më tepër poezinë se sa prozën, përjetimin se sa rrëfimin, se boshti mbi të cilin thurret kjo linjë është pasioni, dashuria, admirimi, mrekuallia e përjetimeve. Rrëfimi i përket atij tipi që Todorov e cilëson si mrekuallia, në të cilën nuk ka shpjegim racional ndaj fenomeneve. Në përgjithësi romani, por veçanërisht kjo linjë, rithekson një dhunti të veçantë të M.Meksit tek e cila imagjinata shfaq pushtet magjik jo aq në krijimin e qenieve apo objekteve imagjinare, por si mjet i hyrjes në botën që ato krijime mishërojnë. Kështu është ikona e Krishtit Pantokrator, lisi i shenjtëruar si simbol i besimit pagan, kuptimi që i jepet faktit të ndërtimit të kishës perandorake mbi rrënojat e tempullit pagan, imazhi fizik i Kristos... janë krijime gati magjike që, përmes imagjinatës së autores, fitojnë konkretësi dhe vizualitet të jashtëzakonshëm. Produkt i magjisë së tyre është krijimi i imazheve, si mjete njohjeje, që realizojnë lidhjen midis ndjeshmërisë dhe kuptimit, ndjeshmërisë dhe njohjes. Sigurisht imazhe të tilla, që vinë tërthorazi në përfytyrimin tonë, mund të nxjerrin pyetje : a janë realitet ato që shohim te imazhet që prodhon romani i M.Meksit ? E gjithë linja e Guttenbergut, në raportet e saj me zbulimin e madh historik, në marrëdhënie me Jolandën magjike, me Kristosin simbol që kapërren përmasat e një personazhi të zakonshëm, është fuqia e krijimit të iluzioneve tona, e intensitetit shpirtëror që krijohet brenda nesh. Në figurën e personazhit, që krijon Mira, bashkohet nocioni me emocionin, duke na krijuar iluzionin e reales. Magjia ndaj kësaj linje qëndron në faktin se padashur kemi zbuluar

në botën tonë të brendshme ëndrën për të dashur dhe për të besuar në idealin e shenjtë njerëzor. Imagjinata e autores ushqen shpirtin tonë. Nëse filozofët kanë menduar se realiteti nuk është thjesht një dukuri e drejtpërdrejtë, por realitet është dhe objekti i të menduarit që përpiqet të kuptojë këtë realitet, atëherë realja për ne është brenda gjithë linjës imagjinare që ndërton romancierja. Ky është momenti më magjik i romanit. Synimi i madh i autores është që e vëtrteta njerëzore, jo thjesht e tanishmja, të mbetet në letërsi, sepse vepra e vërtetë jeton në imagjinatën e lexuesit...

E, megjithatë, edhe kjo nuk është e tëra e asaj që mbart vepra. Kuptimi vjen në ndërlidhje me dy planet e tjera...

Si është raport midis vetëdijes dhe intuitës së autores ? E pamundur të përcaktohet, por specifika e procesit të saj krijues është se vetëdija e përpunuar në shkallë të lartë (njihet pasioni i saj, edhe në vepra të tjera, për të njohur dokumentet e historisë së lashtë, për të rrënuar arkiva e vepra shkencore, historike e fetare, që nga lashtësia ilire, helene etj. Mënyra e ndërtimit të pasionit dhe punës kërkimore të Guttenbergut, e bën aq të pranishme këtë pasion historik-kulturor-fetar të saj...) Por brenda saj jetojnë dëshira me përmbajtje ndërnyerëzore, aq sa, ndoshta edhe ajo vetë nuk e kupton se sa të fuqishme e ka intuitën, refleksin ndjenjësor ndaj problemit që trajton. Përmes një kompozicioni të tipit paralel, alternimit të tre planeve, romancierja M.Meksi nuk realizon thjesht një unitet kuptimor filozofik, por zbulon edhe instiktin e saj të brendshëm, sa njerëzor aq edhe fetar. Në një kuptim ajo është vetë pjesë e fantazisë së krijuar... Nëse thelbi filozofik ndërtohet mbi disa nivele subjektore, që ecin paralelisht dhe të alternuara në kohë, në strukturën e tyre të brendshme kemi një lëvizje të fuqishme të pavetëdijes së autores, të intuitës dhe dritshjeve të brendshme të shpirtit të saj. Nëse teorikisht thamë se subjekti është një komponent në veprim i prozës, në romanin “Diktatori në kryq” lëvizja i përket pikërisht botës shpirtërore të M.Meksit.

Sigurisht nuk është synimi im të futem në teknika interesante të poetikës së romanit, si dukuritë intertekstuale, specifika të narracionit, ligjërimin e pasur dhe prirjen për fjalëformime të reja, që shquajnë ligjërimin artistik të M.Meksit, apo konceptimin sipas realizmit magjik të disa personazheve... Sepse objekti themelor është kuptimi i kuptimit të romanit, depërtimi në strukturën e brendshme filozofike të tij, për të njohur vlerat e vërteta e më të thella të tij. Veprën mund ta quajmë edhe si roman i simbolit të madh, që merr kuptim nga një sërë simbolesh të tjera. Kështu, simboli i djalit që u ngjiz në kishë, që lindi me shenjen e kryqit mbi krahëror, portreti magjik i tij mbështjellë me një dritë verbuese kur hyn brenda në kishë, apo lëvizjet shekullore të heshtura të banorëve të Labovës për ta fshehur në mjedise të ndryshme kryqin e shenjtë si dhe kopjen e tij, ringjallja e shkrimeve të pergameneve të lashta ...simbolika

e bashkimi të dy feve...simbolika e dështimit të gjithë agjunkturave për realizimin e grabitjes së kryqit të shenjtë shumëshekullor... Ashkla e shenjtë, e ruajtur brenda kryqit, simbolizon ndjenjën më të shenjtë njerëzore, sakrificën për njerëzimi, prandaj atë nuk mund ta ketë as diktatori si gjakosësi i popullit të vet, as patriarku me motivet nxitëse të tij, asnjë forcë që nuk qaset me vlerën kuptimore universale të saj. Sepse njerëzimi duhet ta meritojë...Bota e ka humbur shpirtin e dashurisë, të sakrificës deri në vetmohim...Bota e ka përdhosur gjakun e krishtit, e ka tradhëtuar këtë simbol shekullor...Diktatorët mund të kenë shumë pushtet, por ata janë mjeranë para fuqisë së këtij simboli të shenjtë... Kishat mund të predikojnë...por pushteti i tyre është larguar nga simboli i vetësakrifkimit për njerëzimin. Prandaj vjen fuqishëm pohimi “Se ai zbulim duhet t’i përkiste një ngjarjeje që do të ndodhte, e cila lidhej me fatin dhe shpëtimin e njerëzimit mbi tokë dhe që ishte një nga të fshehtat e mëdha të besimit të krishterë.”

Prandaj romani i M.Meksit nuk ka në qendër thjesht figurën e diktatorit, por një filozofi të madhe ndërnyerëzore. Është filozofia e kthesës njerëzore : përballë përmbysjes që ka ndodhur në botën shpirtërore të njerëzimit ndriçon dëshira e ringjalljes së besimit të shenjtë në dashurinë dhe sakrificën sublime. Metafora e fshehjes së kryqit të vërtetë, e dështimit për ta rrëmbyer me dhunë e mashtrim shpreh qartazi idenë se ky simbol i shenjtërisë dhe i mirësisë njerëzore nuk mund të meret me zor, ai qëndron atje, në malin e shenjtë, në pritje që të ndodhë një përmbysje e madhe shpirtërore, që njerëzimi t’i qaset për të shpëtuar ekzistencën e vet...

“Kuptoi se e gjithë kjo ishte shenja e madhe , shenja e rikthimit të Krishtit në tokën e besimit, ku do të ndërtojë mbretërinë njerëzore të besimit për të shpëtuar njerëzimin.”...

“Por, përpara saj pa forcat e tmerrshme të së keqes që iu vërsulën njerëzimit... Pa në Kishën e Labovës rikthimin e Krishtit në Lavdi mbi tokë dhe triumfin përfundimtar të së mirës kundër së keqes...Pa gjykimin që zoti Krisht u bëri të gjallëve dhe të vdekurve, pa faljen dhe jofaljen...”

“Se ai zbulim duhet t’i përkiste një ngjarjeje që do të ndodhte, e cila lidhej me fatin dhe shpëtimin e njerëzimit mbi tokë dhe që ishte një nga të fshehtat e mëdha të besimit të krishterë.”

Të tre linjat, ndonëse u analizuan veç e veç, kanë një shtyllë të madhe rreth së cilës vërtiten dhe në sajë të së cilës ndërlidhen, ndërvaren tragjikisht, duke formuar një njësi të plotë, magjike në qëndrueshmërinë e saj. Mënyra e harmonizimit të tre linjave rreth këtij boshti filozofik i jep veprës një frymëmarrje tjetër, më të gjerë, duke krijuar një pushtet të jashtëzakonshëm në përjetimet e lexuesit, duke tronditur shoqërinë tek ne, apo dhe kudo, me thirrjen hyjnore për të rendur drejt kthesë të madhe që njerëzimi duhet të bëjë!

Ja pra, kjo është filozofia e vërtetë e romanit “Diktatori në kryq” të Mira Meksit !



Mbi ekspozitën e piktorit dhe studiuesit Oltsen Gripshi
“Stinët e qenies apo himni i jetës”

KUR SHKOJMË MË TEJ SE IMAZHI

Prof. Dr. Josif PAPAGJONI



Arti ka fuqinë sa të imitimit, paraqitjes a shpërfaqjes së një objekti, dukurie, aq dhe të rikrijimit, të sendërgjimit, të transformimit, të përlindjes prej ashtit të perceptimit të diçkaje “ndryshe” nga jeta dhe njeriu, nga lëndorja dhe natyrorja, por që të shpie po te jeta dhe njeriu, por tashmë të përthyerja përmes filtrash të hollë psikikë, transcendentalë. Teksa shihja ekspozitën e piktorit dhe studiuesit Oltsen Gripshi “Stinët e qenies apo himni i jetës”, çelur në mjediset e Ministrisë së Kulturës, ma fshiku syrin, trurin dhe zemrën pikërisht kundërshtia përplotësuese që thash më sipër, e cila është pjesë e thelbit të artit. Paraqitja konceptuale e mesazhit dhe domethënies së saj, e shkruar nga vetë Oltsen, më bëri të ndalem mes fjalive të tij prej një ligjërimi të lartësuar, filozofik madje, që dëshmonte sa kulturë, dije, ndërgjegje estetike, edhe një dritësim mbi konturet e lëbryta të punimeve të tij, të cilat na bëhen edhe më të rrokshme në domethëniet e veta. Kam pasur rastin ta njoh Oltsen Gripshin në periudhën 5 vjeçare të përgatitjes së doktoraturës së tij, e më pas të mbrojtjes plot kompetencë, sikundër edhe me botimin e disa studimeve të tij në revistën “Studime për artin”, ku unë isha kryeredaktor. Përpos energjisë dhe ambicies për të mbërritur në “kullën e vet” te “qyteti” i artit bashkëkohor shqiptar, ajo çka më mbresonte më shumë tek ai ishte formimi profesional prej shkollës italiane të arteve, ku edhe ishte diplomuar dhe kishte fituar “masterin”. Dallonte nga gjuha e përdorur dhe koncepti i ri që kishte kundruall proceseve të zhvillimit të artit shqiptar në trajtat moderne e postmoderne të tij, ku shëmbëllimi i thjeshtë thujse ishte flakur dhe në syrin e piktorit buisnin lloje të tjera imazhesh: shpikje të mendjes, vegime prej ëndrrave, maktheve, virulencave psikike, përfytyrime të cytura prej narrativave poetike, futurake e mitologjike, që ngrenin mbi kështjellat

e vjetra e të rënda prej një realiteti gri, të tjera “kështjella”, shpesh të “ajërta” me struktura mentale paradoksale - një surealitet drithërurs, i habitshëm, çudan, grotesk dhe rëndom i frikshëm. Kjo materie e re, e quajtur në të shumtën surealizëm me degëzimet konceptuale të tij, është pikërisht e pranishme dhe përcaktuese edhe te mendja krijuese e Gripshit te ky instalacion. Kjo s’ka nevojë të vërtetohet. Ndjehet kudo. Vetëshprehet. Duket. Porse, ndryshe nga një pjesë e konsiderueshme e artit surealist, këtu piktori ngjan se i shmanget të shëmtuarës, të neveritshmes, tmerrueses, paranojakes, tema e motive preferenciale të këtij drejtimi. Përkundrazi, ai paqtohet me motive, imazhe e kategori estetike, që lidhen më së shumti, sipas meje, me sublimen, liriken, poetiken, të madhërishtmen, simboliken, filozofiken, prandaj edhe ai e thekson enkas qasjen e dytë të karakterit të kësaj ekspozite me instalacione: konceptualizmin. Konceptualizmi shfaqet si diç e natyrshme, e brendshme, ontologjike, ku simbolika dhe metafora shkrijnë në mënyrë harmonike lëndoren e të rastësishmen me shpirtëroren e të përzgjedhurën.

Pashë “muret e qelqta të qenies” artistike të Oltsenit, siç i quan ai. Në ato mure ai kridhet te metaforat shumështrësore që të menduarit e tij artistik kanë vjelur nga jeta, ngacmimet e ardhura prej andej, çka e kanë çuar fantazinë e tij për të rindërtuar tashmë “mure” të tjerë, të një tjetër alkemie, hapësire, dimensionit e forme. Hapësirat boshe e të tejdukshme mbushen tashmë me imazhe që na ftojnë të përjetojmë fshehtësitë tona, dritën që buron nga dikah dhe hyn thellë territ të qenies sonë që të na thotë se kush jemi e çfarë jemi, të na shpjegojë ndoca mistere ardhur nga loja e imazheve onirike, të cilat tekta i shohim e i prekim, mbërrijnë në të tjera domethënie. Kjo ecejake nga e thjeshta në

dukje të parë drejt asaj që tashmë qenka më e thellë e më shumështrësore, mua më kumtonin përftesat mesazhore të artit të Gripshit, i cili i ikën të rastësishmes, pa qenë aspak i një çasti vetmitar, sado fatlum qoftë ai. Kjo dëshirë për të migruar përtej krijimeve të Oltsenit, duke u përqasur me veten time dhe ato çka mendja ime koncepton e përfytyron, m’u duk se më bëri një bartës të artit të tij, sa dhe një kumtar (doemos nisur nga dritarja estetike e perceptimit tim).

Krijimet pamore të sjellë te tablotë e këtij instalacioni polisemantik janë mirëfilli konceptuale. Ato artikuloohen në katër njësi kuptimore, që janë katër stinët: pranvera, vera, vjeshta dhe dimri. Është cikli vjetor natyror, por ne e konotojmë atë dhe si cikël i jetës njerëzore, sepse edhe jeta e njeriut e tillë është: *katërstinore*. Pranvera që na mbush me optimizëm, gjallëri, erotikë, shpresë dhe qiej të hapur në fëmijëri dhe rini pasohet nga vera me zjarrminë, frutat, energjinë për të mbërritur në epëritë e fuqisë, pasionit, egos, riprodhimit seksual, personalitetit, siç është edhe mosha e burrit dhe e gruas, mosha e punës dhe e pllenimit. Ja ku mbërrin dhe vjeshta, një gjethurinë e shpërndarë për tokë, si e rrëmbyer nga era, tekta gjelbërimi ka mbaruar dhe e kuqërremta mbush peizazhin, drurët zhvishen, ka nisur lodhja dhe mundimi nga vrapit i kohës dhe mbijetesa, siç është në fakt edhe mosha kur njeriu ndjen mbi shpinë qiejt e ngarkuar me shira, rrebeshe të pritshme, gjëmime, mes një vuajtje ekzistenciale që duket se është e pambarimtë. Dhe në fund vjen dimri, i ftohtët, ngricat, drita e hirtë e përthyer nga qielli gri me barkun e mbushur me borë, llohë, akuj, kur pemë e kafshë, dhe krejt gjallesat, struken foleve për t’i shpëtuar peshës mortore të tij, njësoj siç është dhe njeriu i ngratë viteve të pleqërisë, gdihui e ngrysu mes lëngatave, pamundësive, vetmisë, rrudhjes, heshtjes dhe shurdhërisë.

Unë i solla këto “stinë”, sa të natyrës aq dhe të qenies njerëzore, përmes një narrative të thjeshtë, me përqasje kah njeriu dhe mosha e tij. Porse në imazhet e ardhura nga ekspozita e Oltsenit mendja e vizitorit lihet e lirë. Ti mund të ecejakesh e të vraposh hirit të simbolikave me dekriftime që vijnë pikërisht nga shija jote estetike, nga perceptimi yt vetjak, nga çasti i përjetimit dhe i ngacmimi për të bredhur një grimë herë nëpër meditime filozofike. Sepse është pikërisht “filozofike” ajo që na jepet nga instalacioni katër-pjesësh a katër-stinor i Oltsenit. Ai e pohon vetë këtë tekta thotë se e gjitha dekodohet si: “Konceptualizmi si alfabeti i im, i dialektikës sime, i universit tim eremit, i qenies sime kozmike, e cila shtegton për t’i qëndruar përballë të vërtetës dhe për ta shpërfaqur atë nëpërmjet një procesi ndjesor, intim dhe vetjak”.

Po sjell në vëmendje të lexuesit emocionin tim, besoj edhe të shumë vizitorëve të tjerë të kësaj ekspozite, që grishet dhe buron nga të menduarit estetik e filozofik të Oltsenit. Shumëçka nuk e dija, por tekta lexova edhe mendimin shoqëruar të vetë artistit Gripshi se nga dhe se si kishin ardhur ngacmimet lidhur me çdo “tablo”, u qartësove për shumëçka dhe dekriftimi im ishte më i lehtë, sidomos për ndonjërin nga tablotë, ku shtresa simbolike më dukej si pasive dhe opake. Në kryeherë, si tablo prezantuese, ndofta edhe si elementi cytës, piktori kishte vendosur një jorgan ngjyrë blu. Ç’ishte vallë ai, ç’kuptim kishte? Unë mund të sajoja disa kuptime, por shpjegimi i Oltsen Gripshit ishte sa domethënës e



sqarues për mua, aq dhe prekës. Është fjala për jorganin e vjetër nga paja e të ëmës, i cili u nxor nga rrënojat e shtëpisë së tij të shembur prej tërmetit të tmerrshëm të nëntorit të vitit 2019. Është një relikte e shtrenjtë dhe e shenjtë, e nxjerrë nga vuajtja dhe kujtesa, nga mallëngjimi, përdëllimi dhe respekti që të gjithë neve kemi për prindërit tanë, rrënjët tona, mbamendjen tonë. Por dhe nga fati, që na ndihet të mbetemi gjallë, teksa një siluetë korbi poshtë këtij jorgani na kujton se kemi shpëtuar nga vdekja në qime të flokut. Pra, ky është një prolog përhirues, që na fton të udhëtojmë në semantikën e tablove të tjera, të cilat përveçse metafora dhe simbole të lexueshme stinore e më gjerë, janë po ashtu edhe shenja që shkojnë më tutje, shenja që kridhen thellë në qenien krijuese të vetë Oltsenit si artist dhe të Oltsenit si bir, burrë, prind e njeri, që përjetoj tmerrin e një fenomeni natyror katastrofik siç qe tërmeti me rrezikimin e jetës teksa shtëpia iu shemb.

Në qendër të hapësirës së ekspozimit, e cila është edhe pjesa më e ngarkuar me simbole, janë vendosur katër objekte: një kafkë njerëzore në qendër, që na çon vetiu te vdekja si fenomenologji dhe përjetësi, si rrezik, proces natyror dhe tragjedi; majtas është një tulipan i porsaçelur, që na çon vetiu te lulëzimi, kur nga hiri i vdekjes fuqia e jetës triumfon mes bukurisë dhe hijeshisë; djathtas është një sahat egjiptian me rërë, klepsidra, e cila na kujton se koha është eterne, formë perceptimi sa brenda ndërgjegjes sonë aq dhe jashtë e pavarësisht asaj. Sakaq koha e matshme njerëzore përcakton caqet e jetës sonë në segmentin jetë-vdekje si dhe çdogjësendi tjetër; elementi i katërt, sipër, është një vezë, pra embrioni i jetës, i qenësisë, i vetë kozmosit, e cila riprodhon materien dhe frymën në një cikël shkatërrimi dhe ndërtimi, fundi dhe fillimi, stopimi dhe vijimi - një proces ky i përhershëm dhe i përjetshëm, kulm e themel njëherit i vetë ekzistencës.

Në një sipërfaqe disa ngjyrëshe mes të kaltrës, rozës dhe grisë, syri ynë dallon një dallandyshe. Është zogu i hershëm i pranverës, fluturaku që na bujt nëpër shtëpia dhe na kujton se dielli është me ne, përtëritja është me ne, ringjallja dhe pranvera janë me ne. Në fakt është një triptik dallëndysësh, sepse në mes të tabosë e shohim këtë zog fluturak se si ngazëllen në ajrinë qiellore, ashtu i shpenguar dhe i bukur, ndërsa sipër spikatit bishtat e dy dallëndysheve të tjera, që mesa duket kanë ngritur folenë dhe po çiftëzohen, si himni i vetë jetës, si ringjallja dhe "Kënga e Këngëve" e Solomonit. Jo lehtësisht e rrokshme është edhe simbolika e tabosë së mbushur me ngjyrë të verdhë, ku rrëshaqsin tre gjarprinjë (apo i njëjti gjarpër), ndërsa në mes është një mizë. Totemi i gjarprit është i njohur, madje edhe në mendësinë dhe antropologjinë tonë kombëtare. "Gjarpri i shtëpisë" themi dhe i atribuojmë atij cilësi mistike, eskatologjike, si mbrojtësi i mureve të konakut ku frymojmë, por edhe i gjindjes. I dalë nga ftohja, dimri, ngrirja, letargjia dhe palëvizshmëria, ai rrëshqet tashmë drejt jetës, të ngrohtës, lëvizjes, shkrifërohet, heq lëkurën dhe rinohet përmes rigjallërimit. Por simbolika e gjarprit është edhe ajo e racionale, pasi gjaku i tij është i ftohtë. Po miza e qetë dhe "indiferente" çdo aty, pranë gojës së gjarprit? Nuk është një kavie-kufomë-kalbësirë. Kuptimi këtu alternohet mes të përkohshmes dhe të përhershmes, mes të voglës dhe të madhes, mes rrëshqanores dhe fluturakes. Duken si dy botë jokomunikuese, indiferente ndaj njëra tjetrës, por duke u kredhur në simbolikë në biem dakord me shpjegimin e vetë artistit Gripshi se miza është insekti i kudogjendshëm, në jetë, kalbje dhe vdekje, një ndërmjetme gjalluese që sfidon rrënimin, vdekjen, stinët, përmasat, duke vërtetuar me praninë e saj të tërëjetshmen dhe të përkohshmen, shpejtësinë dhe ngathtësinë, çastin e shkurtër dhe atë të pafund, token dhe qiellin, jetën dhe vdekjen.

Njësia piktorike dhe pamore më e kompozuar dhe më mbresëlënëse për mua është "Vjeshta". Ajo gjethurinë e bukur, që bie nga lart poshtë në dysheme dhe i vishet sfondit të zi si një kulpër lisit të madhërishtëm, duke u mbledhur më poshtë te një tog që sikur merr frymë ende, më ka dhënë emocionin më të befte, më të bukur. E gjitha më duket lirike, e gjitha si një fluturim ajrisë dhe si këputje e ëmbël, teksa një erë fryn dhe ne sikur ndjejmë trishtimin vjeshtor. Ka diçka që e fton jo vetëm mendjen tonë të migrojë ku ajo dëshiron, por edhe syrin tonë të këndellet me poemën e madhe të natyrës dhe të vetë jetës.



Dashuri me shikimin e parë nga JEFFREY ARCHER

Andrew ishte me vonesë, ndaj pa u menduar Agjatë do të kishte marrë një taksì sikur të mos kishte qenë pikë i qarkullimit. Ai u fut në stacionin e metrosë të mbushur plot e përplot duke i bërë dredha turmës së udhëtarëve teksa ata i drejtoheshin shkallës së lëvizshme për të kapur trenin e kthimit në shtëpi.

Andrew nuk po kthehej në shtëpi. Pas katër stacioneve ai do të rishfaqej në sipërfaqe pasi të kishte lënë pas thellësinë e tokës për të qenë korrekt me takimin që kishte lënë me Ely Bloom-in, Guvernatorin e Bankës Chase Manhattan në Paris. Ndonëse Andrew kurrë nuk e kishte takuar personalisht Bloom-in, ashtu siç mund të thuhej dhe për të gjithë kolegët në bankën ku ai punonte, reputacioni i Guvernatorit ishte më se i njohur për të. Bloom-i nuk të 'thërriste në mbledhje' nëse nuk do të kishte një arsye të fortë për ta bërë këtë gjë.

Nga momenti që sekretarja e Bloom-it e kishte marrë në telefon për ta vënë në dijeni në lidhje me takimin e planifikuar, Andrew kishte kaluar dyzetë e tetë orë duke u përpjekur për ta gjetur me hamendje arsyen e vërtetë të këtij takimi. Një këmbim i thjeshtë vendesh nga Crédit Suisse te Chase dukej si përgjigjja më e mundshme – por nuk kishte të ngjarë që çështja të ishte kaq e thjeshtë, sidomos ngaqë aty përfshihej vetë Bloom-i. Mos vallë ai ishte në prag të bërjes së një oferte të cilën do të ishte e vështirë ta refuzoje? A thua ta kishte ai pritshmërinë që pasi Andrew të kishte kaluar më pak se dy vite në Paris të transferohej te Chase Manhattan në New York? Pyetjet që i pluskonin në kokë ishin të shumta. Ai e kishte të qartë se duhej të hiqte dorë nga spekulime të tilla, sepse përgjigjen për të gjitha këto do ta merrte në orën gjashtë të pasdites. Shkallët lëvizëse do t'i kishte marrë me vrap, por turma e njerëzve nuk e lejonte ta bënte një gjë të këtillë.

Andrew ishte i vetëdijshëm se në dorë mbante një kartë të fortë – ai i kishte ngjitur shkallët e karrierës deri te zyra e shkëmbimit të jashtëm të bankës Crédit Suisse në më pak se dy vite, dhe fakti se ai ishte më i zoti se rivalët e tij pranohej nga të gjithë. Bankierët francezë kishin mbledhur supet kur kishin marrë vesh për suksesin e tij, ndërsa rivalët amerikanë para pak kohësh ishin përpjekur ta bindnin që të largohej nga vendi i punës që kishte dhe të punonte për ta. Cilado që mund të ishte oferta e Bloom-it, Andrew ishte i sigurt se Crédit Suisse do t'ia gjente shoqen. Sa herë që i ishin bërë propozime të këtilla në dymbëdhjetë muajt e fundit, ai i kishte mënjanuar ato me të njëjtën mirësjellje dhe buzëqeshje djaloshare – gjithsesi, ai e dinte se këtë radhë bëhej fjalë për diçka të ndryshme. Bloom-i nuk ishte nga ata që mund t'i shmangeshe lehtë me një buzëqeshje të mirësjellshme djaloshare.

Andrew nuk kishte kurrfarë dëshire për të lëvizur në një bankë tjetër, sepse ai ishte shumë i kënaqur me paketën që Crédit Suisse i siguronte – pastaj, në moshën e tij, cili do të ishte ai i ri që nuk do ta shijonte punën në Paris? Sidoqoftë, tani ishte pikërisht koha kur shqyrtoheshin shpërblimet vjetore, dhe për këtë arsye ai ndjehej i lumtur që do të 'merrte takim' me Ely Bloom-in te Bari Amerikan në Hotelin Geroge V. Do të kalonin disa orë përpara se prezenca e tij aty të vihej re dhe të raportohet te eprorët e tij.

Kur Andrew u ndal tek platforma e metrosë, ai pa se aty ndodhej një turmë aq e madhe sa edhe vetë nuk ishte i sigurt nëse do të mund të hiqte në trenin e parë që do të futej në stacion. Ai i hodhi një sy orës: 5:37. Koha duhej të ishte e mjaftueshme për të mbërritur në orar në takimin e punës, por meqenëse nuk kishte asnjë lloj synimi për të shkuar aty me vonesë, ai u përvodh përmes hapësirave të vogla, i pozicionuar mirë për t'u ngjitur në trenin tjetër të radhës. Edhe po të mos arrinte një marrëveshje me zotin Bloom, ai do të vazhdonte të ishte një figurë e rëndësishme e botës financiare të bankave për shumë vite të tjera, ndaj nuk kishte kuptim që të mbërrinte me vonesë dhe të linte një përshtypje të keqe tek ai.

Andrew priti me padurim që treni i radhës të shfaqej tek dilte nga tuneli për në stacion. Ai i hodhi një shikim të ngulët shinave të trenit në anën e platformës përballë, dhe u përpoq të përqendrohej tek pyetjet që zoti Bloom mund t'i drejtonte.

Sa është rroga juaj mujore?

A mund ta prishni kontratën?

Jeni i përfshirë në ndonjë program shpërblimesh?

A jeni i gatshëm të ktheheni në New York?

Platforma prej së cilës trenat niseshin në drejtim të jugut ishte e mbushur deng, ashtu siç ishte edhe ajo mbi të cilën qëndronte Andrew. Përqendrimi u fashit në momentin kur sytë e tij u ndalën te një vajzë e re, e cila po i hidhte një vështrim orës së saj

të dorës. Ndoshta edhe ajo kishte lënë një takim në të cilin duhej të mbërrinte në kohë.

Në çastin që ajo ngriti kokën lart, Andrew e harroi tërësisht Ely Bloom-in. Ai vështroi me ngulm sytë e saj të thellë ngjyrë kafe. Admiruesin e saj ajo nuk e kishte vënë re. Duhej të ishte një metër e shtatëdhjetë e dy centimetra e gjatë, me një fytyrë të përkryer ovale, lehtësisht e zeshkët dhe që asnjëherë nuk do të kishte nevojë për makijazh, një tufë flokësh të zinj, të përdredhur e të shprishur që asnjë floktare kurrsesi nuk do të ishte në gjendje t'i bënte permanent. Unë ndodhem në platformën e gabuar, i tha ai vetes, ndaj në këto rrethana nuk mund të bëj asgjë.

Ajo kishte veshur një pardesy ngjyrë bezhë, rripi i së cilës i lidhur në mes nuk linte asnjë dyshim se sa elegant dhe i hijshëm ishte shtati i saj, përfshirë edhe këmbët – dhe me aq sa mund të shikonte ai – ato plotësonin një paketë të përsosur. Shumë më të mirë se nga çdo lloj pakete që mund t'ia ofronte zoti Bloom.

Ajo përsëri kontrolloi orën e dorës, më pas ngriti kokën lart, dhe fare papritur vuri re se ai po e shikonte me ngulm.

Ai vuri buzën në gaz. Ajo u përflak në fytyrë dhe uli kokën pikërisht në momentin kur dy trena nga drejtime të ndryshme rrëshqitën brenda në stacion. Çdokush që ndodhej prapa tij shtyu përpara për të pretenduar një vend në trenin e ndalur.

Kur treni la pas stacionin, Andrew ishte i vetmi person që kishte mbetur mbi platformë. Ai i hodhi një shikim trenit tjetër që ndodhej në platformën përballë dhe e vëzhgoi atë tek gradualisht rriti shpejtësinë deri sa ai u largua nga që andej. Në çastin që ai humbi në tunel, Andrew buzëqeshi sërish. Vetëm një person qëndronte në platformën përballë, dhe këtë radhë ajo ia ktheu buzëqeshjen.

Ju mund të pyesni se ku e di unë që kjo histori është e vërtetë. Përgjigjja është e thjeshtë. Këtë histori ma treguan Andrew dhe Claire, në fillim të këtij viti, me rastin e përvjetorit të dhjetë të dasmës së tyre.

Përktheu: Aristidh Shqevi



DY PROZA TË SHKURTRA nga FRANC KAFKA

PARA LIGJIT

Para ligjit qëndron një portier. Te ky portier vjen një burrë nga rrethet dhe lutet për hyrje në ligj. Mirëpo portieri thotë që nuk mund t'ia miratojë hyrjen. Burri mendohet dhe pyet pastaj, në i lejohet të hyjë më vonë. "Ka të ngjarë", thotë portieri, "mirëpo tani jo." Meqenëse porta për te ligji rri hapur si gjithmonë dhe portieri mënjanohet, burri përkulet, për të parë brenda nëpërmjet saj. Kur portieri e vë re këtë, qesh dhe thotë: "Nëse të ndjell kaq shumë, provoje atëherë të futesh brenda, pa çka se ta kam ndaluar. Ki parasysh sidoqoftë: unë jam i fuqishëm. Dhe unë jam veç portieri më i fundmë për nga rangu. Nga salla në sallë bëjnë rojë po ashtu portierë, njëri më i fuqishëm se tjetri. Vetëm pamja e të tretit prej tyre në radhë më bën të dridhem." Kaq koklavitje nuk i ka llogaritur burri nga rrethet; ligji duhet të jetë për këdo dhe gjithnjë sidoqoftë i hapur, mendon ai, porse kur sheh tani më shkoqur portierin me pallto gëzofi, hundën majuce të këtij, mjekrën e gjatë, të hollë, të zezë tartare, vendos që të presë më mirë, gjersa të marrë lejen për hyrje. Portieri i jep një stol dhe e lë të ulet para derës. Rri ulur aty me ditë e vite. Bën shumë përpjekje për t'u lejuar dhe e lodh portierin me lutjet e tij. Portieri e merr shpesh në pyetje, e pyet mbarë e prapë për vendlindjen dhe për shumë gjëra të tjera, porse janë pyetje anashkaluese, të ftohta, ashtu siç i shtrojnë zotërinjtë e mëdhenj, dhe në fund i thotë gjithnjë e përsëri që nuk mund ta lerë të hyjë. Burri, i cili është pajisur për udhëtimin e tij me shumëçka, i përdor të tëra, qofshin këto edhe shumë të vlefshme, për ta korruptuar portierin. Ky i merr gjithçka që i jepet, porse thotë ndërkaq: "Po e marr vetëm që të mos besosh se ke dalë ndoshta huq." Përgjatë shumë viteve burri e vëzhgon portierin gati pa ndërprerje. Ai harron portierët e tjerë, ndërsa ky i pari iu duk pengesa e vetme për hyrjen në ligj. Mallkon rastësinë e pafatë, vitet e para pa bërë kujdes fare dhe me zë të lartë, më vonë, kur plakët, vetëm murmuron gjithë

zhurmë me vete. Bëhet si kalama dhe, meqë e ka diktuar edhe pleshtin në jakën e portierit, i lutet deri edhe pleshtit që ky ta ndihë dhe ta bëjë portierin të ndërrojë mendje. Më në fund i dobësohet drita e syve dhe nuk e di nëse përreth tij errësohet edhe më, apo në e mashtronjë sytë. Mirëpo dallon tanimë në terr një ndrimë, e cila futet e pashuar nga dera e ligjit. Tani nuk do të jetojë më shumë. Para se të vdesë i bëhen bashkë në krye të gjitha përjetimet e tërë kohës në një pyetje, të cilën nuk ia ka shtruar akoma portierit. I bën një shenjë këtij, ngase nuk mund ta drejtojë më trupin e ngrirë. Portierit i duhet të përkulet kah ai, sepse dallimi i lartësive trupore ka ndryshuar në favor të burrit. "Çfarë po kërkon të dish akoma tani?" pyet portieri, "ti je i pangopur." "Të gjithë duan drejtësi, duan ligj, apo?" thotë burri, "për çfarë arsyeje nuk ka kërkuar askush përveç meje hyrje?" Portieri e vë re që burri tashmë po merr fund, dhe, për t'ia mbërritur dëgjimit të këtij, i gërthet: "Këtu nuk do të mundesh askush të merrte leje, mbasi kjo hyrje ishte e përcaktuar vetëm për ty. Po iki tani dhe po e mbyll."

LAJM PERANDORAK

Perandori - kështu flitet - të ka dërguar ty, të vetmit, nënshtetasit të humbur, vocërrakes hije që ka marrë arratinë para diellit perandorak në më të largtën largësi nga të tëra, pikërisht ty të ka dërguar lajm nga shtrati i vdekjes perandori. Lajmësin e ka lënë të bjerë në gjunjë dhe ia ka pëshpëritur në vesh lajmin; ka qenë aq e rëndësishme për të, sa ka lënë t'ia përsërisin në vesh. Ka pohuar me tundje koke saktësinë e fjalëve. Dhe mu para të pranishmëve që e shohin kur po jep shpirt - kanë prishur muret bezdisëse ndarëse dhe shkallareve që bëjnë përpjetë qëndrojnë përreth të mëdhenjtë e perandorisë - në sy të tyre ka kryer punë me lajmësin. Lajmësi është nisur menjëherë për udhë; burrë i fuqishëm, i palodhur; herë me njërin krah, herë me krahun tjetër, i hap shteg vetes nëpër turmë; kur has pengesa tregon kraharorin, ku është shenja e diellit; ecën lehtë përpara, si askush tjetër. Mirëpo turma është e madhe; banesat e gjindjes nuk kanë fund. Po të hapej fushë e lirë, si do të merrte krahë e do të fluturonte dhe shpejt atëherë do të dëgjoje trokitjet e mrekullueshme të grushtave të tij në derën tënde. Por në mungesë të kësaj, si rropatet pa dobi; ende po shtyhet nëpër odat e pallatit të brendshëm; nuk do t'ia kalojë dot kurrë; edhe sikur t'ia dilte, nuk do të kishte fituar asgjë; do t'ia duhej të luftonte shkallëve përposhtë; dhe po t'ia dilte kësaj, asgjë nuk do të fitonte; do t'ia duhej të rrethkalonte oborret; dhe pas oborreve do të ishte pallati i dytë rrethues; dhe përsëri shkallë dhe oborre; dhe prapë një pallat; e kështu me radhë për mijëvjeçarë; dhe sikur të turrej më në fund prej portës së jashtme - porse kurrë, kurrë nuk mund të ngjajë kjo -, shtrihet qyteti i rezidencës para tij, mesi i botës, me pirlje të larta përplot me hedhurina dhe mbetje. Asnjëherë nuk e përshkon dot këtu edhe më pak akoma me lajmin e një të vdekuri. - Porse ti rri ulur ndanë dritares tënde dhe ia ëndërron vetes lajmin, kur vjen mbrëmja.

përktheu: ARB ELO



Botohet ne Itali romani "Metamorfoza e nje kryeqyteti", perkthyer nga prof Matteo Mandala, dhe botuar nga shtepia botuese romane Castelvecchi editore.


NJË IRONI E PAMËSHIRSHME MBI ANTIHERONJTË E TIRANËS

Këto ditë u botua në Itali romani "Metamorfoza e një kryeqyteti", përkthyer nga prof. Matteo Mandala, dhe botuar nga Shtëpia Botuese Romane "Castelvecchi editore". Në shënimin shoqërues me rastin e daljes së romanit, botuesi italian, ndër të tjera shkruan:

"Roman mbi një qytet, të quajtur Tiranë, kryeqyteti i një regjimi stalinist ballafaquar papritmas me modernizmin; një laborator mbi natyrën njerëzore. Me një realizëm alla Çehov, dhe një ironi të pamëshirshme Ylljet Alicka, na zbulon shtresëzimet sociale të atdheut të tij, ai shpalos një galeri të gjerë personazhesh që nga koha e komunizmit deri më sot: një poet, i cili nga vargjet adhuruese për socializmin real, konvertohet në ekspert të poezive hajk, apo epitafeve për të vdekurit, një diplomat, që del i papunë nga "rinovimi i klasës politike", skulptori zyrtar i regjimit, që përfundon duke shitur vjeturina nëpër bankarelat e Firences..."

"Metamorfoza e një kryeqyteti" shënjon një fazë të re të letërsisë shqipe. Një libër antiheronjsh, që ashtu si dhe epoka që na rrëfen, të paktën në letërsi, pse jo dhe në realitet, përfundojnë të zhytur në groteskun dhe absurdin e jetës."


Romani "Metamorfoza e nje kryeqyteti", u botua nga shqip nga shtepia botuese ONUFRI, më 2019.



LINDITA KHANARI LATIFI, profesoresha e parë e gjuhës shqipe, që ka ligjëruar në Universitetin Trakya, Seksioni i Gjuhëve Ballkanike, në Edirne të Turqisë:

HAPJA E QENDRAVE ALBANOLOGJIKE NË TURQI, DOMOSDOSHMËRI

Intervistë dhënë gazetares Mimoza Hasani Pllana



Profesoreshë Lindita, duke parë CV tuaj, kuptojmë se interesimi juaj për ndikimin e gjuhës dhe kulturës turke në gjuhën dhe kulturën shqipe, duke i krahasuar edhe me gjuhët e kulturat tjera të Ballkanit ka nisur prej vitesh. Këtë tip kërkimesh e keni thelluar edhe më tej përmes studimeve të pavarura dhe hartimit të Fjalorit të Turqizimeve të Përbashkëta në Gjuhët e Ballkanit. Si u motivuat, kush ishte shkaku që ju shtyri drejt kërkimeve të tilla?

Lindita Khanari Latifi: E vërteta është se kontakti im me turqishten ka qenë shumë më i hershëm. Fillimisht e kam dëgjuar nga zëri i ëmbël i gjyshes dhe jam mësuar me tingëllimin e saj si gjuhë e huaj që në vogëli. Gjyshërit e mi kanë jetuar për një kohë të gjatë në Turqi. Më pas, gjatë studimeve universitare në Degën e Gjuhës dhe Letërsisë Shqipe, të Universitetit të Tiranës, mu shtua edhe interesi shkencor për të. Nxitjen e parë e mora gjatë zhvillimit të kursit special të Gjuhësisë Ballkanike me Akademik Shaban Demiraj, nën drejtimin e të cilit kam realizuar edhe një temë mbi huazimet turke në gjuhën shqipe, mbështetur në Fjalorin e Orientalizimeve të Tahir Dizdarit, që në vitet '80 gjendej si dorëshkrim në Arkivin e Institutit të Albanologjisë në Tiranë.

Mendimi për hartimin e një Fjalorit të Turqizimeve Ballkanike nuk qe i rastësishëm. Ai vjen në radhë pas punës për studimin e ndikimeve të gjuhës turke në gjuhën shqipe, por do të ishte krejtësisht i pamundur, nëse nuk do të armatosesha me dijen e duhur për këto ndikime edhe në gjuhët e tjera të Ballkanit.

Këtë dije e arrita jo vetëm përmes studimit të literaturës shkencore, por në mënyrë të veçantë përmes pjesëmarrjes së rregullt në mjaft kongrese, simpoziume dhe konferencave shkencore që organizohen në institucionet shkencore të Turqisë e në vende të ndryshme të Ballkanit, Evropës dhe Azisë. Kjo sepse gjatë këtyre aktiviteteve shkencore, si dhe në seminaret e hapura ku jam ftuar të mbaj ligjëratë në mjaft universitete turke, më është krijuar mundësia të njihem dhe të marr kontakt me gjuhëtarë, filologë, ballkanologë e turkologë nga më të mirët. Bisedat, diskutimet e ndonjëherë edhe debatet me ta me formësuan dhe me dhanë dijen e nevojshme për të vijuar punën. Kështu mësova se ashtu siç kemi në një kolos të këtyre studimeve, Tahir Dizdarin, po ashtu të gjitha vendet ballkanike kishin "Dizdarët" e tyre. Por, në kushtet tona, do të ishte pamundur mbledhja e literaturës së domosdoshme për fillimin dhe vijimin e punës, pa ndihmën e pakursyer të kolegëve të nderuar nga vende të ndryshme të Ballkanit. "Dizdarët" e Ballkanit dhe të gjitha studimet e tyre i gjeta falë dashamirësisë dhe ndihmës së pakursyer të kolegëve ballkanas.

Tri qenë elementët që më nxitën për hartimin e tij:

Së pari: kërshtëria apo grishja shkencore. Kureshtja për të vrojtuar gjendjen e këtyre huazimeve veç shqipes edhe në rumanisht, bullgarisht, serbisht, maqedonisht, greqisht, kroatisht dhe boshnjakisht. Dëshira për t'i krahasuar dhe për t'i ballafaquar me njëra-tjetrën.

Së dyti: kur e pashë veten të rrethuar nga një mori e madhe fjalorësh dhe studimesh për turqizmat, thënë më qartë, kur e pashë veten të rrethuar nga këta "Dizdarë" të Ballkanit, të cilët mes shumë sakrificave, kishin punuar secili nga 30-40 vjet për gjurmimin e turqizimeve në gjuhët e tyre, pa mundur ndoshta të komunikonin me njëri-tjetrin, për shkak të situatave e regjimeve politike të vendeve të tyre, ndjeva si detyrim shkencor dhe moral, ridimensionimin e kontributit të tyre të vyer dhe fjalorit që do të përfshinte gjithë kontributin e tyre, mu duk mënyra më e përshtatshme për ta bërë këtë. Tani vonë kam gjetur letërkëmbime të disa prej tyre (si ato të Tahir Dizdarit me turkologun e shquar hungarez Nemeth etj.), ku hidhnin idenë e hartimit të një fjalori të tillë, të cilin nuk mundën ta realizonin dot.

Së treti: synova një produkt shkencor që të ishte në dobi të punës shkencore të kolegëve e në mënyrë të veçantë të studentëve të mi, në mënyrë që fjalori t'u krijonte dhe t'u hapte fusha të reja studimi. Kështu bazuar në fjalor mund të studiohen çështje të përshtatjes fonetike, të përshtatjes morfologjike, të zhvillimeve semantike, të vlerave stilistikore e shumë të tjera si këto.

Turqia është një produkt evropiane dhe aziatike me diasporën më të madhe shqiptare, por që ndryshe nga vendet tjera, diaspora shqiptare në Turqi e pati të vështirë të ruajë gjuhën dhe kulturën e origjinës. Sa e kanë ruajtur shqiptarët e Turqisë gjuhën shqipe?

L.Xh.L.: Kjo është një çështje jo e lehtë për t'u vlerësuar, që ngjall diskutim dhe e vështirë për t'u trajtuar me pak fjalë në një intervistë. Diaspora shqiptare në Turqi na rezultoi të jetë diaspora më e madhe shqiptare në botë. Dhe jo vetëm kaq, është realisht edhe diaspora më e larmishme, më gjithëpërfshirëse për nga përbërja krahinore, e për rrjedhojë edhe për nga përbërja gjuhësore. Sigurisht që bëhet fjalë për disa milionë shqiptarë në Turqi. Jepen shifra të ndryshme për të, por e vërteta është se ende nuk kemi një studim të mirëfilltë dhe statistika të sakta mbi gjendjen e diasporës shqiptare atje. Kjo kushtëzohet si nga fakti që regjistrimi i popullsisë në shtetin turk nuk bëhet mbi baza etnike, ashtu edhe nga fakti se shpërnguljet e shqiptarëve drejt Turqisë kanë qenë të shumta në numër dhe janë kryer në periudha të ndryshme historike. Ato i kanë fillimet që në kohën e Perandorisë Osmane. Është fakt i njohur historik dhe mjafton të përmendim numrin relativisht të madh të vezirëve dhe sadrazemëve me origjinë shqiptare, që punuan si zyrtarë të lartë të perandorisë, apo grupe të tëra të zanatçinjve e ustallarëve që shkëlqyen me punën e tyre, siç bie fjala grupe të tëra të gurgdhendësve e skalitësve nga Kolonja e Erseka, që u thirrën nga arkitekt Sinani si ustallarët që do të realizonin arkitekturën e disa nga kryevepratë të tij në Stamboll e Edirne, e që për këtë arsye u vendosën me familjet e tyre në zonën e Thrakës. Lëvizja e dytë e madhe e shqiptarëve drejt Turqisë i takon kryesisht periudhës së viteve 1913-1914, e sidomos periudhës ndërmjet dy luftërave botërore. Më pas kemi zhvendosje të shqiptarëve, kryesisht shqiptarëve të Kosovës pas masakrës së Tivarit, si dhe shpërngulje të popullsisë çame nga Çamëria, për shkak të përndjekjes së tyre nga shteti grek pas Luftës së Dytë Botërore. Interesant mbetet fakti se shqiptarët megjithëse gjenden në çdo zonë gjeografike të Turqisë, kanë mundur të grupohen sipas krahinave nga vijnë. Kjo ka bërë që një pjesë e tyre të ruajnë gjuhën, doket e zakonet e trashëguara. Për të ardhur tek pyetja juaj, së pari na duhet të vlerësojmë se sa e kanë ruajtur shqiptarët e Turqisë gjuhën e tyre. Unë e di që mbisundon mendimi se shqiptarët e Turqisë janë asimiluar plotësisht dhe ndoshta ky mendim i përgjithshëm, që nuk e di se nga e ka zanafillën, ka çuar në vëmendjen e munguar ndaj kësaj diaspore dhe në mungesën e studimeve për të. Gjendja reale është krejtësisht në antonimi me mendimin e përgjithshëm. Shqiptarët e Turqisë e kanë ruajtur gjuhën e tyre dhe jo vetëm gjuhën, por edhe një pjesë të elementëve të kulturës, doket, zakonet, folklorin etj., por sigurisht që ky proces nuk ka qenë i njëjtë për të gjitha shtresëzimet dhe grupimet e shqiptarëve që përmenda pak më parë. Një pjesë e shtresëzimeve më të hershme pothuajse e kanë humbur dhe kanë ruajtur vetëm elementët të caktuar të saj. Mjafton t'ju përmend se si e kanë ruajtur shqiptarët e Thrakës, Edirnesë e Ibriktepesë, me prejardhje nga Erseka e Kolonja, toskërishten e tyre. Por, shqipja e shqiptarëve të Turqisë dallon nga ajo e diasporave të tjera shqiptare në botë, për shkak të larmisë së madhe që ngërthen në vetvete, larmi që vjen qoftë si rezultat i shpërnguljeve në periudha të ndryshme e të largëta kohore nga njëra-tjetra, qoftë edhe për shkak të origjinës krahinore, e për këtë arsye edhe dialektore apo të folmeve më të ngushta krahinore.

Krejt vonë u lejua mësimi në gjuhën shqipe në arsimin parauniversitar dhe atë të lartë. Si e vlerësoni, pse duhet të ketë ndodhur kjo ngecje?

L.Xh.L.: Arsyet mund të jenë të shumta dhe mund të kenë ndikuar mjaft faktorë. Për të qenë më të saktë në lidhje me këtë çështje na duhet të diferencojmë së pari marrëveshjet shtetërore mes institucioneve zyrtare nga përpjekjet e shoqatave të diasporës shqiptare në Turqi për hapjen e kurseve të mësimi të gjuhës shqipe. Shoqatat e diasporës shqiptare në Turqi janë të shumta. Numërohen me dhjetëra të tilla dhe ato janë të përhapura në zona të ndryshme të Turqisë, pothuajse gjithkund ku ka ngujime shqiptarësh, por në mjaft raste nuk ekziston ndonjë marrëdhënie e fortë mes tyre.

Megjithatë vitet e fundit vihen re përpjekje serioze për t'u organizuar e në mënyrë të veçantë jo vetëm për të rritur vetëdijen kombëtare, por edhe për të mbajtur gjallë gjuhën shqipe, sidomos tek fëmijët e të rinjtë, përmes kurseve të saj. Përpjekjet e tyre fillimisht u finalizuan me hapjen e Qendrës së Kulturës Shqiptare "Sami Frashëri" në Ankara, në shkurt të vitit 2015. Projekti për hapjen e saj u ideua nga ambasada

e Kosovës dhe ajo e Shqipërisë në Ankara dhe administrohet prej tyre, duke synuar kthimin e saj në një vatër të kultivimit të gjuhës e trashëgimisë kulturore shqiptare, për ta afirmuar atë, për ta mësuar atë, si dhe për të bashkuar rreth saj diasporën e atjeshme shqiptare. Po të bëjmë pyetjen: kur ka filluar zyrtarisht mësimi i gjuhës shqipe në Turqi, përgjigja për të është: shumë vonë. Fillimisht u hap dega e gjuhës shqipe në nivel universitar e dhjetë vite më pas, në mars të vitit 2017 me vendim të posaçëm të shtetit turk mësimi i gjuhës shqipe u fut si lëndë me zgjedhje në të gjitha shkollat turke të arsimit të etëvjeçar. Aplikimi i këtij vendimi filloi në vitin akademik 2017-2018 me hapjen e njërit prej këtyre kurseve, në një qytezë të Izmirit (Kemalpaşa), në shkollën të etëvjeçare Aliya Izzetbegović. Gjuha shqipe në këtë shkollë u përzgjedh si lëndë nga 44 nxënës, të cilët u grupuan në dy klasa. Ata zhvillojnë dy orë mësimi në javë në gjuhën shqipe dhe për të zgjeruar njohuritë u janë krijuar kushte të ndjekin edhe orë shtesë në fundjavë. Grupe të tilla nxënësish që përzgjedhin gjuhën shqipe kanë filluar të krijohen edhe në shkollat e tjera të zonave të tjera të Turqisë. Dy vitet e fundit numri i këtyre kurseve ka ardhur në rritje. Kurset janë hapur kryesisht në qytet e mëdha si në Stamboll, Izmir, Bursë etj., ku dihet se ka një përqendrim më të madh të diasporës shqiptare.

Profesoreshë Lindita, keni pasur fatin e mirë që jeni nga profesoret e para që keni ligjëruar për gjuhën dhe letërsinë shqipe në Turqi, por edhe nga të rrallat që e njihni procesin e themelimit të studimeve albanologjike atje. Si rrodhi procesi deri në hapjen e katedrës albanologjike në Universitetin Trakya?

L.Xh.L.: Po është e vërtetë dhe për të qenë e sinqertë në profesionin e mësimdhënësës së gjuhës shqipe, që e ushtrorë prej mbi dy dekadash, është një nga ngjarjet që më ka emocionuar më shumë se çdo gjë tjetër. Kjo sepse pata fatin të merrja pjesë në këtë marrëveshje, si dhe të isha pedagogia e parë e gjuhës shqipe në Universitetin e Trakyas në Turqi së bashku me Prof. dr. Ethem Likaj. Për mua ishte një detyrë mjaft e rëndësishme, që mbarnte një përgjegjësi mjaft të madhe, pasi fillimi gjithmonë është më i vështirë. Kjo marrëveshje e parë universitare e njëkohësisht shtetërore e zyrtare u nënshkruar në fund të vitit 2006 nga Rektori i atëhershëm i Universitetit të Tiranës Prof. dr. Shezai Rrokaj dhe Rektori i atëhershëm i Universitetit të Trakyas Prof. dr. Enver Duran. Zbatimi i saj filloi në vitin akademik 2007-2008 e vazhdon deri sot. Në këtë vit akademik Universiteti i Trakyas hapte për herë të parë programet e disa gjuhëve ballkanike, ku boshnin pjesë gjuha shqipe, gjuha greke, gjuha bullgare dhe ajo boshnjake. Studentët fillimisht hynin në programin e vitit parapërgatitor të gjuhës shqipe dhe pasi jepnin provimin përfundimtar dhe merrnin rezultatin e duhur, kalonin në studimet universitare të gjuhës shqipe.

Vitet e fundit në Turqi ka pasur edhe një zhvillim tjetër të rëndësishëm në lidhje me gjuhën shqipe. Kjo ka të bëjë me vendimin e publikuar në fletoren zyrtare me 7 shkurt 2018, që i hap rrugën mbrojtjes zyrtare të shqipes në Turqi. Që në fillim interesi qe mjaft i madh. Dokumenti i lëshuar nga Qendra e Përzgjedhjes dhe Sistemimit të Nxënësve (OSYM) pas korrigjimit të provimit, mundëson gjithashtu edhe shpërbllim për nëpunësit shtetërorë që zotërojnë këtë gjuhë. Dokumenti i lëshuar nga kjo qendër njihet jo vetëm në institucionet shtetërore, por edhe nga sektori privat. Shqipja në këtë mënyrë fiton statusin e gjuhëve që pranohen për t'u mbrojtur në rastin e specializimeve në sistemin master e doktoraturë.

Sa janë të interesuar të rinjtë e Turqisë për të mësuar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare?

L.Xh.L.: Në fillimet e veta pati një lloj interesi dhe numri i studentëve të regjistruar në seksionin e gjuhës shqipe ishte relativisht më i madh, sesa ai i studentëve të regjistruar në gjuhët e tjera të Ballkanit. Studentët ishin turq dhe vinin nga krahinat e ndryshme të Turqisë. Tregonin gjithmonë me kënaqësi çfarë dinin për shqiptarët, duke përmendur gjithmonë fqinjë ose të afërm të tyre që ishin me origjinë shqiptare. Departamenti i Gjuhës Shqipe, të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë, të Universitetit të Tiranës, u mundësoi gjithashtu pjesëmarrjen në Shkollën Verore të Gjuhës Shqipe që organizohet prej shumë vitesh nga ky departament përgjatë gjithë muajit shtator.

Bazuar në përvojën tuaj si mësimdhënëse, a keni pasur rastin të keni studentë me origjinë shqiptare që nuk flasin shqipen, por kanë dëshirë të mësojnë gjuhën e të parëve të tyre?

L.Xh.L.: Befasia kjo ishte, të paktën gjatë kohës kur kam punuar në këtë universitet, nuk kam pasur asnjë student nga diaspora shqiptare.

A mund të flasim edhe për praktikën e përkthimit të letërsisë turke. Për arsye të rrethanave të njohura historike, kultura dhe gjuha turke ka lënë gjurmë në gjuhën dhe kulturën shqipe, sa ju ndihmon kjo dukuri në përkthimin e veprave letrare?

L.Xh.L.: Përkthimi është një proces i ndërlikuar që nuk ka lidhje vetëm me nivelin e njohjes së gjuhës së huaj e të gjuhës mëmë, pasi kërkon jo vetëm bagazh të gjerë gjuhësor e fond leksikor të gjithanshëm, por kërkon gjithashtu të depërtosh thellë në botën e shkrimtarit që përkthen e të jetës së personazheve të tij.

Shkurtimisht mund të them se letërsia turke në tërësi e vet është sa realiste, aq edhe romantike, sa historike aq edhe me tematikë të së përditshmes. Është një letërsi që na informon, një letërsi që prek edhe ndjenjat më të holla njerëzore, pasi i ka në objektivin e vet ato, por është në të njëjtën kohë edhe një letërsi që na tregon elementet e përbashkëta të kulturës në mjaft përmasa: në kulturë, në kulinari, në gjuhë, në zakone, etnografi, në arkitekturën e shtëpisë, në veshje, në muzikë, në folklor, në mentalitet etj. Edhe këto elementë të përbashkët kulturorë duke ndihmuar në kuptimin e veprës letrare, ndihmojnë gjithashtu edhe në përkthimin e saj në shqip. Në mjaft prej romaneve ndeshim shpesh një personazh shqiptar, a me origjinë shqiptare, e kjo bën që lexuesit t'i duket se gjen shpesh veten e tij brenda saj. Diku përmendet një vezir a sadrazam me origjinë shqiptare, diku Berati, Shkodra e Prizreni e diku tjetër Arnavut çigëri apo Elbasan tavasi. Funkzioni kryesor i letërsisë në thelb mbetet funksioni estetik. Ajo synon të kënaqë shijet estetike të lexuesit. Por veç kësaj ajo ka edhe funksion informues, pasi përmes artit të fjalës na bën me dije për ngjarje historike, situata, çështje e probleme qoftë të së kaluarës e qoftë të së tashmes. Por përkthimi i letërsisë turke ka edhe vështirësi të veta, që lidhen si me tematikat, frazeologjinë dhe terminologjinë e veçantë të përdorur aty, ashtu edhe me veçoritë specifike sintaksore të turqishtes në dallim nga shqipja. Ajo është sa e veçantë, aq edhe e prekshme dhe e kuptueshme nga lexuesi shqiptar, pasi është shumë pranë mentalitetit të tij, është një letërsi sa reale e pa deus ex machina, aq edhe shpirtërore e emocionuese.

Si pas vlerësimit tuaj, cilët autorë shqiptarë më janë të lexuar në turqisht?

L.Xh.L.: Për fat të keq është përkthyer shumë pak letërsi shqipe në gjuhën turke. Mund të them se veprat e përkthyer në këtë gjuhë numërohen me gishta. Madje në një pjesë të rasteve nuk janë përkthyer direkt nga shqipja, por janë përkthyer përmes një gjuhe të tretë. Kështu ka ndodhur për shembull me vepra të Kadaresë që janë përkthyer nga frëngjishtja.

Si e keni bërë përzgjedhjen e veprave që keni përkthyer ishte subjektive, apo e ndikuar nga kritika letrare dhe përse ju pëlqen letërsia turke?

L.Xh.L.: Një pjesë janë përzgjedhje personale, ndërsa një pjesë tjetër ndikime të kritikës letrare. Prej kohësh jam lexuese e rregullt e letërsisë turke dhe kam fatin të njoh personalisht jo vetëm studiues turq të letërsisë, por edhe shkrimtarë e kritikë letrarë. Kjo më ka ndihmuar se tepërmi, pasi bëhet fjalë për një letërsi mjaft të gjerë e me një prodhimtarit të madhe.

Është bukur të lexosh letërsinë turke në origjinal, por është gjithashtu bukur kur e lexon atë të përkthyer në shqip. Nëse dikush pyetet se përse të tërheq e të pëlqen letërsia turke, përgjigjet mund të ishin të gjithfarëllojshme: për tematikë e saj, për ndjenjat që transmeton e ndjenjat që ngjall, për emocionin që shkakton, për romantizmin e saj, për stilet letrare që mbart etj. Ndërsa unë vetë, si përkthyes e saj, do të thosha se e pëlqej pasi të imponon t'i rikthehesh gjithmonë veprës që lexon, jo një herë të vetme, por dy, tre, katër herë e në vazhdim, e përsëri të duket sikur ke etje për ta lexuar nga e para atë....

Janë rreth 20 vepra të njohura të letërsisë turke që keni përkthyer në gjuhën shqipe. Si u arritur kaq rezultate nga kjo punë e vështirë, me mbështetje të institucioneve turke, apo punë e juaja vullnetare?

L.Xh.L.: Fillimi nuk ka qenë aspak i lehtë, pasi procesi i përkthimit kërkon kohë dhe mjaft sakrificë të tjera. Kam përkthyer si vepra të letërsisë klasike turke, ashtu edhe vepra të letërsisë moderne. Të gjitha përkthimet që kam realizuar janë mbështetur nga projekti TEDA në Turqi, i cili që prej më shumë se dhjetë vitesh mbështet përkthimin e letërsisë turke në rreth 100 vende të botës.

Po nga vepra e autorëve shqiptarë, kë mendojnë të përktheni në turqisht?

L.Xh.L.: Në të vërtetë janë disa. Përkthimi i tyre hyn në planet e së ardhmes. Janë vepra që i takojnë romantizmit

shqiptar, si dhe vepra të autorëve bashkëkohore. Më mirë të mbeten surprizë për lexuesin.

Si qëndron bashkëpunimi me qendrat universitare shqiptare dhe ato turke, e kam fjalën në funksion të shkëmbimit të përvojave në mes mësimdhënësve, studentëve si dhe pasurimit me literaturë?

L.Xh.L.: Prej kohësh vihen re përpjekje për të bashkëpunuar sidomos mes qendrave universitare. Kështu Departamenti i Historisë i Fakultetit të Historisë e të Filologjisë, të Universitetit të Tiranës ka organizuar konferenca shkencore të përbashkëta me universitete turke, si me Universitetin e Sakaryas dhe atë të Trakyas.

Në kuadër të bashkëpunimeve shkencore në dobi të studentëve ky departament, në bashkëpunim me Institutin "Yunus Emre" dhe Universitetin e Stambollit ka organizuar për disa vite rresht Shkollën Verore të Osmanishtes. Ideja për hapjen e një shkolle të tillë lindi si rrjedhojë e domosdoshmërisë së krijimit të një grupi studiuesish të rinj, të cilët duhet të kenë një formim më të specializuar, për të përballuar nevojat e shumta që kanë arkivat dhe rrethet shkencore, në çështje të transkriptimit, interpretimit dhe vlerësimit të saktë shkencor të dokumentacionit që gjendet në arkivat brenda dhe jashtë vendit. Në Arkivin e Shtetit Shqiptar gjenden mjaft dokumente ende të patranskriptuara. Në Arkivat e shtetit turk, e sidomos në atë të Stambollit dhe disa vendeve të tjera të Ballkanit gjenden edhe shumë të tjera.. Bëhet fjalë për dokumentacione që kanë lidhje me Shqipërinë dhe tokat shqiptare. Gjithashtu ekziston një fond i veçantë dhe mjaft i madh, që mbulon një periudhë letrare prej afro 120 vjetësh e që përfshin një mori të madhe poetësh, përkthyesish dhe leksikografësh, të cilët e kanë shkruar shqipen me alfabet arabo-osman ende i pastudiuar si duhet. Së fundi, për shkak të mosnjohjes së gjuhës, filologjia jonë nuk ka shqyrtuar ende një numër relativisht të madh të gazetave, revistave, fletoreve dhe periodikëve të ndryshëm që janë botuar në Stamboll nga shoqatat atdhetare shqiptare, të cilat përmblajnë të dhëna mjaft interesante për historiografinë, gazetarinë, gjuhën dhe kulturën tonë. Kjo mosdije ka bërë që t'u qëndrojmë ende larg veprimtarive politike e kulturore jo vetëm të shoqatave, por edhe të personalitetëve shqiptarë që kanë punuar, jetuar e që kanë zhvilluar veprimtarinë e tyre në administratën shtetërore të perandorisë osmane. Mjaft punime të tyre, dorëshkrime e materiale të tjera qëndrojnë ende në arkivat turke të pabotuara. Mjafton të përmendim dosjet dhe letërkëmbimet e Sami Frashërit, Hoxha Tahsinit etj.

Tani së fundmi me shtimin e kurseve të gjuhës shqipe bashkëpunimi duhet të shtrihet edhe në çështje të hartimit të teksteve për mësimin e gjuhës shqipe, si dhe të dërgimit të lektorëve që janë specialistë të kësaj mësimdhënieje. Bashkëpunimi me qendra të specializuar për hartimin e këtyre teksteve, që kanë një përvojë mjaft të gjatë në mësimdhënies e gjuhës shqipe për të huaj e për shqiptarët jashtë atdheut, siç janë departamentet e gjuhës shqipe në Universitetin e Tiranës dhe në Universitetin e Prishtinës do të ishte në dobi të çështjes dhe do të siguronte cilësinë.

Personalitet të rralla shqiptarë ndër shekuj kontribuuan për zhvillimin e Turqisë në shumë fusha. Ndalemi të rilindësit tanë, si Samiu etj. Si nderohen sot këto figura madhore nga komuniteti arsimor e kulturor turk dhe ai shqiptarë në Turqi?

L.Xh.L.: Figura poliedrike e Sami Frashërit, ose Shemshedin Samiut siç i thonë turqit, është nga figurat që zë një vend të veçantë në filologjinë turke e qe nderohet nga të gjithë. Për të në Turqi janë shkruar mjaft libra, studime, bibliografi etj. Ai është linguisti, eruditi, dramaturgu e gazetari që qëndroi e vazhdon të qëndrojë mes dy kombeve, mes dy shteteve, mes dy gjuhëve, e për rrjedhojë mes dy filologjive tona. Përmbledhtazi, mund të themi se shkroi afro 60 vepra me rreth 20 000 faqe, dhe të gjitha këto në shqip e osmanisht. Sami Frashëri është një medaljon i artë në qafën e filologjisë së dy vendeve tona dhe leximi vetëm i njërës anë të medaljes, nuk do bënte gjë tjetër, veçse do ta dëmtonte këtë figurë dhe madhësinë e saj. Sikurse nuk mund të ndahet vepra e tij shqipe nga letërsia shqiptare dhe aktiviteti i tij politik dhe patriotik nga lëvizja kombëtare shqiptare, po kështu edhe veprat e tij shkruar turqisht s'mund të shikohen të izoluara nga letërsia, leksikografia dhe filologjia turke.

Në fund, a mund të flasim për projektet tuaja aktuale lidhur me zhvillimin e studimeve të gjuhës dhe letërsisë shqipe në Turqi dhe a mund të presim hapjen e katedrave të reja të albanologjisë atje?

L.Xh.L.: Për mua ka qenë dhe vijon të mbetet domosdoshmëri çështja e një studimi të hollësishëm mbi diasporën shqiptare në Turqi. Ky studim duhet të bëhet paralelisht në disa fusha duke përcaktuar historikun e krijimit të kësaj diaspore, gjeografinë e shpërnguljeve shqiptare drejt Turqisë, gjeografinë e përhapjes dhe vendosjet së saj atje, elementet gjuhësore, kulturore, etnografike e folklorike që janë ruajtur, si dhe perspektivat e ruajtjes dhe vazhdimet të tyre. Një studim i tillë do të na mundësojë realizimin e studimeve të karakterit sinkronik, për të diktuar gjendjen e dialekteve dhe të folmeve të hershme të shqipes në një periudhë të caktuar, si dhe realizimin e studimeve diakronike duke përqasur veçoritë e të folmeve të caktuara në shtresa të ndryshme kohore.

Hapja e qendrave të tjera albanologjike në Turqi, është

domosdoshmëri. Kemi nevojë për krijimin e qendrave të mirëfillta studimore, që nuk do të merren vetëm me mësimdhënien e gjuhës shqipe, por që do të mundësojnë studimin në arkiva e biblioteka, për realizimin e studimeve me karakter gjithëpërfshirës.



LINDITA XHANARI (LATIFI) u lind në Tiranë më 29 mars 1969. Studimet e larta i përfundoi në vitin 1991 në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë, Dega Gjuhë-Letërsi. Që nga viti 1996 ajo është pedagoge në Departamentin e Gjuhësisë të Fakultetit të Historisë e të Filologjisë së Universitetit të Tiranës, e specializuar në fushën e gramatikës. Ajo ka një karrierë të gjerë profesionale si në fushën e mësimdhënies, ashtu edhe në fushën e studimeve shkencore. Gjatë periudhës 2003-2004 ajo ka punuar si lektore e gjuhës shqipe në Universita degli Studi di Palermo, Facolta di Lettera e Filosofia, në Itali, ndërsa gjatë viteve 2007-2010 ka kontribuar për hapjen e Degës së Gjuhës Shqipe në "Balkan Dilleri Bölümü" në Universitetin e Trakyas, në Edirne të Turqisë, duke u bërë mësimdhënësja e parë e gjuhës shqipe atje. Gjatë periudhës 2004-2006 ndoqi studimet pasuniversitare dhe në mars të vitit 2009 mori titullin "Doktor i shkencave në Gjuhësi", në Fakultetin e Historisë dhe të Filologjisë, Departamenti i Gjuhësisë. Në shtator të vitit 2009 fitoi titullin Docent dhe në maj të vitit 2014 mori titullin akademik Profesor i asociuar në gjuhësi. Në studimet e filologes Lindita Khanari (Latifi) një vend mjaft të rëndësishëm zënë kërkimet shkencore në fushë të Gjuhësisë Historike dhe Gjuhësisë Krahasuese, ku spikasin disa punime monografike dhe fjalorë me tematikë mbi marrëdhëniet gjuhësore të shqipes me turqishten dhe gjuhët e tjera orientale, si dhe marrëdhëniet gjuhësore mes gjuhëve ballkanike dhe turqishtes. Studiuesja Lindita Khanari (Latifi) është pjesëmarrëse e mjaft konferencave, seminareve e kongreseve shkencore brenda dhe jashtë vendit, duke kontribuar veçanërisht në fushën e Gjuhësisë Krahasuese. Ajo është anëtare e Këshillit Shkencor të mjaft konferencave shkencore në Turqi dhe vende të ndryshme të Ballkanit, si dhe anëtare e Bordit Shkencor e gjykatëse shkencore në mjaft revista shkencore në Turqi. Përgjatë dhjetë viteve të fundit ajo është ftuar në disa universitete të Turqisë për të referuar si folëse e ftuar në aktivitete të ndryshme shkencore, si dhe për të mbajtur seminare të hapura me studentë të sistemit bachelor, master dhe studentë të shkollave doktorale. Ajo është anëtare e Komisionit të Transkriptimit të Fjalëve të Huaja në Gjuhën Shqipe në Këshillin Ndërkademi të gjuhës shqipe në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, si dhe përfaqësuesja e TDK në Ankara të Turqisë për Shqipërinë. Gjithashtu është anëtare e Drejtorisë së Seminarit Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, Prishtinë. Profesoreshë Lindita Khanari (Latifi) është për disa vite rresht koordinatore dhe përgjegjëse e Shkollës Verore të Osmanishtes, që organizohet nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë të Universitetit të Tiranës, në bashkëpunim me Institutin e Gjuhës dhe Kulturës Turke "Yunus Emre" në Tiranë. Kontributi i kësaj studiueseje shtrihet edhe në fushën e përkthimeve të letërsisë turke në gjuhën shqipe. Kështu ajo është përkthyes e mbi njëzet veprave të letërsisë klasike dhe moderne nga turqishtja.



Aktorët e regjistruan shfaqjen në shtëpinë e Profesoresha Shaughnessy më 8 tetor 2020. Rreshti i parë (nga e majta në të djathtë): David Schmitz (Zë, Hermesi, Poseidoni); Susan Shaughnessy, Regjisore. Rreshti i pasmë (majtas në të djathtë): Ricketts Race (Zeusi, Herkuli, Pushteti); Alexi Smith (Erebi, Zë, Hadesi, Hefesti, Apolloni, Epimetheu); Sarah Helsley (Dramaturgu, Filozofi, I panjohuri, Hyjnesha); Lucy Dismore (Zëri, I panjohuri, Dhuna, Hyjnesha, Dejanira); Andie Fuentes (Hypnosi, Zëri, Hyjnesha, Hera); Chandler Ryan (Ëndrra Mashtruese, Zëri, Hyjnesha); Max Breaux (Prometheu, Oqeani). Fotoja nga Ioannis Andriotis.

Të përkthesh Kadarenë për skenën: Stinë e mërzitshme në Olymp

Fabrice Conte-Williamson

University of Wisconsin-Parkside

World Literature Today, Shkurt 2021

Në fund të 2019-ës, unë dhe David Bellos u kontaktua nga Daniel Simon dhe World Literature Today për një projekt përkthimi të dramës së Ismail Kadaresë të vitit 1998, *Stinë e mërzitshme në Olymp*. Qëllimi ishte të bëhej përkthimi i parë në gjuhën angleze i veprës së vetme dramatike të autorit, e cila më pas do të vihej në skenë si një ngjarje teatrale e drejtpërdrejtë kur të shfaqej në vjeshtën e ardhshme, si pjesë e festimeve për Kadarenë si shkrimtari i vlerësuar me Çmimin Ndërkombëtar për Letërsinë Neustadt 2020.

Pa diskutim, prisja të bashkëpunoj ngushtë me Dr. Bellos-in, një përkthyes i mirënjohur, biograf i vlerësuar me çmime dhe specialist me famë botërore i veprës letrare të Kadaresë. Si drejtor teatri, më ngazellen dinamika e procesit të bashkëpunimit dhe ky projekt më siguroi mundësi unike për të zhvilluar një lloj të ri marrëdhënieje krijuese. Më e rëndësishmja, njohuritë e thella të Dr. Bellos-it për botën e Kadaresë dhe vlerësimi i tij i madh për mitologjinë e saj si labirint - ai ka përkthyer disa nga romanet e tij - dolën të jenë cilësi të paçmueshme kur e filluam këtë udhëtim letrar. Çka ishte dhe më e rëndësishme, procesi i bashkëpunimit do të vazhdonte edhe pas përfundimit të përkthimit: Profesoresha Susan Shaughnessy e Shkollës së Dramës Helmerich të Universitetit të Oklahomas dhe unë ishim përcaktuar për ta përshtatur dramën, dhe ajo kishte pranuar përgjegjësitë e drejtueses për premierën në SHBA gjatë festivalit.

Sidoqoftë, u desh të hiqet dorë nga planet për një varg shfaqjesh të *Stinë e mërzitshme në Olymp* që do të mbaheshin gjatë përvjetorit të pesëdhjetë të Festivalit Letrar Neustadt pas fillimit të asaj ngjarjeje që do të përcaktonte vitin 2020: pandemia Covid-19. Në fillim të pranverës, kriza shëndetësore e përqësuar me shpejtësi kishte nxitur anulimin e papritur të shumicës së konferencave dhe festivaleve si dhe mbylljen e pashmangshme të teatrove në të gjithë vendin. Kështu, u bë e vështirë të imagjinohej se si drama do të vihej në skenë duke pasur parasysh kufizimet dhe protokollet e vendosura rishtas që synonin ngadalësimin e përhapjes së virusit. Pavarësisht nga kjo tablo e zymtë, organizatorët e festivalit njoftuan se ngjarja do të mbahej virtualisht, duke përdorur platformën Zoom. Ky format alternativ siguroi një mjedis të sigurt për pjesëmarrësit e festivalit dhe në fund të fundit bëri të mundur që të merrte pjesë një audiencë më e gjerë dhe më ndërkombëtare. U bë e qartë se edhe vënia në skenë e *Stinë e mërzitshme në Olymp* duhej të përqafonte prirjen e ngjarjeve virtuale, dhe kështu u vendos që të regjistrohej shfaqja në stilin e një radio-drame të modës së vjetër ose librit më modern në format audio. Regjistrimi do të redaktohej dhe më vonë do të transmetohej përmes Zoom-it.

Ndërsa po zhvilloheshin përgatitjet për festivalin virtual, unë dhe Dr. Bellos vazhduam të punojmë për përkthimin. Detyra jonë ishte posaçërisht të përkthenim dramën nga versioni i saj frëngjisht i

Jusuf Vrionit, me titull *Mauvaise saison sur l'Olympe*, në një skenar besnik ndaj tekstit origjinal të autorit dhe tërheqës për aktorët që do ta interpretonin. Megjithëse Kadare nuk duket se e ka shkruar dramën me qëllimin e hapur të shfaqjes në skenë, artistët e teatrit priren t'i shohin të gjitha veprat e letërsisë dramatike si vepra me potencial të tillë. Në fakt, e pranoj se do të ishte gati e pamundur për mua të mos imagjinoja se si një tekst dramatik mund të vihej në skenë ndërsa isha në procesin e leximit të tij. Edhe shfaqjet e klasifikuara si "dramat për lexim" - të krijuara kryesisht për kënaqësinë e lexuesit dhe të pashqetësuar për sfidat dhe kërkesat e vënies në skenë - janë nxitës të zjarrtë për të zgjuar shtysat e mia më të thella regjisoriale. Prandaj, ky përkthim i tragjedisë së Kadaresë s'ishte kurrë një qëllim në vetvete por më tepër korniza për një strukturë shumë më të gjerë që do të përfshinte kontributet e shumë artistëve të tjerë: midis tyre një regjisor, një grup aktorësh, një inxhinier i zërit dhe një dramaturg.

Procesi i përkthimit në anglisht hasi në disa sfida. Sfidat e parë kishte të bënte me cilësinë e versionit frëngjisht të Vrionit. Do të ishte e drejtë që gjuha e saj të përshkruhet si e ndërlikuar, e stërholluar në mënyrë magjepsëse, dhe ndonjëherë e pazakontë. Megjithëse ky tekst ofron një përvojë të kënaqshme për lexuesin, ai me gjasë s'ishte krijuar duke pasur në mendje aktorët. Kësisoj, një pjesë e madhe e procesit tim iu përkushtuar zhbërjes së nyjeve gjuhësore të përkthimit të Vrionit,

për të hetuar zgjedhje të posaçme befasuese ose të pazakonta leksikore dhe për të hartuar një strategji që do të krijonte një tekst më të përshtatshëm për lojë aktoriale. Gjatë gjithë këtij procesi, shqyrtova në mënyrë sistematike mënyrën se si do të tingëllonin rreshtat kur të interpretoheshin nga aktorët, shpesh duke i lexuar skenat me zë të lartë në zyrën time, duke vlerësuar efektshmërinë e fjalëve dhe të strukturës së fjalisë në ligjërimin e folur.

Sfida e dytë kishte të bënte me ndërrimet e vazhdueshme të tonit dhe regjistrimit të folurit, karakteristikë themelore e kësaj drame. Për shembull, dy dukjet e para paraqesin ekspozicionin e veprës me anë dialogëve lojçak deri diku të rastësishëm midis personazheve që bisedojnë përbri një ndërtese hyjnore-zyrtare në malin Olymp. Krejt ndryshe, dukja e tretë - e cila zhvillohet në Tokë - është shkruar në një lloj para-gjuhe imagjinare. Në këtë skenë, Kadare përshkruan agimin parak të njerëzimit me personazhe që flasin me rreshta jashtëzakonisht të shkurtër - shumë herë vetëm një fjalë të vetme - sikur vetë gjuha të ishte në foshnjërinë e saj. Dukja e katërt, përqendrohet te gjyqi i Prometheut, merr një ton më juridiko-politik ndërsa hyjnitë debatojnë për vjedhjen e zjarrit, dëgjojnë dëshmitarë të ndryshëm dhe diskutojnë fatin e të pandehurit. Dukja e pestë dhe e gjashtë kthehen në dialogun lojçak ndërsa tek e shtata dhe e teta kemi ndërrim të veçantë të regjistrimit në dramë. Të dyja përmbajnë fjalime më të gjata me nëntekst më të njohur filozofik ndërsa Prometheu reflekton mbi veprimet e veta, mbi marrëdhënien e tij të paqartë me pushtetin dhe mbi dënimin që ka marrë. Dukja e dhjetë, e njëmbëdhjetë dhe e trembëdhjetë kanë cilësi të ngjashme. Nga ana tjetër, dukja e nëntë, e dymbëdhjetë dhe e katërbëdhjetë dallohen qartë nga pjesa tjetër. Të tre skenat paraqesin disa hyjni që dialogojnë me stilin e thashethemeve të adoleshentëve, duke i bërë këto pjesë më shumë të kujtojnë filmin kult Vajzat e liga sesa tragjeditë e Eskilit.

Me një larmi të tillë midis dukjeve të ndryshme, përkthyesit duhej të gjenin mënyrën për të krijuar një peizazh gjuhësor të qëndrueshëm për shfaqjen në tërësi, duke respektuar gjithashtu ndryshimet e rëndësishme të tonit dhe regjistrimit që i japin secilës tablo ngjyresën e saj unike. Këto ndryshime midis dukjeve janë thelbësore sepse ato pohojnë strukturën episodike të Stinë e mërzitshme në Olymp, një aspekt themelor i dramës evropiane postmoderne. Unë edhe strukturën e shfaqjes do ta përshkruaja si narrative kaleidoskopike - ose një formë e kozmosit - në përgjigje



Fabrice Conte-Williamson

të shënimit të autorit që ndjek dramatis personae: “Ngjarja zhvillohet në tri nivele: në qiell, në tokë, dhe nëntokë. Koha e ngjarjes është e përgjithshme, pa kahje, me rrjedhë të ndryshme në qiell, në tokë dhe nëntokë”. Në fund, ndërrimet dalluese në stilet gjuhësore përforcojnë qartë botët paralele të tragjedisë së Kadaresë.

Nga marsi deri në korrik 2020, procesi i përkthimit ndoqi një model të thjeshtë, por të frytshëm. Përgatita një variant për secilën dukje, të cilën ia dërgova Dr. Bellos-it. Ai u treguar bujar në reagimet e tij, duke i shoqëruar me shënime dhe sugjerime. Letërkëmbimi i tij zakonisht përmbante informacione shtesë

informuese për elementë të veçantë të skenarit - në veçanti se si ato i bëjnë jehonë disa episodeve në jetën e Kadaresë dhe në historinë politike të Shqipërisë. Ai gjithashtu vinte në pah menjëherë rastet e shumta të ndërtektorësisë brenda krijimtarisë së Kadaresë. Për shembull, Ëndrra Mashtruese, personazh dytësor te Stinë e mërzitshme në Olymp, shfaqet edhe në botimin në frëngjisht La Porteuse de songs, një tregim i vitit 1993. Kështu duket se opusi i veprës së Kadaresë funksionon si një univers i gjerë mitologjik në të cilin secila vepër kontribuon në mozaikun e përgjithshëm letrar.

Shfaqja e Stinë e mërzitshme në Olymp në formatin frymëzues të libri audiofonik, në një farë mënyre, ishte edhe një lloj përkthimi, një metamorfozë teatrale nga faqja e librit në skenë - në këtë rast një skenë dëgjimi. Arritjet e Profesor Shaughnessy-t dhe pjesës tjetër të ekipit të realizimit ishin edhe më mbresëlënëse duke pasur parasysh sfidat e paraqitura nga pandemia. Në fund të fundit, s'mund të mos pyes veten nëse ky format i librit audio ishte ndoshta mënyra më e mirë për ta paraqitur një dramë të tillë epike pasi imagjinatën tonë e mbante plotësisht të mbërthyer tek ajo dhe theksonte bukur tekstin e fuqishëm të Kadaresë. Vënia në skenë e veprave dramatike të autorëve bashkëkohorë mbetet një aspekt vendimtar i shfaqjeve në teatër dhe paraqitja e Stinë e mërzitshme në Olymp është një kontribut i rëndësishëm për këtë mision kulturor që vazhdon.

Përktheu nga origjinali Granit Zela



Fabrice Conte-Williamson është regjisor, actor, pedagog i teatrit, dhe ligjërues në kurset e shfaqjeve teatrale dhe historisë së teatrit në Universitetin e Wisconsin - Parkside. Është diplomuar në nivelin e Masterit në Artet e Bukura dhe në regji në Universitetin e Nice Sophia Antipolis dhe ka mbaruar studimet e doktoraturës ndërdisiplinare në Shkollën e Dramës në Oclahoma Helmerich University. Nga viti 2007 deri në vitin 2013 ishte Asistent Profesor i teatrit dhe kryetar i Departamentit të Arteve Pamore dhe Skenike në Universitetin St. Gregory. Studimet e tij përqendrohen në letërsinë dhe teorinë e performancës postmoderne franceze, rolin e mitit letrar në letërsinë dramatike dhe zhvillimin e lëvizjeve teatrore shumëgjuhëshe dhe ndërkulturore.

NASI LERA

vetmia e syve
të qenit

Onufri Tregime